



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË



RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Guidë Turistike Shqiptare ”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”,
Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Eva TAFILI 
2. Prof. Dr. Rudina MITA 

Shkurt 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në “Guidë Turistike Shqiptare”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master profesional në “Guidë Turistike Shqiptare”
4	Urdhri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 653, datë 11.10.2018
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR nr. 285, datë 22.10.2020
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit / 2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021: 7 PAE / 2 PAK 2021-2022: 6 PAE / 1 PAK 2022-2023: 7 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021: 3 studentë 2021-2022: 8 studentë 2022-2023 : 4 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, i cili ka aplikuar për akreditimin e programit të studimit Master Profesional “Guidë Turistike Shqiptare” është një Institucion i Arsimit të Lartë që përbëhet nga 5 fakultete dhe 22 departamente e 3 qendra kërkimore, është licencuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 20.12.2005 dhe akredituar me Vendimin e BA nr. 18, datë 24.03.2022.

Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore që ofron programin Master Profesional, po ashtu, është krijuar me Vendimin e KM Nr. 801, datë 20.12.2006, si një nga njësitë kryesore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” (UAMD). Në gjenezë ai emërtohej Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, ndërsa qysh nga viti 2010 njihet si “Fakulteti i Biznesit” (FB).

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Guidë Turistike Shqiptare” i hapur gjatë vitit akademik 2018-2019 me Urdhër nr. 653, datë 11.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë është një program që realizohet në gjuhën shqipe nga Departamenti i Turizmit, i cili është pjesë e Fakultetit të Biznesit. Programi ofrohet si formë studimi me kohë të plotë dhe me 60 kredite. Kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik (2 semestra). Në përfundim të programit lëshohet diplomë “Master profesional” në “Guidë Turistike Shqiptare”, në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Programi i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Departamenti i Turizmit, që realizon programin, përbëhet nga 8 (tetë) anëtarë. Qëllimi i këtij program studimi është të përgatisë profesionistë në fushën e Guidës Turistike, të pajisur me njohuri bashkëkohore teorike dhe shprehi të duhura praktike, për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të biznesit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL-i përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, të cilët do të kryenin vizitën në institucion, si dhe do të përpilonin raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga **Prof. Dr. Eva Tafili** dhe **Prof. Dr. Rudina Mita**.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Guidë Turistike Shqiptare” i ofruar nga Departamenti i Turizmit, pjesë e Fakultetit të Biznesit, pranë Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë.

Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga koordinatorja teknike e ASCAL-it, **Msc. Aviola Bardhi**. Në bashkëpunim me koordinatoren teknike të ASCAL-it u caktuan datat e vizitës në institucion dhe u përgatit agjenda e takimeve që do të realizoheshin. Agjenda iu dërgua paraprakisht edhe institucionit.

Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 9 dhe 10 Qershor 2023. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me drejtues të Institucionit të Arsimit të Lartë, dekanin e fakultetit dhe përgjegjës të departamentit që mbulon programin e studimit; grupin e vlerësimit të brendshëm; pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi; studentë të këtij programi studimi, përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të zyrës së Kurrikulës, përfaqësues të zyrës së Projekteve, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të zyrës së Shërbimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe me përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambientet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambientet e bibliotekës. Pas vizitës në IAL, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit e analizës së materialeve shtesë që iu kërkuan institucionit gjatë vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm. Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek koordinatorja teknike e ASCAL-it.

Për vlerësimin e këtij programi studimi GVJ u përqendrua në 6 fusha kryesore, si vijon:

1. Përputhshmëria e programit të studimit me interesat kombëtare, misionin dhe vizionin;
2. Në organizimin, drejtimin dhe administrimin e programit të ofruar;
3. Tek niveli e cilësia e mësimdhënies, vlerësimi i studentëve dhe aftësitë e fituara prej tyre;
4. Tek burimet e nevojshme njerëzore, financiare, infrastrukurore dhe logjistike për realizimin e programit;
5. Tek politikat dhe procedurat që ndiqen për mbështetjen e studentëve;
6. Tek sigurimi i cilësisë së programit të studimit.



Më datë 22.01.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 19/10 Prot., datë 22.01.2024 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 20.02.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr 332/1 Prot., datë 19.02.2024.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

Lidhur me përmbushjen e kriterit 7, standardi II.1 , nga ana e GVJ është gjykuar mbi faktin që të tre programet MP në Guidë Turistike përgatisin specialistë guida turistike për tregun turistik në Shqipëri, pavarësisht nëse në emërtesën e njërit program ekziston cilësori "shqiptare" dhe tek të tjerët nuk ekziston. Të gjithë të diplomuarit në këto tre programe u dedikohen të njëjtit treg pune, duke qenë të specializuar në Guidë Turistike, për çka nuk dallojnë nga njëri-tjetri në kualifikimin profesional. Kësisoj, në gjykimin e RVJ, emërtesa "Guidë Turistike" e një programi që formon specialistë për tregun turistik shqiptar, nuk se ndryshon në thelb me emërtesën "Guida Turistike Shqiptare" e një programi tjetër që formon, po ashtu, specialistë për tregun turistik shqiptar.

Megjithatë, meqë komenti i Departamentit të Turizmit, UAMD, mbështetet në Urdhrin nr. 653, datë 11.10.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në pretendimin se kjo gjë nuk është ngritur si problem nga ministria, po e pranojmë observacionin e tyre dhe po e përshtatim RVJ sipas tij. Kjo përshtatje do të ndikojë edhe në vlerësimin përfundimtar të Standardit II.1 dhe Standardit II në tërësi, duke kaluar nga "Përmbushja kryesisht" e Standardit II.1, në "Përmbushet plotësisht", si edhe tek shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit, duke kaluar sërish nga "Përmbushja kryesisht" e Standardit II, në "Përmbushet plotësisht".



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Guidë Turistike Shqiptare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UAMD dhe Fakulteti i Biznesit ofrojnë programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe kërkesat e nevojat e shoqërisë, si dhe që synojnë konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Mënyra sesi është hartuar Programi i studimit Master Profesional në “Guidë Turistike Shqiptare” (MPGTSH), është pasqyrë e mbështetjes në përvojën akademike e kulturore, ndaj kërkesave të zhvillimit perspektiv të vendit, duke pasur në fokus ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. <i>(Ev Aneks 2; Ev Aneks 3; Ev. Aneks 3.1; Ev. Aneks 3.2; Ev. Aneks 4; Ev. Aneks 4.1)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni, vizioni dhe qëllimi i Universitetit A. Moisiu Durrës është rritja në mënyrë të vazhdueshme dhe arritja e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahja e aspiratave arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Në këtë kuptim, programi i studimit MPGTSH, në hartimin e tij i plotëson kriteret dhe ofrohet në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së IAL UAMD dhe të Fakulteti të Biznesit. <i>(Ev Aneks 3; Ev Aneks 3.1; Ev. Aneks 3.2; Ev Aneks 4.1; Ev. Aneks 7)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Nga evidencat vërehet se programi i studimit MPGTSH është hartuar dhe u ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit, UAMD-së. Statuti i Universitetit i parashton qartë drejtimet strategjike të zhvillimit të IAL-së, duke filluar me Planin Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2016-2020 e duke vijuar me planin e ri 2020 – 2025. Statuti dhe rregullorja e IAL-së, rregullorja e Fakultetit të Biznesit, ajo e Departamentit të Turizmit, si dhe rregullorja e programit të studimit MPGTSH përcaktojnë qartë drejtimet parësore akademike të institucionit, çka bën që tërësia e programit të ofruar të studimit të jetë në përputhje me përcaktimet në fuqi. <i>(Ev Aneks 2; Ev Aneks 3; Ev. Aneks 3.1; Ev. Aneks 55; Ev. Aneks 57; Ev. Aneks 59; Ev. Aneks 60; Ev. Aneks 61; Ev. Aneks 61.1)</i>



<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Për hapjen e programit të studimit MPGTSH, si dhe për përmirësimin në vazhdimësi të programeve të studimeve që mbulon Dep. i Turizmit, ky i fundit është mbështetur në Planin strategjik të zhvillimit të UAMD-së. Programi i studimit MPGTSH, është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, duke mbajtur në vëmendje interesin kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit.</p> <p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar dhe përmes tij synohet të plotësohen nevojat e tregut të punës në nivel lokal, kombëtar e më gjerë. Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Studentët e këtij programi mund të inkuadrohen në projektet dhe programet ndërkombëtare me të cilat UAMD ka marrëveshje mobiliteti.</p> <p><i>(Ev. Aneks 3; Ev. Aneks 3.1; Ev Aneks 3.2; Ev. Aneks 4.1; Ev Aneks 34; Ev Aneks 53; Ev. Aneks 55; Ev Aneks 58; Ev. Aneks 63)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Hartimi i programit të studimit MPGTSH i plotëson kriteret dhe ky i fundit ofrohet në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së UAMD e të fakultetit përkatës. Ky program mbështetet mbi përvojën akademike e kulturore dhe mban parasysh kërkesat e zhvillimit perspektiv të vendit, duke pasur në fokus ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike e ato kulturore kombëtare. Ai është hartuar dhe u ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit të IAL-së. Hartimi i programit të studimit është bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe zbatohet duke u mbështetur në to. Studentët e këtij programi mund të inkuadrohen në projektet dhe programet ndërkombëtare me të cilat UAMD ka marrëveshje mobiliteti.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga këqyrja e dokumentacionit, GVJ vëren se Universitetit Aleksandër Moisiu” Durrës e ushtron veprimtarinë e tij si IAL qysh nga krijimi i tij përmes VKM nr. 801, datë 20.05.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës”. Përgjatë veprimtarisë së tij UAMD është transformuar nga pikëpamja cilësore dhe rritur nga ajo sasiore, me mbi 100 programe studimi për të tre ciklet e studimit, të organizuara nga gjashtë njësi kryesore, si dhe ka në gjirin e tij mbi 300 të punësuar si PAE. Departamenti i Turizmit, zbatuesi i këtij programi studimi, që është njësi bazë e Fakultetit të Biznesit, me përvojë prej rreth 12 vitesh akademike dhe që ofron aktualisht 3 programe studimi Bachelor dhe 2 programe studimi Master Profesional është i përbërë nga një staf akademik prej 9 lektorësh me ngarkesë të plotë mësimore, përmes të cilit mbulohen të gjitha programet e studimit që zhvillohen në atë njësi bazë. Pra, mund të themi se institucioni i ka përvojën, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit MPGTSH. <i>(Ev. Aneks 20; Ev. Aneks 20; Ev Aneks 22; Ev. Aneks 43; Ev. Aneks 65; Ev Aneks 97.1; Ev. Aneks 97.2; Ev Aneks 108)</i> https://uamd.edu.al/departamenti-i-turizmit/</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se MPGTSH është emërtuar, organizuar dhe strukturuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (Niveli 7), si program i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional, i cili është vijimësi e programit të ciklit të parë Bachelor “Menaxhim Turizëm”, i profilizuar në Menaxhim Hotel Restorant, Menaxhim Turizëm Kulturor dhe Menaxhim Turizëm Arkeologjik. Po ashtu, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Biznesit, që është përgjegjës për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivave dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. <i>(Ev. Aneks 3.1; Ev Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev Aneks 7)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ vëren se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MPGTSH është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, në përputhje me direktivat e udhëzimet kombëtare dhe evropiane. <i>(Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 6.1; Ev Aneks 7)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>-----</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga këqyrja e evidencave dhe bisedat me personelin e UAMD-së, del në pah fakti që studentët e MPGTSH janë të përfshirë në trajnime të mëtejshme profesionale në bashkërendim me institucione mbështetëse të kontraktuara.</p> <p>Konkretisht, nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se një nga trajnimet e kryera në këtë kuptim është ai i shtatorit të vitit 2022, në kontekst të një projekti në të cilin studentët ishin të ftuar për 2 ditë në Vlorë e Karaburun, për t'u njohur me guidat e natyrës.</p> <p><i>(Ev. Aneks 33; Ev. Aneks 34)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka përvojën, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit MPGTSH. Ky program studimi është emërtuar, organizuar dhe strukturuar në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit, ndërkohë që fusha e tij e përgjithshme dhe specifike është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Biznesit dhe krijon kushtet që studentët të përfshihen në trajnime profesionale, në bashkërendim me institucione mbështetëse të kontraktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ, konstatoi nga vizita në institucion se çdo vendimmarrje realizohet në njësinë bazë dhe në njësinë kryesore përcillet më pas mënyra sesi zbatohet kurrikula për plotësimin e orëve me departamentet e afërta. Komunikohet me zëvendësdekanin për të ofruar një suplement për orët. Po ashtu, janë paraparë trajnime, të cilat njoftohen në shkallë dekanati, për përgjegjësit e njësive. Është krijuar partneritet me Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka”, për departamentin e Turizmit në vitin 2020-2021 dhe me Universitetin e Prishtinës, të cilët e kanë konsideruar UAMD-në si partner ndihmës.</p> <p>Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se për mbarëvajtjen e punës, për zbatimin e programit të studimit MPGTSH, njësia bazë ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me të tjera njësi bazë të njësive kryesore, Fakultetin e Biznesit, në funksion të realizimit efektiv të objektivave që ka ky program studimi. Këto marrëdhënie bashkëpunimi kanë rezultuar në mbulimin me lektorë nga jashtë departamentit të lëndëve dhe moduleve që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev Aneks 24)</i></p>

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit provues, GVJ konstaton se për realizimin e objektivave të programit të studimit, si dhe procesit mësimor e formues të studentëve, UAMD dhe njësia kryesore përgjegjëse për programin kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë biznesi vendës dhe të huaj.</p> <p>Në bisedat në departament GVJ u njoh me faktin se përveç marrëveshjeve në rang fakulteti, departamenti përkatës ka lidhur marrëveshje me operatorët turistikë, të cilët realizojnë vizita studimore, apo duke i ftuar këta të fundit në auditorë. Po ashtu, një tjetër bashkëpunim në këtë kuptim është ai me Departamentin e Gjeografisë në FHF, UT.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev Aneks 34; Ev. Aneks 129)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj., dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, konstaton se në kuadër të realizimit të programit të studimit MPGTSH, UAMD dhe Fakulteti i Biznesit kanë nënshkruar një sërë marrëveshesh institucionale në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe me biznese e kompani private që operojnë në fushën e turizmit, për aftësimin praktik profesional të studenteve pranë këtyre institucioneve ose kompanive, si dhe në funksion të mbikëqyrjes së praktikave profesionale nga njësitë administrative dhe aktorët e bizneseve private të fushës.</p> <p>Një nga institucionet qendrore në këtë kuptim është Qendra Muzeore e Durrësit. Janë realizuar 16 marrëveshje për Guidën Turistike, në të tri hallkat: fakultet, departament dhe dekanat. Po ashtu, në funksion të këtij qëllimi komunikohet me Zëvendësdekanin që të ofrohet një suplement për orët. Edhe për trajnimet bëhen njoftime në shkallë dekanati për përgjegjësit. Vlen të përmenden marrëveshjet e bashkëpunimit me Happy Tours dhe Unionin Turistik Shqiptar. Në këtë prizëm është edhe mbështetja e Programit Hees për trajnime dhe oferta punësimi të studentëve në resorte gjermane, në të cilat janë angazhuar 22 studentë.</p> <p><i>(Ev Aneks 10.3; Ev. Aneks 32; Ev. Aneks 34.1; Ev. Aneks 64)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Është viti i katërt që programi i studimit MPGTSH realizohet nga njësia bazë Departamenti i Turizmit. Në analizën vjetore të punës së programit të studimit, kjo njësi ka hartuar një raport mbi përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Po ashtu, GVJ, nga vizita në institucion u njoh me faktin se në kuadër të analizës vjetore hartohet raporti analitik nga grupet e punës në departament. Në raportin e vitit akademik 2021-2022 janë pasqyruar edhe mundësitë e punësimit e të trajnimit të studentëve.</p> <p>Këto bashkëpunime mundësojnë veprimtari të stafit akademik dhe të studentëve, siç është edhe realizimi i veprimtarive informuese on-line, apo i leksioneve të përbashkëta.</p> <p><i>(Ev. Aneks 35; Ev Aneks 38; Ev. Aneks 107)</i></p>

Konkluzione	<p><i>Për zbatimin e programit të studimit njësi bazë ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me të tjera njësi bazë të njësisë kryesore, në funksion të realizimit efektiv të objektivave që ka ky program studimi. Nga UAMD dhe Fakulteti i Biznesit janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë biznesi. Po ashtu, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për aftësimin praktik profesional të studenteve, pranë institucioneve të ndryshme ose kompanive, si dhe në funksion të mbikëqyrjes së praktikave profesionale. Një nga institucionet qendrore në këtë kuptim Është nënshkruar marrëveshje me Qendrën Muzeore të Durrësit, Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka", për departamentin e Turizmit në vitin 2020-2021 dhe me Universitetin e Prishtinës. Janë realizuar 16 marrëveshje për Guidën Turistike, Vlen të përmenden marrëveshjet e bashkëpunimit me Happy Tours dhe Unionin Turistik Shqiptar. Në këtë prizëm është edhe mbështetja e Programit Hees për trajnime dhe oferta punësimi të studentëve në resorte gjermane, në të cilat janë angazhuar 22 studentë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimeve MPGTSH është i strukturuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij. Kjo strukturë shprehet përmes ndërtimit të planit mësimor të detajuar dhe të miratuar, si dhe kurrikulës së programit të studimit. Bazuar në kurrikulën dhe planin e tij mësimor, programi është i organizuar në lëndë që karakterizohen përmes ngarkesës në orët mësimore që përmban çdo lëndë. Në përputhje me ligjin 80/2015, neni 75, pika 6, çdo veprimtari formuese është e shprehur me kredite ECTS. Tërësia e krediteve në programin mësimor paraqiten për secilën lëndë, të ndarë sipas veprimtarive; leksione, seminare, punë laboratorike dhe praktika. Programi i studimit zgjat 1 vit (2 semestra) me 60 kredite, që nga ana e tyre ndahen në:</p> <p>30 javë mësimore në auditor për vitin akademik dhe 15 javë mësimore në auditor për çdo semestër. Në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018), “Për Elementët e Programeve të Studimit”, plani mësimor i këtij programi studimi, është i detajuar me simbolet A, B, C, D, E dhe F, për veprimtarive formuese, për çka ndarja e lëndëve dhe moduleve të këtij plani përputhet plotësisht me kategoritë e përcaktuara. Konkretisht:</p> <p>Me “A” simbolizohen Lëndët Bazë (10%), që karakterizohen nga 6 kredite ECTS; 1 lëndë;</p> <p>Me “B” simbolizohen Lëndë Karakterizuese (40%), që karakterizohen nga 24 kredite ECTS; 4 lëndë</p> <p>Me “C” simbolizohen Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (23%), që karakterizohen nga 14 kredite ECTS; 2 lëndë</p> <p>Me “D” simbolizohen Lëndë Plotësuese (10%), që karakterizohen nga 6 kredite ECTS; 2 lëndë</p> <p>Me “E” simbolizohen Detyrimet Përmbyllëse (17%) që karakterizohen nga 10 kredite ECTS; Mikroteza.</p> <p>Kategorizimi i lëndëve në planin mësimor dhe organizimi i kurrikulës së studimit përmes ndarjes në vite e semestra i shërben plotësisht formimit të studentëve të MPGTSH.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 14; Ev. Aneks 14.1)</i></p>

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

GVJ vëren se programi i studimit MPGTSH ka në përmbajtje lëndë që kanë karakter shumëdisiplinor, çka i shërben formimit të gjithanshëm të studentëve. Mënyra e zhvillimit të tyre paraqitet në rregulloren e programit të studimeve dhe atë të UAMD.

Kurrikula karakterizohet nga ndarja e lëndëve në disiplina të formimit karakterizues, që përbëjnë aspektin kryesor të formimit profesional në program. Vërehet një ndarje në lëndë që bëjnë pjesë tek disipinat e formimit të thelluar; në lëndë të karakterit integruar; në lëndë karakterizuese specifike; si dhe në praktikën mësimore. Organizimi në këtë mënyrë i lëndëve mundëson formimin profesional të studentëve dhe u krijon atyre mundësinë që të orientohen drejt një kategorie specifike profesionale në fushën e turizmit, siç është profesioni i guidës turistike në Shqipëri. Ky program priret të ofrojë njohuri të qëndrueshme në sferën e turizmit, pasi mbështet mbi parimet akademike të kësaj fushe, të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit në MPGTSH. Njohuritë e fituara në përfundim të këtij programi studimi shtojnë për studentët mundësitë për karrierë profesionale në këtë profesion, në rang kombëtar e më gjerë.

Programi bën të mundur që, duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale në profesionin, të diplomuarit në MPGTSH të punësohen në bizneset e industrisë së turizmit, apo si guida tek monumentet e kategorisë së parë e të dytë, etj.

Rinovimin dhe pasurimin i syllabuse-ve të programit ofron informacion bashkëkohor që lidhet me profesionin e Guidës Turistike, çka shprehet me literaturën e përditësuar të viteve të fundit, e cila pasqyrohen njohuritë dhe zbulimet e reja të kësaj fushe akademike. Syllabus-et e lëndëve që përbëjnë programin e studimit japin një pasqyrë të faktit se qëllimi final i programit është formimi i specialistëve guida turistike me njohuritë e nevojshme për të kuptuar në mënyrë kritike teoritë dhe parimet akademike në fushën që ata do të punësohen në të ardhmen, duke plotësuar mungesën e sotme të guidave turistike në tregun vendas të punës. Temat e leksioneve që trajtohen gjatë zhvillimit të lëndëve janë bashkëkohore dhe transmetojnë një nivel të përparuar informacioni e njohurish, aftësish dhe kompetencash në fushën profesionale. I gjithë kuadri formues priret të ofrojë njohuri dhe kompetenca në realizimin e objektivave të njohjes së destinacioneve turistike arkeologjike, historike, natyrore, kulturore, detare, mjekësore, etj., duke i shtyrë njohuritë e studentëve përtej atyre që kanë përftuar në programin Bachelor, çka u jep atyre mundësi për zgjidhjen e situatave të ndryshme në mjediset që lidhen me fushën e studimit të tyre.

(Ev Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 6.1; Ev. Aneks 7)

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga këqyrja e dokumentacionit GVJ konstaton se ndërtimi i programit të studimit MPGTSH është bërë në mënyrë të tillë që praktika profesionale të realizohet në semestrin e dytë nga çdo student, pasi të ketë përmbyllur me sukses të gjitha detyrimet e mëparshme, pra të jetë kalues në të gjitha lëndët e programit. Praktikës profesionale i janë dedikuar 3 kredite ECTS dhe kjo e fundit duhet të mbrohet përpara një komisioni vlerësimi të krijuar nga përgjegjësi i njësisë bazë. Pas përfundimit të praktikës studenti duhet të mbrojë detyrimet përmbyllëse përpara një komisioni të krijuar nga përgjegjësi i njësisë bazë, ose të bëjë mbrojtjen e mikrotezës, e cila vlerësohet me 10 kredite, të cilat përbëjnë 17% të totalit të krediteve të programit, në përputhje me përcaktimet e akteve nënligjore, si VKM, etj. <i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 10.2; Ev. Aneks 10.3; Ev. Aneks 15; Ev. Aneks 15.1, Ev. Aneks 63)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>-----</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>-----</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD nuk hyn tek institucionet me status të veçantë.</p>

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit MPGTSH ofrohet në fushën e turizmit, posaçërisht në fushën e udhërrëfyesit turistik. GVJ konstaton se një program studimi 2-vjeçar (120 kredite), i emërtuar “Master Profesional Guidë Turistike”, ofrohet nga Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore në FHF, UT, si dhe një tjetër program 1-vjeçar (60 kredite), po me emërtimin “Master Profesional Guidë Turistike”, ofrohet nga Departamenti i Marketing Turizmit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Fan Noli, Korçë. Duke qenë se Programi MPGTSH, ndryshe nga dy programet më lartë emërtohet “Guidë Turistike Shqiptare” dhe jo thjeshtë “Guidë Turistike”, nuk e ka detyrimin të ketë ngjashmëri së paku në masën 70% të saj me çdonjërin nga këto programe master profesional të guidës turistike. (Ev. Aneks 58.1) https://www.fhf.edu.al/plani-mesimor-mp-guide-turistike/ https://moodle.unkorce.rash.al/course/index.php?categoryid=42</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Po ashtu, të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë të kodifikuara nga instancat e përkatëse shtetërore në Shqipëri. Secila lëndë ka kodin e vet përkatës, që e dallon atë nga lëndët e tjera të programit dhe të çdo programi tjetër studimi. (Ev. Aneks 31)</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk është ky rasti, pasi programi i studimit ofrohet vetëm nga Departamentit i Turizmit në Fakultetin e Biznesit të UAMD dhe nuk është program studimi i përbashkët..</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimeve MPGTSH është i strukturuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për këtë qëllim. Procesi mësimor është i organizuar me orë mësimore dhe kreditet përkatëse. MPGTSH ka në përmbajtje lëndë që kanë karakter shumëdisiplinor dhe priret të ofrojë njohuri të qëndrueshme në sferën e turizmit, pasi mbështetet mbi parimet akademike të kësaj fushe, që janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit në MPGTSH. Syllabus-et e kanë qëllim formimin e specialistëve guida turistike për të plotësuar mungesën e tyre në tregun. Programi i studimit MPGTSH i përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi. Programi MPGTSH nuk ka emërtesë të njëjtë me asnjë program tjetër në fushën e studimit guidë turistike, ndaj nuk e ka detyrimin të ketë ngjashmëri së paku në masën 70% asnjërin prej tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia që ofron programin e studimit MPGTSH është ajo bazë, pra Departamenti i Turizmit në Fakultetin e Biznesit, UAMD, në përputhje me aktet dhe rregulloret përkatëse. Ky departament dhe fakulteti ku ai është i inkorporuar, me cilësinë e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit MPGTSH, i përmbushin rekuizitat ligjore lidhur me numrin e personelit të nevojshëm akademik dhe kualifikimin e tij akademik.</p> <p>Për vitin akademik 2022- 2023, njësia bazë që ofron programin e studimit MPGTSH, Departamenti i Turizmit, ka në përbërjen e tij 9 punonjës akademikë, ku 8 janë të kategorisë “Lektorë” dhe zotërojnë gradën shkencore “Dr.”, ndërsa 1 është i kategorisë “Asistent-lektorë”, me gradën Msc.</p> <p>Sakaq, në përbërjen të Fakultetit të Biznesit janë 69 punonjës akademikë, nga të cilat 18 janë të kategorisë “Profesor”, ku 5 zotërojnë titullin “Profesor” dhe 13 titullin “Profesor i Asociuar”, 40 janë personel akademik të kategorisë lektorë, me gradën shkencore “Dr.” dhe 11 janë të kategorisë “Asistent-lektorë” me gradën MSc.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 8; Ev. Aneks 23; Ev. Aneks 24; Ev. Aneks 36)</i></p> <p>https://ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-24-mars-2022</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga bisedat në institucion, GVJ vëren se njësia kryesore, Fakulteti i Biznesit, pjesë e të cilit është Departamenti i Turizmit, i përmbush të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me angazhimin e personelit akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, siç është i përcaktuar në aktet nënligjore dhe siç dëshmohet nga rregulloret e studimit. Nga vizita në institucion GVJ konstaton se, si personel akademik i angazhuar nga njësia bazë, përzgjidhen figura të lidhura me turizmin dhe arkeologjinë, pasi janë ftuar për t’u angazhuar përmes thirrjeve të hapura të botuara në webfaqen e fakultetit nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Njësia përgjegjëse, Departamenti i Turizmit, e ngarkuar me zbatimin e këtij program studimi, i përmbush të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin e strukturën akademike dhe ndihmëse të tij, për realizimin e proceseve mësimore laboratorike dhe praktikave mësimore.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 22)</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin, Departamenti i Turizmit, ka të emëruar një koordinator për programin e studimit MPGTSH. Koordinatori është zgjedhur nga asambleja e departamentit në mbledhjen e tij të datës 19.04.2021. Koordinatori i ka të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit të drejtat dhe detyrimet e tija. Siç dëshmon evidenca “Aneks 36”, në mbledhjen e lartpërmendur janë zgjedhur koordinorët për të gjitha programet e studimit të ofruara nga kjo njësi bazë. (Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 36)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përputhje me aktet dhe rregulloret përkatëse, përgjegjëse për programin e studimit MPGTSH është njësia bazë, Departamenti i Turizmit në Fakultetin e Biznesit, Kjo njësi ka në përbërjen e saj 9 punonjës akademikë, ku 8 syresh janë të kategorisë “Lektorë” dhe zotërojnë gradën shkencore “Dr.”, ndërsa 1 është i kategorisë “Asistent-lektorë”, me gradën Msc. Fakulteti i Biznesit, që ka në përbërje këtë njësi bazë, ka 64 punonjës akademikë, nga të cilat 14 janë të kategorisë “Profesor”, ku 4 zotërojnë titullin “Profesor” dhe 10 titullin “Profesor i Asociuar”, 44 janë personel akademik të kategorisë lektorë, me gradën shkencore “Dr.” dhe 6 janë të kategorisë “Asistent-lektorë” me gradën MSc. Programi i studimit mbikëqyret nga titullari i Departamentit të Turizmit, ndërsa për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit është ngarkuar koordinatori i programit, i cili raporton tek përgjegjësi i njësisë bazë. Institucioni i arsimit të lartë, UAMD, i plotëson standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional, përmes VBA nr. 18, datë 24.03.2022. Fakulteti i Biznesit, si pjesë përbërëse e UAMD, ka ngritur njësinë e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike, dhe standardet e hartuara për këtë qëllim janë në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Turizmit, përgjegjës për zbatimin e programit të studimit MPGTSH ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, siç kërkohet ligjërisht, çka pasqyrohet në Statutin e UAMD, Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Studimeve të Fakultetit të Biznesit, në Rregulloren e programit të studimit MPGTSH dhe në nivel departamenti.</p> <p>Ky program studimi është i organizuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të institucionit. Programi i studimit është i organizuar dhe i ndarë në lëndë, praktika e aktivitete formuese, çka pasqyrohet në planin mësimor e kurrikulën e studimeve.</p>

	<i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 14)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>GVJ konstaton se programi i studimit e ka të inkorporuar planin mësimor, ku janë të paraqitura qartë syllabus-et e lëndëve që e përbëjnë atë plan mësimor, i cili ofrohet nga Departamenti i Turizmit.</p> <p>Plani mësimor i MPGTSH përmban informacion të hollësishëm lidhur me secilën lëndë, numrin e krediteve për çdonjëren syresh, semestrin kur zhvillohet, raportin midis leksioneve dhe seminareve, detyrimet e ndryshme, të cilave studenti u nënshtrohet gjatë zhvillimit të saj, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe mënyrën e vlerësimit të studentit, si dhe mënyrën e zhvillimit të provimit. Po ashtu, ky plan ka të pasqyruar ngarkesën mësimore për çdo lëndë, edhe për efekt të kreditimit, ku janë të shprehura qartë orët që studenti kryhen në auditor dhe orët studimore jashtë tij. Po ashtu, është përcaktuar mënyra e frekuentimi të çdo lënde, si dhe metodika për aftësimin praktik të studentëve. Me pak fjalë, tërësia e orëve të studimit që realizohen në auditor, ku secila zgjat 50 minuta, si dhe orët për punën e pavarur jashtë tij shprehen në kredite ECTS, ku secilës ore mësimore i korrespondojnë 25 të tilla. Në këtë kuptim edhe punët laboratorike e praktika kanë të përcaktuara numrin përkatës të krediteve.</p> <p>Ndarja e programit të studimit, që zhvillohet me 2 semestra, me nga 15 javë mësimore në auditor për çdo semestër, duke çuar kësisoj në 30 javë mësimore përgjatë gjithë vitit akademik.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 14.1; Ev. Aneks 23; Ev. Aneks 24; Ev. Aneks 25; Ev. Aneks 93)</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Nga këqyrja e dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, GVJ vëren se programi i studimit MPGTSH është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me Rregulloren e Studimeve të Universitetit UAMD-së, Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit, Rregullore e Departamentit të Turizmit dhe, natyrshëm, me Rregulloren e programit të studimit MPGTSH. Me fillimin e procesit mësimor, këto rregullore u vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi, të cilët aty gjejnë informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 6.1; Ev. Aneks 7)</i></p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabus-et) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit MPGTSH është në përputhje me misionin dhe politikën e Departamentit të Turizmit, çka dëshmohet nga objektivat e detajuara që ka secila kategori e grup lëndësh, si dhe nga lëndët e veçanta të këtij programi. Këto objektiva, për të cilat vërehet se kanë një renditje logjike, që shmanë përsëritjen e tyre, janë informuese për studentët në funksion të formimit të tyre sipas profilit përkatës, duke ofruar informacion për destinacionet arkeologjike, kulturore, natyrore që vizitohen nga turistët, për menaxhimin e tureve dhe grupeve turistike.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit, i hartuar për zbatimin e kurrikulës nga stafi akademik dhe studentët, mbështetet tek syllabus-et, të cilat përmbajnë informacione të përgjithshme, siç janë titulli i lëndës, emrin e titullarit që e zhvillon, ngarkesën në orë dhe kreditë, tipologjinë apo kategorinë e lëndës, vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës, programin mësimor të cilit i përket, kodin e lëndës/modulit dhe adresën elektronike të titullarit të lëndës. Po ashtu, ato përmbajnë një përmbledhje dhe rezultatet e të nxënies, koncepte themelore mbi të cilat ndërtohet lënda, temat e saj të ndara në javë sipas semestrit, praktikën, seminarët, apo orët e laboratorit, formatet e kontrollit të dijeve (<i>masën e frekuentimit dhe mënyrat e kontrollit të vazhdueshëm, mënyrën dhe peshën e vlerësimit</i>) dhe burimet e literaturës bashkëkohore e të përditësuar, në mbështetje të programit të lëndës. Të gjitha syllabus-et janë hartuar, së pari, nga titullari i lëndës në përputhje me formatet ligjore për këtë qëllim dhe më pas shqyrtohen në departament e miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i Fakultetit të Biznesit.</p> <p>Në fund, mund të thuhet se programi i studimit MPGTSH i përmban të gjitha informacionet e detajuara për syllabus-et, që nga ana e tyre përmbajnë të gjithë elementët formues të programit, brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara nga aktet përkatëse.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 14.1; Ev. Aneks 19; Ev. Aneks 67; Ev. Aneks 93)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, u njoh me faktin se programi i studimit MPGTSH syllabus-et aktuale i ka të trashëguara qysh viti akademik 2018-2019, kur u bë miratimi i programit të studimit. Këtij programi, pas një riorganizimi të bërë në vitin 2020, janë shtuar në masën 20% lëndët me zgjedhje, u riemërtua një lëndë dhe u rinovua literatura.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 14; Ev. Aneks 14.1)</i></p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit MPGTSH, përmban planin mësimor të zërthyer përmes syllabus-eve të lëndëve përkatëse dhe i organizuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të institucionit, përmes ndarjes në lëndë, praktika e aktivitete formuese, çka pasqyrohet në planin mësimor e kurrikulën e studimeve. Plani mësimor pasqyron në mënyrë të hollësishme informacionin për emërtimin e lëndëve, numrin e krediteve për çdo lëndë, me të gjithë elementët e saj përbërës, duke iu përmbajtur rregulloreve përkatëse në nivel IAL-je dhe njësisish nënrenduese. Kurrikula e programit të studimit është në përputhje me misionin dhe politikat e Departamentit të Turizmit. Si plani mësimor, ashtu edhe syllabus-et e tija janë hartuar nga titullari i lëndës e më pas janë miratuara nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i Fakultetit të Biznesit. Programi i studimit MPGTSH përmban të detajuara të gjitha informacionet dhe elementët formues në përputhje me formatet e miratuara nga aktet përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga këqyrja e dokumentacionit, GVJ vëren se MPGTSH u ofron studentëve mundësinë e thellimit dhe zhvillimit të dijeve, si dhe përfitim të aftësive praktike e profesionale në fushën e guidave turistike, duke u mundësuar atyre të njihen me burimet natyrore, kulturore, arkeologjike, së bashku me njohuritë që u jepen në sferën menaxhuese dhe asaj të marketingut të destinacioneve turistike, krijon premisa për guida më të specializuara në territorin shqiptar. Praktikant mësimorë dhe përdorimi i terminologjisë në gjuhën e huaj, i pajisin studentët me njohuritë e nevojshme për të konkurruar në tregun turistik. Në aspektin e punësimit, MPGTSH ofron njohuri të mira profesionale, duke rritur mundësitë për t'u punësuar si guidë terreni, pranë një Tour Operatori apo agjencie turistike. Zhvillimi i mëtejshëm i aftësive do bëjë të mundur më pas edhe punësimin e të diplomuarve në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit. <i>(Ev. Aneks 16; Ev. Aneks 17; Ev. Aneks 29)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstaton se kurrikula e MPGTSH përbëhet nga 8 lëndë, praktikën profesionale dhe mikrotezën, të ndarë në dy semestra. Në semestrin e parë zhvillohen 6 lëndë (34 kredite), ku ndërthuren lëndët bazë, lëndët karakterizuese dhe ato integruese e plotësuese. Në semestrin e dytë zhvillohen 2 lëndë (26 kredite), që janë praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës. Kjo mënyrë e organizimit të planit mësimor, më të gjithë elementët e tij, ka bërë një shpërndarje në dukje optimale për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. <i>(Ev. Aneks 14.1)</i>

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Këqyrja e programit të studimit MPGTSH dëshmon se ai është i strukturuar sipas përcaktimeve ligjore c nënligjore dhe i ndarë në kategori të veprimtarive formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët karakterizuese profesionale, që janë në përputhje me profilin e programit. Lëndët dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e programit të studimit, pasi përmbajnë njohuritë e duhura për t’i formuar studentët që e ndjekin atë. Ngarkesa në orë mësimore (1500) dhe kredite ECTS (60) që ai përmban, janë në përputhje me përcaktimet ligjore për një cikël të dytë studimi profesional.</p> <p>Nga bisedat në institucion, GVJ u njoh me faktin se pas hapjes së programit të studimit MPGTSH, nga organizatorët e këtij programi u krye një studim tregu dhe u konstatua se ai ka ngjashmëri me programet e ofruara nga universitetet e Shkodrës, Gjirokastrës dhe Tiranës. Në këtë aspekt, konstatimi ynë është se ngjashmëria ekziston lidhur me fushën e studimit, por jo në masën 70% në aspektin kurrikular të programit, siç kërkohet nga kriteri 7, i Standardit II.1. Po ashtu, sa sipër vlen të thuhet edhe në lidhje me programe të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare në sferën e guidës turistike.</p> <p>Në kurrikulën e këtij programi masteri profesional, raporti teori - praktikë është në përputhje të plotë më plotësimin e synimeve që ka ky program studimi, duke mundësuar një formim më të mirë profesional të studentëve dhe duke krijuar kushtet që t’i pajisë ata me aftësi profesionale të thelluara. (Ev. Aneks 14.1; Ev. Aneks 19; Ev. Aneks 58; Ev. Aneks 58.1; Ev. Aneks 67)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ vëren se ndarja e veprimtarive formuese në programin e studimit, MPGTSH është bërë duke ruajtur një raport të ekuilibruar teori - praktikë. Ky ekuilibër krijon mundësinë për një formim të plotë të studentëve, sipas drejtimin, profilizimit dhe objektivave formues të programit, çka u mundëson atyre transferimin e studimeve në institucione të tjera.</p> <p>Ky program studimi e ka rëndësinë tek veprimtaritë formuese, të cilat përfaqësojnë disiplina të formimit karakterizues, ndërdisiplinore dhe plotësuese (73%) të kurrikulës.</p> <p>Interesimit të GVJ, sesi organizatorët e programit të studimit mendonin ë që të realizonin transferimin e studimeve brenda vendit, në një kohë që programet nuk përputhen në masën 73% me programe që ofrojnë institucionet e tjera, iu përgjigjën se vënia e theksit tek marketingu dhe politikat e sigurisë janë elementët që i dallojnë dhe i afrojnë me to. (Ev. Aneks 14.1)</p>
<p>Kriteri 5. Syllabus-et (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabus-et e programit të studimit MPGTSH i hapur në vitin akademik 2018-2019, janë përditësuar, duke iu referuar një literaturë të rifreskuar të 5 viteve të fundit, ndonëse në disa lëndë janë ruajtur koncepte bazë të rëndësishme që mbështeten në një literaturë më të hershme se 5 vitet e fundit.</p> <p>(Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 19; Ev. Aneks 67)</p>

<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga biseda në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit MPGTSH është i plotë dhe në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar: dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në guidë turistike për studentët. Ai është ndërtuar me lëndë specifike të veprimtarive formuese, ku mbizotërojnë jo vetëm disiplinat e formimit karakterizues, por edhe lëndët ndërdisiplinore e plotësuese, të cilat krijojnë të gjitha kushtet për arritjen e synimeve të tija dhe që u garantojnë studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale që do tu shërbejnë kur të punësohen në të ardhmen. (Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 14.1; Ev. Aneks 19)</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstaton, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga bisedat në institucion, se programi i studimit MPGTSH ofron njohuri të mira në fushën e turizmit, në veçanti për profesionin e udhërrëfyesit dhe studentët e diplomuar mund të punësohen në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si të vetëpunësuar (freelance), apo në sektorin publik, në të gjitha shtetet, parqet arkeologjike apo muzetë e vendit si guida profesionale.</p> <p>Interesimit të GVJ në këtë kuptim, në institucion iu përgjigjen se shumë studentë të diplomuar janë punësuar inspektorë të bashkive, në agjencitë e ndryshme.</p> <p>(Ev. Aneks 12; Ev. Aneks 16; Ev. Aneks 17; Ev. Aneks 19; Ev. Aneks 29; Ev. Aneks 67)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programit i studimit MPGTSH është i strukturuar sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore dhe i ndarë në kategori të veprimtarive formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët karakterizuese profesionale. Në aspektin e punësimit, masteri ofron njohuri të mira profesionale, duke rritur mundësitë për t'u punësuar si guidë terreni, pasi praktikat mësimore dhe përdorimi i terminologjisë në gjuhën e huaj i pajisin studentët me njohuritë e nevojshme për të konkurruar në tregun turistik. Ndonëse ekziston ngjashmëria e këtij programi me programet e ofruara nga universitetet e Shkodrës, Gjirokastrës dhe Tiranës, ajo ekziston vetëm lidhur me fushën e studimit, pasi nuk është i tillë në masën 70% në aspektin kurrikular, siç kërkohet nga kriteri 7, i Standardit II.1. Po ashtu, sa sipër vlen të thuhet edhe në lidhje me programe të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare në sferën e guidës turistike, duke mos i përmbushur plotësisht rekuizitat e Kriterit 3 të këtij Standardi.</i></p> <p><i>Syllabus-et janë përditësuar, duke iu referuar një literature të rifreskuar të 5 viteve të fundit. Ka lëndë specifike të veprimtarive formuese, ku mbizotërojnë jo vetëm disiplinat e formimit karakterizues, por edhe ato ndërdisiplinore e plotësuese. Si përfundim, ky programi ofron njohuri të mira në fushën e turizmit dhe studentët e diplomuar mund të punësohen në biznese të llojeve e dimensioneve të ndryshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bisedat në institucion, konstaton se, Departamenti i Turizmit ka siguruar jo vetëm pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në panairin e karrierës, por edhe në veprimtaritë e lidhura me krijimin e kapaciteteve, apo të ndërveprimit praktik me të tretët, si pjesë e transferimit të njohurive dhe të punësimit të tyre</p> <p>Gjatë këtyre veprimtarive departamenti konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, për të përmirësuar e përshtatur kurrikulën e këtij programi dhe ta çojë atë sa më afër propozimeve të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të tregut të punës, duke synuar kështu që të kurrikula e këtij programi të përmirësohet në vijimësi. Bashkëbiseduesit i bënë me dije GVJ-së se një nga ndihmesat më të mëdha në këtë kuptim, lidhur me propozimet e partnerëve, studentëve të diplomuar etj., është ai i Unionit Turistik Shqiptar që vë theksin tek përforsimi i performancës në komunikimin e guidave turistike dhe në zotërimin e gjuhëve të huaja.</p> <p><i>(Ev. Aneks 12; Ev. Aneks 16; Ev. Aneks 17; Ev. Aneks 29)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se qysh nga vitit akademik 2018-2019 UAMD mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, çka realizohet përmes krijimit të një baze të dhënash për studentët, pas mbarimit të ciklit të parë të studimeve. Po ashtu, edhe me studentët e MPGTSH, UAMD dhe Departamenti i Turizmit, si njësi përbërëse e tij, gjatë vitit akademik organizojnë anketa periodike me pyetësorë, për të kuptuar problematikat dhe vështirësitë që ata hasin gjatë frekuentimit të programit, duke synuar përmirësimin e tyre. Edhe Departamenti i Turizmit, në funksion të konsolidimit të programit të studimit MPGTSH, ka mundur pjesëmarrjen dhe angazhimin e studenteve në diskutime të hapura, për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin teorik të tyre.</p> <p>Përfaqësues të studentëve që ndjekin këtë program, sikundër edhe ata që ndjekin programet e tjera, janë anëtarë të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Përfaqësuesi i studentëve ka të drejtë të barabartë vote dhe lirie në shprehje mendimesh, njëso si stafi akademik.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, u njoh me faktin se njësi bazë, në kuadër të ndërkombëtarizimit të në Fakultetin e Biznesit, i disponon të gjitha programet e studimit, si dhe planin mësimor në anglisht. Në këtë kuptim, momentalisht nuk kanë marrëveshje vetëm për programin Guidë Turistike, ndërkohë që programet e tjera i kanë lidhur ato.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 6.1; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 8; Ev. Aneks 12; Ev. Aneks 30; Ev. Aneks 33; Ev. Aneks 40; Ev. Aneks 51; Ev. Aneks 51.2; Ev. Aneks 51.3; Ev. Aneks 66; Ev. Aneks 134)</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bisedat në institucion, GVJ vëren se për të realizuar këtë program studimi Departamenti i Turizmit bashkëpunon me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, si dhe njësitë e pushtetit vendor e qendror. Nga kontaktet me këta partnerë, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon elementët e programit për t'ia përshtatur atë nevojave të tregut të punës. Ky përditësim realizohet edhe me anë të riorganizimeve nën 20%, siç ka ndodhur në vitin 2019-2020, ku MPGTSH u riorganizua për t'iu përshtatur më mirë tregut të punës. (Ev. Aneks 55; Ev. Aneks 57.1; Ev. Aneks 57.2)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në funksion të realizimit të programit të studimit, Departamenti i Turizmit ka siguruar jo vetëm pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në punë dhe karrierës, por edhe në veprimtaritë e lidhura me krijimin e kapaciteteve, apo të ndërveprimit praktik me të tretët, si pjesë e transferimit të njohurive dhe të punësimit të tyre, por edhe konsultohet e merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, për të përmirësuar e përshtatur kurrikulën e këtij programi, që ta çojë atë sa më afër propozimeve të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të tregut të punës, duke synuar kështu që kurrikula e këtij programi të përmirësohet në vijimësi. Ky departament, në funksion të konsolidimit të programit MPGTSH, ka mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në diskutime të hapura, për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin teorik e tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>GVJ vëren se programi i studimit MPGTSH i ka të përcaktuara qartë objektivat kryesore të studimit, si edhe prioritetet e studimit dhe kërkimit shkencor, duke i përputhur ato me objektivat kryesore të Fakultetit të Biznesit dhe të UAMD. (Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 6.1; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 14.1; Ev. Aneks 55)</p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga bisedat në institucion, GVJ konstaton se gjatë vitit akademik njësia kryesore, krahas veprimtarive mësimore, duke bashkërenduar punën nxit edhe zhvillimin e atyre kërkimore shkencore, përmes respektimit të lirive akademike të personelit dhe nxitjen e zgjerimin e fushave të studimit. Mund të përmenden këtu konferencat shkencore që organizon Fakulteti i Biznesit, pjesëmarrja në Konferencën Studentore të Fakultetit të Biznesit, leksionet e hapura apo tavolinat e rumbullakëta, ku ftohen të marrin pjesë ekspertë nga fushën e turizmit, si dhe nxit kërkime shkencore individuale të studentëve, me anë të projekteve e detyrave të kursit që ata realizojnë në lëndët e ndryshme. (Ev. Aneks 81; Ev. Aneks 83; Ev. Aneks 84; Ev. Aneks 84.1; Ev. Aneks 85)</p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga biseda në institucion, GVJ u njoh me faktin se, në funksion të përmirësimit të programit të studimit, njësia bazë u ka siguruar studentëve mundësinë e pjesëmarrjes në konferencat shkencore që organizohen nga institucioni, Fakulteti i Biznesit. Po ashtu, GVJ u njoh me faktin që si formë motivuese në këtë prizëm është edhe vlerësimi i turistëve në sitet turistike në 3 qytete të Shqipërisë ku angazhohen studentët, së paku për periudhën 2022-2023. (Ev. Aneks 83; Ev. Aneks 84.1; Ev. Aneks 85)</p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ konstaton se gjatë hartimit të projektbuxhetit institucioni merr në konsideratë realizimin e objektivave të përcaktuara në funksion të përmbushjes së misionit të tij, si dhe për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në programet e ndryshme të studimit. Buxheti i UAMD mundëson mbështetjen e nevojshme financiare edhe për mbarëvajtjen e programit të studimit MPGTSH. Gjatë vizitës në institucion GVJ-së iu bë i njohur fakti se njësia bazë gjen mbështetje financiare në rang universiteti, për mbulimin e shpenzimeve të praktikave dhe ekspeditave. (Ev. Aneks 49; Ev. Aneks 50)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit MPGTSH i ka të përcaktuara qartë objektivat kryesore të studimit, si edhe prioritetet e studimit dhe kërkimit shkencor, për çka, gjatë vitit akademik njësia kryesore krahas zhvillimit të veprimtarive mësimore, nxit edhe ato kërkimore shkencore, duke pasur në fokus lirinë akademike dhe nxitjen e zgjerimin e fushave të studimit. Nga ana e saj, njësia bazë, përmes respektimit të lirive akademike, u ka siguruar studentëve mundësinë e pjesëmarrjes në konferencat shkencore që organizohen nga institucioni. UAMD, përmes buxhetit të vet, i mundëson mbështetjen e nevojshme financiare mbarëvajtjes së programit të studimit MPGTSH.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ vëren se në çdo njësi bazë të Fakultetit të Biznesit janë krijuar grupet lëndore të miratuara nga senati i UAMD në Statut, në Rregulloren e UAMD, si dhe të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Biznesi dhe Rregullores e Departamentit të Turizmit. Nga ana e tij Fakulteti i Biznesit është pjesë e disa projekteve kërkimore-shkencore, që nxisin kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin me organizma të ngjashme kombëtare e ndërkombëtare. GVJ u njoh me faktin se një ndër projektet e rëndësishme të Fakultetit të Biznesit, është ai Mistral, që në fokus ka turizmin dhe pashmangshmërisht në grupin e punës së të cilit është përfshirë edhe Departamenti i Turizmit.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 6.1; Ev. Aneks 43.1; Ev. Aneks 97.1; Ev. Aneks 97.2; Ev. Aneks 109; Ev. Aneks 118; Ev. Aneks 119; Ev. Aneks 131; Ev. Aneks 132)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bisedat në institucion, vëren se Departamenti i Turizmit ka realizuar përfshirjen e personelit të vet akademik në shumë projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në studime kërkimore-shkencore. Në një pjesë prej tyre, janë përfshirë edhe studentët e programit të studimit MPGTSH.</p> <p>Në institucion GVJ u njoh me faktin se në këtë kuptim janë realizuar guida turistike me destinacione të afërta, siç është shkuarja në Belsh, për të bërë më të prekshëm nga studentët rolin që do të luajë guida në rajon. Po ashtu, në fund të çdo viti akademik organizohen ekskursione mësimore në këtë prizëm. <i>(Ev. Aneks 43; Ev. Aneks 97.1; Ev. Aneks 119; Ev. Aneks 131; Ev. Aneks 132)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë, në bashkëpunim me Fakultetin e Biznesit dhe UAMD, në zbatim të programit të studimit MPGTSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe vendase, aktorë të biznesit vendës e të huaj, për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kurrikulës.</p> <p>Paralelisht, njësia bazë ka mbuluar me personel akademik edhe shumë veprimtari të tjera specifike të kryera nga vetë ai apo nga institucione të tjera, siç janë konferencat në fushën e turizmit, panairët, etj., ku ky personel akademik ka bashkëpunuar ngushtësisht me studentët, për rritur nivelin e pjesëmarrjes aktive së studentëve dhe përfshirjen e tyre në këto veprimtari. <i>(Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 34; Ev. Aneks 81; Ev. Aneks 83; Ev. Aneks 84; Ev. Aneks 84.1; Ev. Aneks 85)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Nga kontaktet në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vëren se kuadri formues i programit të studimit MPGTSH synon të ofrojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional për specialitetin e guidës, që ai të realizojë objektivat në terren, komunikimin me turistët, menaxhimin e tureve, hartimin e një pakete turistike bashkëkohore, dhënien e njohurive rreth destinacioneve turistike shqiptare, etj.</p> <p>Njohuritë, aftësitë, kompetencat dhe formimi i thelluar profesional i studentëve që përfundojnë këtë program studimi do të ndikojë në shtimin e njohurive të tyre, përtej asaj që kanë marrë në Bachelor. Kjo i bën ata origjinalë në zhvillimin e ideve dhe zbatimin e tyre në kontekstin e kërkimit shkencor e në formimin e tyre profesional. Studentët do të fitojnë</p>

kompetenca në sferën turistike, si brenda konteksteve më të gjëra që lidhen me fushën e studimit.
(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 19; Ev. Aneks 26; Ev. Aneks 67)

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.

Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. *Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU*).

Guida turistike nuk hyn tek profesionet e rregulluara, në kuptim të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”.

Konkluzione

Fakulteti i Biznesit është pjesë e disa projekteve kërkimore-shkencore, që nxisin kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin me organizma të ngjashme kombëtare e ndërkombëtare. Nga ana e tij, edhe Departamenti i Turizmit ka realizuar përfshirjen e personelit të vet akademik në shumë projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuptim, një ndër projektet e rëndësishme të Fakultetit të Biznesit, është ai Mistral, që në fokus ka turizmin dhe pashmangshmërisht në grupin e punës së të cilit është përfshirë edhe Departamenti i Turizmit. Njohuritë, aftësitë, kompetencat dhe formimi i thelluar profesional i studentëve që përfundojnë këtë program studimi do të ndikojë në shtimin e njohurive të tyre, përtej asaj që kanë marrë në Bachelor.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Si dëshmohet nga aktet shoqëruese të aplikimit dhe nga bisedat në institucion, GVJ vëren se format e mësimdhënies dhe mësimnxënies mbështeten tek metodat klasike, siç janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e orët e hapura, etj. Praktikës profesionale i kushtohet vëmendje e veçantë, pasi aftësimi praktik i studentëve lidhet me zbatimin konkret në praktikë të njohurive teorike. (Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 10.3; Ev. Aneks 14; Ev. Aneks 91; Ev. Aneks 92; Ev. Aneks 94; Ev. Aneks 95; Ev. Aneks 107)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vëren se personeli akademik altermon metoda pune në përshtatje me nevojat e studentëve. Në syllabus-e të veçanta përfshihet aftësim praktik (vizita studimore) në orë të veçanta, si dhe duke realizuar orën e detyrave individuale të kursit, apo në grupe të vogla pune, për të stimuluar pavarësinë e kërkimit shkencor, si dhe metodikën e të punuarit në grup. Janë vendosur marrëdhënie reciproke përmes komunikimit verbal, si dhe përmes komunikimit elektronik, mes stafit akademik e studentëve. Këtu hyn dhe përfshirja e studentëve në konferencat nga njësjia kryesore. Në institucion GVJ u njoh me faktin se në përgjigje të nevojave të studentëve për marrjen e sa më shumë dijeve, një nga metodat është edhe grumbullimi i objekteve të kulturës materiale, apo organizimi për t'i dërguar studentët në muze të ndryshëm, apo guida natyrore shqiptare me studentët, në terren. Po ashtu, personeli akademik vë në zbatim pyetësorët e ndryshëm të hartuar nga departamenti. Në këtë kuadër realizohet edhe Panairi i Punës dhe i Karrierës, apo janë lidhur marrëveshje me Agjencinë Kombëtare të Vendeve të Mbrojtura. Një aspekt tjetër ishte edhe organizimi e zhvillimi i mësimdhënies bazuar në platformat elektronike si Google Classroom, Zoom, Moodle dhe Teams, përgjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021, në kushtet e zhvillimit të mësimdhënies gjatë periudhës së pandemisë Covid 19. (Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 38; Ev. Aneks 46.1; Ev. Aneks 67; Ev. Aneks 81; Ev. Aneks 81.1)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues dhe nga bisedat në institucion, konstaton se për mbështetjen e personelit akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, UAMD dhe Fakulteti i Biznesit, përkatësisht, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshjeve kanë në thelb shkëmbimet e personelit akademik të dedikuar në procesin didaktik, si dhe atyre që kryejnë veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminarëve, etj.; shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore. Falë</p>

	<p>përvojës së fituar nga përfshirja ne aktivitete shumëdimensionale në këtë kontekst, vërehen ndryshime cilësore në mësimdhënien e tyre.</p> <p>Nga vizita në në njësinë kryesore GVJ konstatoi se Personeli akademik i UAMD, si dhe ai i FB, është i përfshirë në mobilitete të karakterit të mësimdhënies në universitete të huaja, si dhe në veprimtari trajnuese. Pothuaj i gjithë personeli akademik i departamentit që i është dedikuar lekrimit dhe që është i përfshirë në procesin e mësimdhënies, në programin e studimit MPGTSH, përdor mjete audiovizive në realizimin e mësimdhënies. Po ashtu, në ndihmë të tyre është edhe realizimi i ekspeditave mësimore të mbështetura financiarisht nga institucioni, marrëveshjet institucionale, nga të cilat përfitues kanë qenë edhe studentët. Nga ana tjetër, lektorët e Departamentit të Turizmit u përgjigjen thirrjeve për projekte shtetërore.</p> <p><i>(Ev. Aneks 34; Ev. Aneks 73; Ev. Aneks 73.1; Ev. Aneks 109)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit tek studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (CV-të e personelit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në programin MPGTSH, si dhe kualifikimet e tyre) GVJ vlerëson kompetencën e mjaftueshme të personelit akademik në fjalë, në përputhje me përcaktimet e rregullores së programit të studimit. Tregues i për shtimin e kompetencës së personelit akademik janë edhe kualifikimet e tija në fushat e kërkimit, si dhe përvoja e krijuar në kërkimin shkencor, siç dëshmojnë CV-t e gjithsecilit dhe formularët e kërkimit shkencor në rang departamenti. Në këtë kuptim, GVJ u njoh me faktin se një ndihmesë e madhe në kuadrin e kërkimit shkencor nga personeli akademik është edhe mbështetja financiare që i bëhet këtij personeli nga ana e fakultetit, duke i mundësuar atij shpenzimet për publikime në revistat e indeksuara në Scopus dhe Web of Science, për çka u mbulohen shpenzimet financiare deri në 1000 euro. Po ashtu, përfshirja e personelit akademik në trajnime dhe mobilitete është një tjetër tregues i përpjekjes për shtimin e aftësive të tyre në sferën e mësimdhënies.</p> <p>GVJ, po ashtu, vërejtë se në departament funksionon në vijimësi angazhimi i studentëve në programet Erasmus (universitete spanjolle kryesisht), ku janë dërguar 4 studentë në këtë kuptim, si dhe prej 9 vitesh organizohet konferenca studentore periodike në rang fakulteti. <i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 20; Ev. Aneks 24; Ev. Aneks 43; Ev. Aneks 73)</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UAMD i përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë edhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve nga ana e tyre. Dy herë në vit zhvillohen pyetësorë me studentët, për të parë efektivitetin e bashkëpunimit lektor-student, mënyrën e kryerjes dhe drejtimit të procesit mësimor, si dhe ndërveprimin e përbashkët. Po ashtu, përmes rregullores së Fakultetit të Biznesit është përcaktuar mekanizmi i trajtimit të ankesave të studentëve.</p> <p>Përmes këtyre masave synohet përmirësimi i mëtejshëm i organizimit të procesit të mësimdhënies, përmes plotësimit të pyetësorëve të vlerësimit nga studentët, për të cilët ruhet anonimat. Mendimet dhe sugjerimet që studentet parashetrojnë në pyetësorë, kanë shërbyer për vlerësimin e punës së personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p> <p>GVJ konstatoi nga biseda në institucion se studentët përfshihen edhe në udhëtime të ndryshme, si tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si dhe kontaktet me ekspertë të ndryshëm e faktorë lokalë dhe ndërkombëtarë. Gjatë pandemisë së Covid-19 janë realizuar takime me alumni-t, për këtë qëllim.</p> <p><i>(Ev. Aneks 2; Ev. Aneks 8; Ev. Aneks 40; Ev. Aneks 51; Ev. Aneks 66)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura / njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ vëren se në institucionin është ngritur struktura organizative për promovimin në vijimësi të përmbushjes së standardeve të cilësisë në mësimdhënie, duke koordinuar punën me njësinë kryesore e njësinë bazë, për të mundësuar efikasitetin në procesin e mësimdhënies. Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, si dhe përgjegjësitë e tyre për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë::</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) - Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjSBC Fakulteti) - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB, Bch. / GVB.MP. / GVB.Msc.) - Koordinatorët e Programeve (Ko. Bch. / Ko. MP / Ko. Msc.) <p>Këto struktura janë në koordinim të përhershëm në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre me qëllimin e përbashkët koordinimin dhe bashkërendimin e veprimtarive për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. NjSBC pranë Fakultetit të Biznesit realizon raportin e vlerësimit të brendshëm për fakultetin, mbështetur edhe në manualin për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, ku analizohet puna e çdo njësie bazë.</p>

	<p>Përfshirja e personelit akademik dhe ndihmësakademik, krahas studentëve në programin e shkëmbimit Erasmus+ shërben për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të shërbimeve mbështetëse, si dhe të përmirësimit cilësor të ofrimit të programit të studimit. Personeli akademik është përfshirë në trajnime të ndryshme, si në kuadër të pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, ashtu dhe në kuadër të mobiliteteve të kryera në institucione homologe, çka duhet të ndikojë në përmirësimin e mësimdhënies, përmes përdorimit edhe të metodave të reja ndërvepruese të mësimdhënies. (Ev. Aneks 8; Ev. Aneks 11; Ev. Aneks 34.1; Ev. Aneks 37; Ev. Aneks 73; Ev. Aneks 99; Ev. Aneks 109)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit mbështeten tek metodat klasike, siç janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e orët e hapura, etj., duke i kushtuar vëmendje edhe praktikës profesionale, pasi aftësimi praktik i studentëve lidhet me zbatimin konkret në praktikë të njohurive teorike. Personeli akademik ndërthur metoda pune në përshtatje me nevojat e studentëve. Duke vendosur marrëdhënie reciproke përmes komunikimit verbal, si dhe përmes komunikimit elektronik, mes personelit akademik e studentëve.</i></p> <p><i>Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, për mbështetjen e personelit akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, përmes përfshirjes në mobilitete të karakterit të mësimdhënies në universitete të huaja, si dhe në veprimtari trajnuese</i></p> <p><i>Në procesin e mësimdhënies në programin MPGTSH, si dhe kualifikimet e tyre) GVJ vlerëson kompetencën e mjaftueshme të personelit akademik në fjalë, në përputhje me përcaktimet e rregullores së programit të studimit. Tregues i përpjekjes për shtimin e kompetencës së personelit akademik janë edhe kualifikimet e tija në fushat e kërkimit, si dhe përvoja e krijuar në kërkimin shkencor, siç dëshmojnë CV-t e gjithsecilit dhe formularët e kërkimit shkencor në rang departamenti..</i></p> <p><i>Në programin e studimit MPGTSH, personeli akademik i angazhuar si titullar lënde ka së paku gradën shkencore "Doktor". Po ashtu, edhe personeli akademik PAK është kryesisht me gradën shkencore Dr..</i></p> <p><i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UAMD i përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë edhe mundësinë e trajtimit të ankimeve nga ana e tyre</i></p> <p><i>GVJ vëren se në institucioni është ngritur struktura organizative për promovimin në vijimësi të përmbushjes së standardeve të cilësisë në mësimdhënie, duke koordinuar punën me njësinë kryesore e njësinë bazë, për të mundësuar efikasitetin në procesin e mësimdhënies. NjSBC pranë Fakultetit të Biznesit realizon raportin e vlerësimit të brendshëm për fakultetin, mbështetur edhe në manualin për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, ku analizohet puna e çdo njësie bazë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se njësisia bazë që zbaton programin e studimit MPGTSH ndjek dhe realizon procesin e vlerësimit të njohurive e dijeve, si dhe të aftësive profesionale që studenti ka përfutuar gjatë vitit, duke u bazuar tek rregullorja e UAMD-së, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe rregullorja e programit të studimit. Ky proces mbështetet në sistemin e vlerësimit me 10 nota. Kompozimi i formës së vlerësimit është i ndarë tre pjesë: vlerësimi i ndërmjetëm që kryhet në përfundim të 7-8 javëve të para dhe që është 40%, vlerësimi i detyrave të kursit/projekteve, i cili realizohet para kryerjes së provimit përfundimtar, është 10%, si dhe vlerësimi përfundimtar (provimi i lëndës) që ka pjesën e luanit dhe përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm. Skema e vlerësimit është pjesë përbërëse e syllabuse-ve mësimore dhe miratohet në fillim të vitit akademik nga përgjegjësi i njësisë bazë. Në orën e fundit të mësimin, përpara provimit përfundimtar, titullari i lëndës i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provim (që realizohet me shkrim), në bazë të mungesave të kryera nga ky i fundit, si dhe të pikëve të marra në vlerësimin e ndërmjetëm e në detyrën e kursit. (Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 21)</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për realizimin e këtij kriteri, nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vëren se në fillim të çdo lënde titullari i saj i njofton studentët lidhur me programin e saj, literaturën bazë e atë ndihmëse, si dhe mënyrën e vlerësimit. Ai u bën të ditur studentëve strukturën e lëndës dhe të vlerësimit, sipas përcaktimeve në syllabus-et e lëndëve, duke i njohur ata me faktin që vlerësimi bëhet me dy pjesë: ai i ndërmjetëm, në fund të javës së 7-të ose të 8-të dhe ai provimi përfundimtar, në fund të mbylljes së lëndës (java e 15-16-të), duke mos lënë pas dore faktin se 10% të vlerësimit e mbulon realizimi i detyrave /projektet e kursit. Po ashtu, studentët marrin dijeni për faktin që zbatohet sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit Clean Score, që është bërë i mundur nga marrëveshja e UAMD me AADF. (Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 139)</p>

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret e UAMD, të Fakultetit të Biznesit, si dhe në atë të programit të studimit MPGTSH, janë përcaktuar mënyrat e format e kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të dijeve e aftësive që kanë përvetësuar studentët gjatë leksioneve teorike dhe aftësimit praktik, që kulmon me vlerësimin përfundimtar. Në rastin e provimit, komisioni përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me zëvendësdekanin për anën mësimore dhe miratohet nga dekani. Në sezonin e riprovimeve, drejtuesi i njësisë bazë krijon komisionet e provimeve me 3 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, ndërsa anëtarët e tjerë janë të angazhuar në mbulimin e fushave të përafërta të studimit. Vlerësimi i dijeve dhe i aftësive zhvillohet me shkrim, në prani të një asistent lektori, që vëzhgon procesin e testimit, sipas përcaktimeve në rregulloren e UAMD-së dhe atë të Fakultetit të Biznesit. Në rastet kur mund të konstatohen parregullsi, në shkelje të rregullores së zhvillimit të provimeve, është parashikuar ndërprerja e provimit, duke plotësuar më pas procesverbalin për parregullsitë e konstatuara. (Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 21; Ev. Aneks 88)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë që zbaton programin e studimit MPGTSH ndjek dhe realizon procesin e vlerësimit të njohurive e dijeve, si dhe të aftësive profesionale që studenti ka përfituar gjatë vitit, duke u bazuar tek rregullorja e UAMD-së, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe rregullorja e programit të studimit. Ky proces mbështetet në sistemin e vlerësimit me 10 nota, ku vlerësimi i ndërmjetëm, pas 7-8 javëve të para, zë 40%, vlerësimi i detyrave të kursit/projekteve zë 10%, si dhe provimi i lëndës, që zë 50% të vlerësimit të përgjithshëm. Skema e vlerësimit është pjesë përbërëse e syllabuse-ve. Titullari i çdo lënde njofton studentët lidhur me programin e saj, literaturën bazë e atë ndihmëse, si dhe mënyrën e vlerësimit, ku hyn edhe ai i testimit dhe vlerësimit Clean Score. Në rastin e provimit, komisioni përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me zëvendësdekanin për anën mësimore dhe miratohet nga dekani. Në sezonin e riprovimeve, drejtuesi i njësisë bazë krijon komisionet e provimeve me 3 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, ndërsa anëtarët e tjerë janë të angazhuar në mbulimin e fushave të përafërta të studimit. Në rastet kur mund të konstatohen parregullsi, është parashikuar ndërprerja e provimit, duke plotësuar më pas procesverbalin për parregullsitë e konstatuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III. 3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabus-et e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga biseda në institucion, GVJ vëren se format kryesore të vlerësimit të dijeve të përfuara nga studenti janë testimi i ndërmjetëm; detyra e kursit/projekti dhe provimi final. Pedagogu i lëndës/modulit i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provimin final, mbështetur jo vetëm tek pikët që ai ka marrë në vlerësimin e ndërmjetëm, por edhe tek vlerësimi i detyrës së kursit, përpara mbajtjes së provimin përfundimtar, që organizohet me shkrim, siç parashihet në syllabus-e.</p> <p>Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim, ku u garantohet vlerësim objektiv, vetëm kur ai plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 21; Ev. Aneks 138)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në programin e studimit të ciklit të dytë MPTSH përdoret sistemi elektronik i testimit dhe i vlerësimit Clean Score, që gjen zbatim si rrjedhojë e bashkëpunimit të institucionit me AADF dhe projektit rrjedhojë e këtij bashkëpunimi. <i>(Ev. Aneks 139)</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabus-in dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve e aftësive realizohen në përputhje përcaktimet në rregulloret institucionale. Në rastin e provimit, komisioni përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me zëvendësdekanin për anën mësimore dhe miratohet nga dekani. Në sezonin e riprovimeve, drejtuesi i njësishë bazë krijojnë komisionet e provimeve me 3 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, ndërsa anëtarët e tjerë janë të angazhuar në mbulimin e fushave të përafërta të studimit. Vlerësimi i dijeve dhe i aftësive zhvillohet me shkrim, në prani të një lektori asistent, që vëzhgon procesin e testimit, sipas përcaktimeve në rregulloren e UAMD-së dhe atë të Fakultetit të Biznesit. Në rastet kur mund të konstatohen parregullsi, në shkelje të rregullores së zhvillimit të provimeve, është parashikuar ndërprerja e provimit, duke plotësuar më pas procesverbalin për parregullsitë e konstatuara. <i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 21; Ev. Aneks 88)</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, GVJ vëren se vlerësimi i njohurive e dijeve shoqërohet me komente e feedback në formë sqarimesh e këshillash rekomanduese, për përmirësimin e punës së studentit në procesin e të nxënës. Në auditor ky proces reflektimi realizohet në orën pas kryerjes së testimit, ku studentët njihen me pasaktësitë në drejtim të zgjidhjes së pyetjeve të caktuara të testit, si dhe njihen njëkohësisht edhe me zgjidhjen e saktë. Titullari i lëndës bën korrigjimin e fletëve të testit, si dhe komente verbale, sipas rastit. Në kryerjen e vlerësimit të detyrës së kursit/projektit, krahas komenteve verbale bëhet edhe shpjegimin për paqartësitë që mund të lindin procesit, në mënyrë që këto vërejtje t'u vlejnjë studentëve në të ardhmen. <i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 21)</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të aplikimit, GVJ konstaton se personeli akademik zbaton me korrektësi bazën ligjore lidhur me plagjiaturën në kërkimin e realizuar nga studentët dhe politikën e tolerancës zero në kopjimin në provime, mbështetur në rregulloret përkatëse, në nivel institucional e më gjerë. Siç përcaktohet në rregulloret përkatëse, studentët lejohen të zhvillojnë provimet vetëm me mjet identifikimi personal dhe gjatë provimit pedagogu asistohet nga një lektor. Provimi nuk autorizohet të nisë, nëse nuk është i disponueshëm asistenti. Në ambientet e provimit nuk lejohen të hynë personel tjetër i paautorizuar, me përjashtim të autoriteteve drejtuese që mund të kryejnë vëzhgimin e zhvillimit të provimit. Gjatë kryerjes së provimit, studentët ndalohen të mbajnë celularë. Nëse studentët shkelin normat për zhvillimin e provimit, ata përjashtohen nga kryerja e provimit, pasi plotësohet procesverbali që i bashkëlidhet fletës së provimit.</p> <p>GVJ u njoh me faktin se çdonjëri prej lektorëve ndjek përkujdeset për plagjiaturën në detyrat e kursit, përmes programeve individuale, pasi për këtë nuk ka një sistem të IT në Departamentin e Turizmit.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 21)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ vëren se aktualisht në program janë vetëm 4 studentë, ndaj edhe realizimin e kërkesave të këtij kriteri ky departament e ka të lehtë. Përgjigjet për rezultatet e kontrollit të studentët i marrin në kohë. Rezultatet e provimit pasqyrohen në procesverbalet përkatëse jo më vonë se pesë ditë, për provimin e parë të ndërmjetëm dhe brenda për një afat 72-orësh, për provimin përfundimtar. Provimet zhvillohen me shkrim.</p> <p><i>(Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 21; Ev. Aneks 69)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se pasi kryhet vlerësimi i provimit, zhvillohet procesi i transparencës me studentët në auditor, ku çdo student njihet me vlerësimin personal dhe konsulton fletën e testit me pedagogun përkatës, për t'u sqaruar mbi gabimet e bëra dhe zgjidhjen e duhur. Pasi kryhet kjo transparencë, vlerësimet pasqyrohen në sistemin Pitagora, prej nga gjenerohen dhe procesverbalet. Kur studenti shfaq pakënaqësi ndaj procesit të vlerësimit nga pedagogu, ai ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e bërë. Nëse rezultateve të provimit nuk jepen në kohë, siç parashihet në rregullore, pedagogun i lëndës ngarkohet me përgjegjësi. Provimet dorëzohen në sekretarinë mësimore, ku ruhen sipas afateve kohore të përcaktuara në rregullore. Një kopje e procesverbaleve ruhet pranë departamentit, për çdo rast.</p> <p><i>(Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 21)</i></p>

<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ vëren se është parashikuar e drejta e ankimit, sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, në rastet kur studenti ka rezerva ndaj vlerësimit. Pas paraqitjes se ankimit tek drejtuesi i njësisë kryesore, sipas rregullores së provimeve, fillon të ndiqet procedura për trajtimin e ankimit. Në rastet kur gjykohet se ankimi mund të zgjidhet nga përgjegjësi i njësisë bazë, ai i përcillet këtij të fundit, i cili ngre një komision për rivlerësim të tezës dhe ia njofton rezultatet, si studentit, ashtu dhe pedagogut. Kur rezultati i gjykimit konsiston në ndryshim të vlerësimit, kjo pasqyrohet në një procesverbal të dytë. Procedura e ndjekur për shqyrtimin e ankimit depozitohet në dekanat, si dhe në arkivin e departamentit. (Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 21)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format kryesore të vlerësimit të dijeve të përfuara nga studenti janë testimi i ndërmjetëm; detyra e kursit/projekti dhe provimi final. Në programin e studimit të ciklit të dytë MPGTSH përdoret, po ashtu, edhe sistemi elektronik i testimit e i vlerësimit Clean Score. Provimi zhvillohet me shkrim, në prani të një lektori asistent. Nëse konstatohen parregullsi në zhvillimin e provimeve, parashihet ndërprerja e provimit, me procesverbal. Siç përcaktohet në rregulloret përkatëse, studentët lejohen në provim vetëm me mjet identifikimit personal. Gjatë provimit studentëve u ndalohen celularët. Pasi kryhet vlerësimi i provimit, çdo student njihet me vlerësimin personal dhe konsulton fletën e testit me pedagogun përkatës. Më pas vlerësimet pasqyrohen në sistemin Pitagora, prej nga gjenerohen dhe procesverbalet. Në rastet kur studenti ka rezerva ndaj vlerësimit atij i është garantuar e drejta e ankimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III. 4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në kurrikulën e programit të studimit MPGTSH janë parashikuar lëndë që u mundësojnë studentëve thellimin e dijeve e të marrin njohuri të mëtejshme për njohjen e burimeve natyrore, kulturore, arkeologjike, së bashku me njohuritë drejtuese dhe marketuese të destinacioneve turistike, duke krijuar parakushtet që studentët të aftësohen profesionalisht për udhërrëfyes të formuar me aftësi e kompetenca, që të operojnë në fushën e guidës/udhërrëfimit turistik. Aftësimi përmes praktikës profesionale dhe ushtrimi i terminologjisë së fushës në gjuhë të huaj, pajisin studentin me njohuritë e nevojshme për të konkurruar në tregun turistik. Lëndët synojnë të formojnë ekspertë dhe specialistë të mirëfilltë si guidë turistike, të pajisur me shprehitë dhe aftësitë e interpretimit të vlerave të trashëgimisë natyrore, krahas me ato kulturore e shpirtërore të vendit tonë, duke shtuar mundësitë për karrierë profesionale në drejtim e tureve dhe formimit të udhërrëfyesve turistikë profesionistë. Zhvillimi i aftësive teknike, konceptuale dhe ndërpersonale, bën të mundur punësimin e specialistëve guida/udhërrëfyes të ardhshëm në bizneset turistike të sektorit privat e atij publik, për guida muzeore, si dhe profesioniste të vetëpunësuar. Praktika profesionale në kurrikul synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve, në drejtim të drejtimit të tureve, mundësi për krijimin e itinerareve turistikë, etj. Kësisoj, synohet formimi i specialistëve të aftë në nivel vendimmarrje, për drejtimin e tureve turistike, si dhe për udhërrëfyes e interpretë profesionistë, përmes marrjes së informacionit bazë teorik në nivel të thelluar, të ndërthurur edhe me aftësimin e kompetencave profesionale. (Ev. Aneks 57; Ev. Aneks 63; Ev. Aneks 64)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ vëren se në programin e studimit MPGTSH i është kushtuar vëmendje brumosjes të studentëve me njohuri të fushve humane e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit dhe përvetësimin të teknologjisë së informacionit. Në planin mësimor të MPGTSH janë të përfshira lëndë si “Komunikim dhe marketing i turizmit”, “Teknika dhe planifikimi i guidave turistike”, “Guida Natyrore e Kulturore e Shqipërisë”, “Trashëgimia Natyrore e Kulturore dhe menaxhimi saj”, “Gjuhe e huaj”, etj. Këto lëndë i aftësojnë studentët të jenë më konkurrues në tregun e punës, të krijojnë aftësi komunikuese të mira, të aftësohen si guida të ardhshme profesionistë, të rrisin kompetencat e të punuarit në grup, etj. (Ev. Aneks 63)</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruese GVJ konstaton se në përfundim të çdo lëndë, aftësitë e kompetencat e fituara nga studentët gjatë realizimit të saj shqyrtohen në analizën vjetore të punës së departamentit, duke iu referuar nivelit të kalueshmërisë dhe cilësisë së arritur në përfundim të kurseve. Pasurimi i informacioneve të përfshira në literaturën e përdorur bazë e mbështetëse, si dhe përditësimet nga çdo pedagog me literaturën bashkëkohore të fushës, realizohen në fillim të çdo viti akademik, duke kryer ndryshime pozitive në syllabus-et, lidhur me literaturën e përdorur, duke synuar rritjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe pajisjen e studentëve me kompetencat më të mira. Ky përditësim ndodh në fillim të</p>


	<p>çdo viti akademik, me miratimin nga përgjegjësi i njësisë bazë.</p> <p>Pedagogu orienton studentët në përfundim të lëndës, duke vënë në pah çështjet më të rëndësishme të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse, në formën e ushtrimeve, diskutimeve, analizës së çdo rasti. Këto, zakonisht, realizohen ose në formën e një ore mësimi për përsëritje, në formatin e përmbledhjes së temave kryesore apo çështjeve specifike, ose në formë përmbledhëse, gjatë realizimit të çdo ore mësimore, duke i orientuar studentët me pyetje përgjithëse analizuuese. Analizimi i programit lëndor në këtë kontekst bëhet me qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe orientimin drejt provimit të ndërmjetëm she atij përfundimtar. (Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 38.1; Ev. Aneks 67)</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit MPGTSH, lëndët përbërëse i ka të ndërthurura për të mbrytur studentët me kompetenca që nevojiten në tregun e punës. Kur ndodhi tërmeti i nëntorit 2019, apo gjatë pandemisë së Covid, në vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 mësimdhënia u krye tërësisht online, nga semestri i dytë i vitit 2019-2020, deri përgjatë vitit akademik 2020-2021, megjithatë nuk mungoi përkushtimi i personelit akademik ndaj studentëve. Në vitin akademik 2021-2022, kur nisi të përdorej auditori, ia dolën që vizitat studimore të kryheshin duke respektuar rregullat anti-Covid. Për këtë qëllim trupa akademike e departamentit të turizmit ka zhvilluar praktika të mira pune komunikuese lidhur me diskutimin e problematikave dhe nivelin e vendimmarrjes, për një proces mësimdhënës sa më efikas. Personeli akademik promovon përpjekjet pozitive dhe idetë krijuese të studentëve, me përfshirje në veprimtari dhe nisma për thellimin e kërkimit shkencor. Po ashtu, studentët përfshihen në programe mobiliteti. Personeli akademik i orienton ata në përzgjedhjen e temave të diplomave, si dhe i asiston e i mbështet në zhvillimin e tyre.</p> <p>Qysh nga viti 2010, UAMD, ka vënë në përdorim një sistem të integruar të menaxhimit të studentëve, që mundëson një menaxhim të integruar të të dhënave për programet, personelin akademik dhe studentët. Në nivel institucioni, UAMD e ka përdorur shumë më herët teknologjinë e sistemit Aula, duke nisur nga vitit 2010.</p> <p>GVJ u njoh me faktin se institucioni realizon një model rankimi të departamenteve në bazë të pjesëmarrjes në projekte, si dhe botimeve të realizuara, përmes një vetëdeklarimi që më pas shqyrtohet deri në nivel dekanati.</p> <p>(Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1; Ev. Aneks 63; Ev. Aneks 73; Ev. Aneks 82; Ev. Aneks 85; Ev. Aneks 106; Ev. Aneks 113; Ev. Aneks 114)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në programin e studimit MPGTSH, që është në vitin e katërt të zbatimit të tij, përdoren forma alternative të mësimdhënies, duke realizuar në auditor orë leksioni të hapura me specialistë të fushës, të ftuar për trajtimin e tematikave të veçanta të zhvillimeve dinamike në këtë profesion. Njëkohësisht, gjatë ekspeditave në terren, kryhen leksione të hapura edhe nga specialistë të ftuar, të ardhur nga institucionet pritëse, apo bashkëpunuese. Kjo formë mësimdhënie rrit aftësinë komunikuese të</p>

	<p>studentëve në lidhje me menaxhimin e situatave të ndryshme praktike, drejtpërdrejt, në kontakt me profesionin e tyre të ardhshëm.</p> <p>GVJ u njoh me faktin se në maj të vitit 2023 është ftuar një lektor i huaj për turizmin (menaxhimin dhe administrimin e tij). Gjatë leksioneve studentëve u jepen të dhëna për turet virtuale, lojërat digjitale etj.</p> <p><i>(Ev. Aneks 81; Ev. Aneks 92; Ev. Aneks 95)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Biznesit ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të huaja, biznese dhe institucione publike të cilat mundësojnë, veç të tjerave, edhe kryerjen e praktikave profesionale të studentëve pranë tyre. Në programin e shkëmbimit Erasmus+, krahas personelit akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë për rritjen e cilësisë të mësimdhënies dhe përmirësimit të programit të studimit, janë përfshirë edhe studentët. Institucioni mbështet e promovon idetë inovative, përfshirjen në studime të avancuara, që mundësohet nëpërmjet edhe bashkëpunimit të krijuar me institucione bashkëpunuese në kuadër të programeve të studimit Credit Mobility Erasmus+ apo Ceepus. Sipas një praktike të përcaktuar nga rektorati, Departamenti i Turizmit angazhon lektorë të ftuar për mbajtjen e leksioneve të hapura me studentët, në varësi të specifikave të lëndëve. Organizimi i përvitshëm i konferencave studentore të Fakultetit të Biznesit është një mundësi shumë e mirë promovimi drejt thellimit të kërkimit shkencor, ndërsa promovimi me stimuj nxitës i punimeve më të mira të studentëve, nën mbështetjen edhe të pedagogëve, janë forma pune që nxisin aktivizimin shumëdimensional të studentëve drejt formimit profesional të tyre.</p> <p><i>(Ev. Aneks 32)</i></p>

Konkluzione	<p><i>Kurrikula e programit të studimit MPGTSH përmban lëndë që u mundësojnë studentëve thellimin e dijeve e të marrin njohuri të mëtejshme për njohjen e burimeve natyrore, kulturore, arkeologjike, së bashku me njohuritë drejtuese dhe marketuese të destinacioneve turistike. Aftësimi përmes praktikës profesionale dhe ushtrimi i terminologjisë së fushës në gjuhë të huaj, pajisin studentin me njohuritë e nevojshme për të konkurruar në tregun turistik. Pasurimi i informacioneve të përfshira në literaturën e përdorur bazë e mbështetëse, si dhe përditësimet nga çdo pedagog me literaturën bashkëkohore të fushës, realizohen në fillim të çdo viti akademik, duke kryer ndryshime pozitive në syllabus-et, lidhur me literaturën e përdorur, duke synuar rritjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe pajisjen e studentëve me kompetencat më të mira.</i></p> <p><i>Pedagogu orienton studentët në përfundim të lëndës, duke vënë në pah çështjet më të rëndësishme të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse, në formën e ushtrimeve, diskutimeve, analizës së çdo rasti. Personeli akademik i departamentit të turizmit (DT) bashkëpunon ngushtë me studentët, duke promovuar përpjekjet pozitive dhe idetë e tyre kreative, përmes përfshirjes në veprimtari krijuese dhe nisma për thellimin e kërkimit shkencor, siç është pjesëmarrja në konferencat e përvitshme studentore të organizuara nga fakulteti i Biznesit. Fakulteti i Biznesit ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të huaja, biznese dhe institucione publike të cilat mundësojnë, veç të tjerave, edhe kryerjen e praktikave profesionale të studentëve pranë tyre. Organizimi i përvitshëm i konferencave studentore të Fakultetit të Biznesit është një mundësi shumë e mirë promovimi drejt thellimit të kërkimit shkencor, ndërsa promovimi me stimuj nxitës i punimeve më të mira të studentëve, nën mbështetjen edhe të pedagogëve, janë forma pune që nxisin aktivizimin shumëdimensional të studentëve drejt formimit profesional të tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga bisedat në institucion, GVJ vëren se në Fakultetin e Biznesit diplomimi studentëve bëhet përmes mbrojtjes së një punimi diplome. Institucioni harton procedurë të posaçme për realizimin e mbrojtjes së diplomës para diplomimit të studentëve, mbështetur në Rregulloren e Diplomimeve në FB, në rregulloren e Tezës së Diplomës, si dhe në rregulloren e programit të studimit MPGTSH dhe e bën atë publike në webfaqen e FB-së, por edhe përmes njoftimeve të vendosura në stendat e sekretarisë mësimore,

	përgjegjëse për ciklin e dytë të studimeve. <i>(Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1; Ev. Aneks 78)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ vëren se Departamenti i Turizmit, që ofron programin MPTGSH, i asiston studentët për t'u mundësuar kryerjen me sukses të mbrojtjes së diplomës, përmes personelit akademik dhe administrativ. Siç parashikohet në aktet rregullatore përkatëse, në përmbylljen e këtij qëllimi ky departament vë në dispozicion të studentëve të gjithë materialet, udhëzimet dhe informacionet e duhura. GVJ u njoh me faktin se risitë e sjella nga konferencat shkencore mbi turizmin, që organizon Fakulteti i Biznesit, ku veprimtaria e studentëve përdoret si shembull konkret. Studentët kanë edhe një revistë të tyre, të titulluar "Konferenca Studentore". <i>(Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se mbrojtja e diplomës në programin e studimit MPTGSH nuk është paraparë të bëhet përmes një provimi përfundimtar, por realizohet përmes punimit të temës së diplomës (mikrotezës). Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision që përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë, që miratohet nga dekani pas propozimit të departamentit përkatës. <i>(Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 10.1)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ vëren se udhëheqësi i temës së diplomës e udhëzon dhe e ndihmon studentin në përcaktimin e temës së diplomës dhe përgatitjen e saj, mbështetur në përcaktimet e Rregullores së Tezës së Diplomës në Fakultetin e Biznesit Ai së bashku me studentin përcaktojnë afatet për realizimin e detyrimeve gjatë sezonit të caktuar për mbrojtjen e diplomës, të cilat duhet të respektohen rigorozisht nga ky i fundit, çka realizohet përmes një grafiku për konsultimin dhe kontrollin e punës së bërë nga studentit. Po ashtu, edhe personeli akademik i departamentit i ndihmon studentët me sqarime në lidhje me organizimin e materialit, sipas fushave që ata mbulojnë. Në bashkëpunim me studentin, udhëheqësi harton strukturën e temës së mikrotezës dhe përzgjedh metodikën e studimit për realizimin e temës. Studenti asistohet prej udhëheqësit qysh prej fillimit të kërkimit e deri në shkrimin e mikrotezës, duke qenë edhe garanti për cilësinë e punimit dhe origjinalitetit të saj. Udhëheqësi i temës harton një raport përmbyllës në përfundim të punimit, nëpërmjet të cilit ai miraton ose jo punimin e diplomës dhe ia paraqet atë komisionit të diplomës. <i>(Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1; Ev. Aneks 10.2)</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Personeli akademik i Departamentit të Turizmit, në përputhje dhe me fushat e studimit dhe kualifikimit që zotëron, asiston studentët për përmbylljen dhe përpunimin e të dhënave, sipas fushës së interesit dhe kërkimit për realizimin e temës së diplomës. <i>(Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së	Nga dokumentacioni shoqërues dëshmohet se në përfundim të paraqitjes për mbrojtjen e diplomës, studenti vlerësohet me notë nga komisioni. Nota për mikrotezën llogaritet si mesatare e të gjitha vlerësimeve të anëtarëve të komisionit. <i>(Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1)</i>

punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.									
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se studentët, në përfundim të studimeve, pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASR. Në Fakultetin e Biznesit të UAMD, për programin e studimit të ciklit të dytë MPTGSH, që i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Guidë Turistike Shqiptare”. Po ashtu, në përfundim të studimeve, me kërkesën e tij, studentit i mundësohet kopje e plotë e programit të studimit të zhvilluar. (Ev. Aneks 10; Ev. Aneks 10.1; Ev. Aneks 10.2)								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përputhje me përcaktimet ligjore institucioni kryen praktikat e duhura për ruajtjen e dokumentacionit, arkivimin dhe dhënien e informacioneve, kur kërkohen nga të interesuarit. (Ev. Aneks 5; Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 9, Ev. Aneks 54)								
Konkluzione	<i>Në Fakultetin e Biznesit, Departamenti i Turizmit i asiston studentët për t'u mundësuar kryerjen me sukses të mbrojtjes së diplomës (mikrotezës). Vlerësimi i diplomës bëhet me notë nga një komision me jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Udhëheqësi i mikrotezës e udhëzon dhe e ndihmon studentin në përcaktimin e temës së diplomës dhe përgatitjen e saj dhe afatet për realizimin e detyrimeve gjatë sezonit të caktuar për mbrojtjen e diplomës. Në përfundim të paraqitjes për mbrojtjen e diplomës, studenti vlerësohet me notë nga komisioni, e cila llogaritet si mesatare e të gjitha vlerësimeve të anëtarëve të komisionit. Në përfundim studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. Për programin e studimit, lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Guidë Turistike Shqiptare”. Po ashtu, në përfundim të studimeve, me kërkesën e tij, studentit i mundësohet kopje e plotë e programit të studimit të zhvilluar.</i>								
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 1429 798 1507">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="798 1429 1002 1507">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1002 1429 1246 1507">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1246 1429 1471 1507">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 1507 798 1563"></td> <td data-bbox="798 1507 1002 1563"></td> <td data-bbox="1002 1507 1246 1563"></td> <td data-bbox="1246 1507 1471 1563">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse i garantojnë programit të studimit MPGTSH mjedise të mjaftueshme e të përshtatshme për realizmin e praktikës profesionale, në bashkëpunim edhe me institucione mbështetëse, për shkak të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar me to. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me Agjencinë e Zonave të Mbrojtura, që ndihmon në ofrimin e mjediseve në terren dhe në pika turistike. Studentët kryejnë praktikën 3-mujore në institucione publike, apo biznese private, ku aftësohen sipas specifikave në menaxhimin dhe drejtimin tureve, hartimin e itinerareve turistike, apo dhe si udhërrëfyes turistik. Në kuadër të ambienteve të brendshme, UAMD ka investuar për blerjen e mjeteve të ndryshme audiovizive dhe kompjuterë, çka i shërben përmirësimit të rrjetit të brendshëm, në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës në ndihmë të procesit të mësimdhënies, dhe në funksion të përmirësimit të mësimdhënies. (Ev. Aneks 32; Ev. Aneks 34; Ev. Aneks 35; Ev. Aneks 42; Ev. Aneks 42.1; Ev. Aneks 74)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>-----</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>GVJ konstaton se praktika profesionale në programin e studimit MPGTSH, e cila realizohet në përputhje me përcaktimet ligjore, me kohëzgjatje 3-mujore, vlerësohet me notë dhe ka një ngarkesë prej 3 kredite ECTS, në përfundim të saj bashkëshoqërohet me dokumentacionin përkatës të mentorëve, lidhur me aktivizimin e studentit dhe kompetencat profesionale të fituara prej gjatë praktikës. (Ev. Aneks 6; Ev. Aneks 7; Ev. Aneks 10.3; Ev. Aneks 64)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësitë përgjegjëse i garantojnë programit të studimit MPGTSH mjedise të mjaftueshme e të përshtatshme për realizmin e praktikës profesionale, në bashkëpunim edhe me institucione mbështetëse, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, siç është bashkëpunimi me Agjencinë e Zonave të Mbrojtura. Gjatë praktikës 3-mujore në institucione publike, apo biznese private, studentët aftësohen sipas specifikave në menaxhimin dhe drejtimin tureve, hartimin e itinerareve turistike, apo dhe si udhërrëfyes turistik. Në kuadër të ambienteve të brendshme, UAMD ka investuar për blerjen e mjeteve të ndryshme audiovizive dhe kompjuterë etj., në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies. Praktika profesionale vlerësohet me notë, ka një ngarkesë prej 3 kredite ECTS dhe në përfundim të saj bashkëshoqërohet me dokumentacionin përkatës të tutorëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga vëzhgimet në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB-në dhe materialet plotësuese, GVJ konstaton se të dhënat mbi rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) apo dhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ gjenden të arkivuara dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme Njerëzore të rektoratit të UAMD. Departamenti i Turizmit pjesë e Fakultetit të Biznesit, të UAMD-së në përputhje me detyrat dhe kompetencat e tij si Njësi Bazë të përcaktuara dhe në Statutin e UAMD, (Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 10) në Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe në Rregulloren e Departamentit të Turizmit, ka parashikuar organizimin e grupe mësimore kërkimore-shkencore, sipas programit të studimit. Personeli akademik (PAE dhe PAK) i angazhuar për realizimin e programit të studimit ka plotësisht nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e mësimdhënies, në përputhje me rregulloren e programit të studimit. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi ka angazhuar si staf akademik së paku me gradën Doktor, pedagogë, titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të dytë Master Profesional. GVJ konstaton se në përputhje me këtë angazhim rezulton se në këtë program studimit janë angazhuar një personel akademik me tituj e grada:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2020-2021 7 PAE dhe 2 PAK, prej të cilëve: <ul style="list-style-type: none"> • PAE 7 (shtatë) staf akademik me gradën Doktor dhe 2 (dy të kategorisë “Profesor” (Prof. Asoc.); • PAK 1 (një) staf akademik i kategorisë “Profesor” (Prof.) dhe 1 (një) me gradën shkencore “Doktor” - Viti akademik 2021-2022 6 (gjashtë) PAE dhe 1 (një) PAK, prej të cilëve: <ul style="list-style-type: none"> • PAE 5 (pesë) staf akademik me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 (një) staf akademik i kategorisë “Profesor” (Prof. asoc.) • PAK 1 (një) i kategorisë Profesor (Prof.) - Viti akademik 2022-2023 7 PAE dhe 2 PAK, prej të cilëve: <ul style="list-style-type: none"> • PAE 6 (gjashtë) me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 (një) personel akademik i kategorisë “Profesor” (Prof. asoc.). • PAK 1 (një) i kategorisë “Profesor” (Prof.) dhe 1 (një) me gradën shkencore “Doktor”. <p>Sipas konstatimeve të GVJ ka parë me kujdes dhe të dhënat për personelin akademik të ngarkuar për realizimin e programit MPGTSH, të cilat departamenti i Turizmit i zotëron, pasqyron në mënyrë të</p>

	<p>detajuar përfshirë dhe ndryshimet që pa pësuar personeli akademik efektiv dhe me kontratë gjatë vitit akademik në këtë program studimi. Departamenti i Turizmit në dokumentacionin e tij ka të pasqyruar dhe listën e plotë të personelit akademik (PAE dhe PAK) në çdo semestër, si dhe të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ. Nga konstatimet e GVJ rezultojnë se personeli akademik i ngarkuar për realizimin e këtij programi studimi ka kualifikime në masë të konsiderueshme brenda dhe jashtë vendit, sipas specialiteteve që mbulon dhe në funksion të fushës që mbulon ky program studimi. Stafit akademik i ngarkuar për realizimin e këtij programi studimit pothuajse plotësisht është i specializuar sipas fushave akademike dhe kërkimore, të përgjithshme dhe specifike të tyre, në përputhje me specialitetin e ofruar në programin e studimit MPGTSH, dhe sipas natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë. Kjo është demonstruar edhe në veprimtarinë kërkimore – shkencore, fushat e botimeve të pasqyruara në mënyrë të detajuar në CV e të gjithë stafit të DT., dhe programit të dytë të studimit MPGTSH.</p> <p>Aneks 6, Aneks 6.1, Aneks 7, Aneks 24, Aneks 23, Aneks 11, Aneks 20.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga vëzhgimi me kujdes i dokumentacionit të paraqitur në DT dhe nga të dhënat e paraqitura nga GVB, u konstatua nga GVJ se programi i studimit Master Profesional në GTSH është bazuar në strukturimin e tij në përputhje me parashikimet ligjore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi si në normën juridike ashtu dhe në ngarkesën mësimore, gjë e cila është shpaloset plotësisht në planin mësimor, sipas ngarkesës në orë dhe kredite në vite akademike sipas semestrave përkatës. Në kuadrin e strukturimit të këtij programi studimi pasqyrohet shtrirja e tij në 1 vit akademik, me 2 semestra dhe 60 kredite. Shtrirja e lëndëve (ngarkesa në orë dhe kreditet (ECTS) për çdo lëndë) përgjatë semestrave të vitit akademik është në përputhje të plotë me strukturimin e këtij programi studimit. GVJ konstaton se ngarkesa mësimore për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimit është shpërndarë në përputhje me rregulloren e DT, FB, dhe Statusin e UAMD, në kuadër të plotësisht të objektivave të programit të studimit në MP GTSH.</p> <p>Viti akademik 2020-2021:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e ngarkesës mësimore e stafit akademik PAE 80.9 % • Përqindja e ngarkesës mësimore të stafit akademik PAK 19.1 % <p>Viti akademik 2021-2022:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e ngarkesës mësimore e stafit akademik PAE 87.9 % • Përqindja e ngarkesës mësimore të stafit akademik PAK 12.1 % <p>Viti akademik 2022-2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e ngarkesës mësimore e stafit akademik PAE 79 % <p>Përqindja e ngarkesës mësimore të stafit akademik PAK 21 %.</p> <p>Aneks 93, Aneks 59, Aneks 5, Aneks 63, Aneks 93, Aneks 25</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton se Departamenti i Turizmit ka burimet, kapacitetet për mbulim të plotë të programeve të studimit që Departamenti ofron, në Fakultetin e Biznesit. Në Departamentin e Turizmit, i cili është përgjegjës për programin e</p>

<p>programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>studimit, ka njëstaf akademik me kohë të plotë i kontraktuar sipas akteve ligjore në fuqi për rekrutimin e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Nga vëzhgimet e kryera në institucion u evidentua se universiteti realizon të gjitha detyrimet ligjore që i lindin nga Kontrata e Punës midis institucionit dhe stafit akademik specifikisht në termat e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gjithashtu në ky staf akademik përvojën e duhur të punësimit dhe zotëron kualifikimet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2020-2021 7 PAE dhe 2 PAK, prej të cilëve: <ul style="list-style-type: none"> • PAE 7 (shtatë) staf akademik me gradën Doktor dhe 2 (dy të kategorisë “Profesor” (Prof. Asoc.); • PAK 1 (një) staf akademik i kategorisë “Profesor” (Prof.) dhe 1 (një) me gradën shkencore “Doktor” - Viti akademik 2021-2022 6 (gjashtë) PAE dhe 1 (një) PAK, prej të cilëve: <ul style="list-style-type: none"> • PAE 5 (pesë) staf akademik me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 (një) staf akademik i kategorisë “Profesor” (Prof. asoc.) • PAK 1 (një) i kategorisë Profesor (Prof.) - Viti akademik 2022-2023 7 PAE dhe 2 PAK, prej të cilëve: <ul style="list-style-type: none"> • PAE 6 (gjashtë) me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 (një) personel akademik i kategorisë “Profesor” (Prof. asoc.). PAK 1 (një) i kategorisë “Profesor” (Prof.) dhe 1 (një) me gradën shkencore “Doktor”. <p><i>Aneks 24, Aneks 25, Aneks 53.1, Aneks 110.1, Aneks 110.2</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e rekrutimit dhe vlerësimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten në departament, sipas përcaktimeve statutoare dhe të legjislacionit mbi arsimin e lartë. GVJ pas verifikimeve të dokumentacionit në institucion, kontakteve dhe të dhënave të RVB evidentoi se UAMD i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e tij, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Kriteret publikohen në WEB zyrtarë të UAMD, Pra shpallja e vendeve vakante bëhet publike. Dekani i FB ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. GJV konstatoi se Zyra e burimeve njerëzore mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punë, konkurseve, etj. (<i>Aneks 110 Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit akademik në UAMD</i>) (<i>Aneks 23-Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit.</i>) Për vlerësimin e kandidaturave ngrihet një komision i posaçëm, i cili shqyrton dosjen e kandidatit të paraqitur dhe zhvillon intervistën me gojë. (<i>Aneks 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i>). GVJ konstatoi se rekrutimi i personelit akademik është mbështetur në aktet e brendshme rregullatore përcaktohet dhe bëhet në përputhje me nevojat e departamentit, përmes publikimit të vendeve vakante dhe kërkesave/kritereve të përgjithshme e specifike për plotësimin e tyre. Departamentit në varësi të strukturës, kualifikimit të</p>

	<p>stafit dhe programeve të studimit që ofron, përcakton dhe kritere të veçanta shtesë për vendet vakante, mbështetur mbi kategorinë e personelit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga rektorati. Të njëjtat kritere dhe kërkesa për punësimin e PAE zbatohen dhe për punësimin e PAK. Konkurrimi është i hapur transparent dhe kryhet sipas një procedure që përcaktohet qartë në statut dhe rregulloret e brendshme të miratuara. <i>Aneks 8, Aneks 7, Aneks 54, Aneks 5, Aneks, 3, 3.1, Aneks, 2</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti i Turizmit, Fakulteti i Biznesit në programin e studimit MPGTSH, angazhon dhe personel akademik, në ndihmë të realizimit të veprimtarisë akademike. Departamenti i Turizmit, si njësi përgjegjëse për zbatimin e këtij program studimi, përmbush të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike dhe ndihmëse të tij për realizimin e proceseve mësimore laboratorike dhe praktika mësimore. Nga verifikimet e kryera nga vizita në institucion dhe nga kontaktet që e takimet që patëm me student dhe ish student të këtij programi studimit konstatoam se, personeli ndihmës akademik për vetë specifikën që mbart ky program është angazhuar në kryerjen e praktikave mësimore në terren, sipas tematikave që ka programit mësimor (syllabuset e lëndëve/moduleve të përcaktuara në plane kalendarike, e në javë mësimore), mbështetur në nivel kualifikimi. <i>Aneks 2, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 22, Aneks 67.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga vëzhgimet në institucion dhe nga të dhënat e paraqitura në dokumentacion GVJ konstaton se të dhënat mbi rekrutimin e personelit akademik (PAE dhe PAK) si dhe të personelit ndihmës akademik dhe administrative të angazhuar në programin e studimit MPGTSH gjenden të arkivuara dhe administrohen pranë Sekretarisë së Burimeve Njerëzore si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të rektoratit të UAMD. Struktura ka përgjegjësinë e mbledhjes, ruajtjes dhe përditësimit të të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program dhe në programet e tjere të studimit. Gjithashtu të dhëna mbahen dhe për personelin ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrative dhe detyrat që realizon. <i>Aneks 25, Aneks 73, Aneks 131.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe duke konsultuar bazën dokumentare që DT ka paraqitur, GVJ konstaton se rang Universiteti dhe Fakulteti, sipas programeve të studimit që ai mbulon ka lidhur një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe, me aktorë të biznesit, vendas apo të huaj të cilët ofrohen për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kurrikulës të studimeve. Departamenti në funksion të realizimit të veprimtarive specifike të organizuara prej tij apo institucione të tjera (konferenca në fushën e turizmit, panaire, guida etj.) në përputhje me programet mësimore ka caktuar dhe personelin akademik të specializuar në këto fusha. Qëllimi i ndërmarrjes dhe</p>



specifike sipas natyrës së programit të studimit.	angazhimit në këto veprimtari është bashkëpunimi me studentët, rritja e numrit të studentëve pjesëmarrës dhe angazhimi i tyre në to. <i>(Aneks 81. Aktivitete te kryera nga lektorët e departamentit të turizmit gjatë viteve 2018-2021) Aneks 31, Aneks 34, Aneks 35, Aneks 129.</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nga vëzhgimi i planit mësimor, rezulton se programi i studimit MP GTSH është strukturuar në mënyrë të tillë semestrin e dytë studentët të realizojnë disiplinën praktikë profesionale (3 ECTS). Në përfundim të saj student vlerësohet në prani të një komisioni vlerësimi, i krijuar për çdo vit akademik nga drejtuesi i njësisë bazë. Vlerësimi nga ana e komisionit mbështetet dhe në vlerësimin e praktikës mësimore nga ana e personelit mbikëqyrës të caktuar për të. <i>Aneks 5, Aneks 7, Aneks 63, Aneks 64.</i>
Konkluzione	<p><i>Nga vëzhgimet në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB-në dhe materialet plotësuese, GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>të dhënat mbi rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) apo dhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ gjenden të arkivuara dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme Njerëzore të rektoratit të UAMD.</i> - <i>të dhënat e paraqitura nga GVB, u konstatuan nga GVJ se programi i studimit Master Profesional në GTSH është bazuar në strukturimin e tij në përputhje me parashikimet ligjore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi si në normën juridike ashtu dhe në ngarkesën mësimore, gjë e cila është shpaloet plotësisht në planin mësimor, sipas ngarkesës në orë dhe kredite në vite akademike sipas semestrave përkatës.</i> - <i>Departamenti i Turizmit ka burimet, kapacitetet për mbulim të plotë të programeve të studimit që Departamenti ofron, në Fakultetin e Biznesit.</i> - <i>Në Departamentin e Turizmit, i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka një staf akademik me kohë të plotë i kontraktuar sipas akteve ligjore në fuqi për rekrutimin e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.</i> - <i>Procedura e rekrutimit dhe vlerësimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten në departament, sipas përcaktimeve statutoare dhe të legjislacionit mbi arsimin e lartë.</i> - <i>UAMD i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e tij, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Kriteret publikohen në WEB zyrtarë të UAMD.</i> - <i>Departamenti i Turizmit, Fakulteti i Biznesit në programin e studimit MPGTSH, angazhon dhe personel akademik, në ndihmë të realizimit të veprimtarisë akademike.</i> - <i>Të dhënat mbi rekrutimin e personelit akademik (PAE dhe PAK) si dhe të personelit ndihmës akademik dhe administrative të angazhuar në programin e studimit MPGTSH gjenden të arkivuara dhe administrohen pranë Sekretarisë së Burimeve Njerëzore si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të rektoratit të UAMD.</i>



	<p>- Në rang Universiteti dhe Fakulteti, sipas programeve të studimit që ai mbulon ka lidhur një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione homologe, me aktorë të biznesit, vendas apo të huaj të cilët ofrohen për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kurrikulës të studimeve.</p> <p>- MPGTSH është strukturuar në mënyrë të tillë semestrin e dytë studentët të realizojnë disiplinën praktikë profesionale (3 ECTS). Në përfundim të saj student vlerësohet në prani të një komisioni vlerësimi, i krijuar për çdo vit akademik nga drejtuesi i njësisë bazë. Vlerësimi nga ana e komisionit mbështetet dhe në vlerësimin e praktikës mësimore nga ana e personelit mbikqyrës të caktuar për të.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e vet Departamenti i Turizmit, konstaton një infrastrukturë të përshtatshme për çdo personel akademik për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si dhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtari e personeli akademik të departamentit. Në infrastrukturën e FB nën kujdesin e UAMD janë rritur hapësirat ndërtimore duke ulur densitetin e studentëve për metër katror. Nga ana e institucionit është parashikuar dhe e drejta e tyre në përdorimin e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor, por dhe të pasurit akses në përfitim të shërbimeve mbështetëse që ofrohen nga Fakulteti. FB dhe Departamenti i Turizmit, ka ambiente të reja dhe komode me pajisje teknologjike të nevojshme për programet e që ofrohen në departament. Mjediset ku punojnë pedagogët janë të mira, dhe secili ka hapësirën e vet të punës. <i>Aneks 3, Aneks 3.2, Aneks 6.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Grupi Vlerësues i Jashtëm gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në evidencat e infrastrukturës reale në dispozicion të procesit mësimor teorik dhe praktik, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktiviteteve mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve. Njëkohësisht dhe hapësira e vënë në dispozicion të personelit akademik është më se e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturë. Departamenti Turizmit DT

	<p>disponon dy laboratorë të pajisur me mjete të teknologjisë digjitale i cili do të ndihmojë procesin cilësor të mësimdhënies dhe hulumtimit individual të studentëve me risitë që nevojiten në aspektin formues profesional të studentëve që do të ndjekin programin e studimit MP GTSH.</p> <p>Aneks 3.2, Aneks 42.1, Aneks 6, Aneks 42, Aneks 74</p> <p><u>Sugjerim: Nga ana e DT dhe stafit akademik të tij dhe më konkretisht të programit të studimit MPGTSH nga ana e GVJ sugjerohet një shfrytëzim sa më efikas i mjeteve me bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit në kryerjen me së miri të aktiviteteve mësimore, por dhe atyre me natyrë praktike.</u></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët e dedikuar për programin e studimit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Ata kanë akses në internet pa limit dhe në çdo moment mund të lidhen online apo faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të ndryshme e të nevojshëm për realizimin e detyrave individuale apo projekteve. Këto laboratorë gjendet në katin e tretë të godinës nr. 2, pranë Fakultetit të Biznesit Secili nga ato është i pajisur me 30 tavolina teke, me 5 dalje prizash dhe me një kapacitet prej 30 pc. Aneks 42, Aneks 74.</p> <p><u>Rekomandim: Departamenti duhet të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara të programeve mësimore për të ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online.</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, si për studentët ashtu dhe për stafin akademik, në çdo ditë të javës. Departamenti i Turizmit ka në përdorim 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit. Ato janë të pajisura me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit, të instaluar në secilin PC ku studentët ulen, me lidhje direkte me PC e lektorit që do e hapi dhe përdori programin. Aneks 42</p> <p><u>Rekomandim: Mbështetur në strategjinë e UAMD dhe të FB e më konkretisht të DT, në laboratorët ekzistues duhet të instalohen dhe programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit. Është e kuptueshme që vështirësitë sidomos financiare në këto aspekt dihen, por në kuadër të ndërkombëtarizimit si pjesë e strategjisë së UAMD, në këto aspekt duhet të hidhen hapa konkretë sidomos në këto program studimi, i cili i përshtatet kërkesave dhe tregut të punës në nivel lokal e më gjerë.</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Fakulteti i Biznesit dhe veçanërisht Departamenti i Turizmit i zotëron kapacitetet e mjaftueshme materiale për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mësimore praktike në terren. Realizimi i tyre është mbështetur në bashkëpunimin dhe me institucione dhe subjekte të tjera private e shtetërore që operojnë në sektorin e Turizmit. (Aneks 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit te FB) Në funksion të realizimit të plotë të praktikës në terren Departamenti Turizmit në kuadër të bashkëpunimeve me interes ë ndërsjelltë në funksion të dijes, praktikës ka nënshkruar dhe aktualizuar dhe marrëveshje me subjekte private dhe</p>

<p>profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>turistike, si edhe me institucione qeverisëse siç janë: Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, (DRKK), CEAPAL dhe Risi Albania. Me DRKK Durrës, MuzehLab, QZHDI, etj. për konsultime dhe mendime në aspektin e specialitetit, si dhe në drejtim të njohjes së trashëgimisë kulturore e menaxhimit të siteve arkeologjike. Frut i bashkëpunimeve me subjekte private e qeverisëse janë dhe veprimtari të tjera si praktika mësimore, e leksione jashtë auditorit të kryera ndër vite që nga koha e hapjes së këtij programi studimi. Aneks 31, Aneks 91, Aneks 92.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e vet Departamenti i Turizmit, konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Një infrastrukturë të përshtatshme për çdo personel akademik për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si dhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtarit e personeli akademik të departamentit.</i> - <i>Konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe paisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktiviteteve mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve. <u>Sugjerim: Nga ana e DT dhe stafit akademik të tij dhe më konkretisht të programit të studimit MPGTSH nga ana e GVJ sugjerohet një shfrytëzim sa më efikas i mjeteve me bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit në kryerjen me së miri të aktiviteteve mësimore, por dhe atyre me natyrë praktike.</u></i> - <i>Laboratorët e dedikuar për programin e studimit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Ata kanë akses në internet palimit dhe në çdo moment mund të lidhen on-line apo faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të ndryshme e të nevojshme për realizimin e detyrave individuale apo projekteve. <u>Rekomandim: Departamenti duhet të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara të programeve mësimore për të ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online.</u></i> - <i>Mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, si për studentët ashtu dhe për stafin akademik, në çdo ditë të javës. Departamenti i Turizmit ka në përdorim 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit. <u>Rekomandim: Mbështetur në strategjinë e UAMD dhe të FB e më konkretisht të DT, në laboratorët ekzistues duhet të instalohen dhe programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit. Është e kuptueshme që vështirësitë sidomos financiare në këto aspekt dihen, por në kuadër të ndërkombëtarizimit si pjesë e strategjisë së UAMD, në këtë aspekt duhet të hidhen hapa konkretë sidomos në këtë program studimi, i cili i përshtatet kërkesave dhe tregut të punës në nivel lokal e më gjërë.</u></i> - <i>Fakulteti i Biznesit dhe veçanërisht Departamenti i Turizmit i zotëron kapacitetet e mjaftueshme materiale për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mësimore praktike në terren. Realizimi i tyre është</i>



	<i>mbështetur në bashkëpunimin dhe me institucione dhe subjekte të tjera private e shtetërore që operojnë në sektorin e Turizmit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në nivel fakulteti UAMD vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën e Fakultetit, Bibliotekën e universitetit. Biblioteka e FB garanton të drejtën e çdo student për aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin të literaturës fizike në ambientet e saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i gjithë hapësirës së bibliotekës me rrjetin Wireles dhe të aksesohet në biblioteka on-line, për gjetjen e literaturës së nevojshme të parashikuar në programet mësimore të MPGTSH.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se programi i studimit mbështetet nga literatura bazë (kryesisht në gjuhën shqipe) dhe ndihmëse (e sugjeruar për çdo program disiplinë në gjuhën shqipe dhe të huaj-anglisht) e përcaktuar nga stafi akademik dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse dhe i miratuar nga drejtuesi i njësive bazë. Mënyra e ofrimit të literaturës që u vihet në dispozicion studentëve të këtij program studimi është e printuar ose on-line nëpërmjet mënyrës së komunikimit elektronik. <i>Aneks 67</i></p> <p><i>Konstatim: Nga vizita në bibliotekën e FB, u evidentua se literatura bazë ishte e aksesueshme, ndërsa në lidhje me literaturën ndihmëse, sidomos ajo në gjuhë të huaj paraqitej vështirësi në aksesimin e saj nga ana e studentëve, pavarësisht mundësive që u paraqiteshin atyre për shfrytëzim.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>UAMD, bazuar në objektivat e Planit Strategjik 2020-2025 për zhvillimin e programit të studimit MPGTSH, në projekt buxhetin vlerësuar në nivel akademik, financiar apo dhe burimesh njerëzore, ka krijuar hapësira të rëndësishme dhe në rritjen cilësore dhe funksionale të bibliotekës. FB ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga DT (njësia bazë). Drejtuesit e programeve të studimit përmes kërkesave të marra nga ana e stafit akademik, me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së FB. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni merr në konsideratë kërkesat e stafit akademik, por procesi i realizimit të pasurimit të fondit realizohet në varësi të buxhetit të hartuar nga ana e IAL-UAMD.</p> <p>Koleksioni bibliotekar fizik përfshin burime që plotësojnë deri diku nevojat e përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. Koleksionet bibliotekare përmbajnë edhe librin elektronik në gjuhë të</p>

	<p>ndryshme. Është evidentuar një shtim i vazhdueshëm i librit elektronik me tituj e formate të rinj. Biblioteka siguron hyrje në bazat e të dhënave elektronike në rrjet. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit përmes përshkrimit bibliografik, ofrohet falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të UAMD-së. <i>Aneks 3.2, Aneks 45.2, Aneks 45.3,</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në nivel universiteti UAMD vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Shkencore e krijuar në vitin 2015, e cila është hibride dhe me fonde të hapura në tre godina.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Biblioteka Nr. 1 (160 m²) në shërbim të Fakultetit të Studimeve Profesionale, Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe FASTIP-it. 2. Biblioteka Nr. 2 (220 m²), pranë kampusit universitar, që i shërben Fakultetit të Biznesit dhe Fakultetit të Edukimit. 3. Biblioteka Nr. 3 (35 m²), pranë godinës Nr 2, kampus, e cila i shërben FSHP-J-së (jo e kompletuar plotësisht. Mungojnë libra, vende për studim, kompjuterë, internet). <p>Mbështetur në të dhënat e marra si në rrugë komunikimi me stafin akademik të DT, FB dhe Bibliotekës, ashtu përmes tyre bazës së dokumenteve të paraqitura në këtë proces mund të theksojmë se së bashku ato mbulojnë në masën 80-90% nevojat e studentëve për literaturë mësimi dhe kërkim. Biblioteka shkencore e UAMD ka në fokus mbështetjen e ecurisë zhvillimore-akademike të stafit, lektorëve dhe studentëve, përmes ofrimit të alternativave akademike bashkëkohore nëpërmjet teknologjisë së informacionit në aktivitetin e tyre akademik-shkencor. Në bibliotekën Nr. 2, në shërbim të Fakultetit të Biznesit (ambientet e tij), vë në dispozicion literaturën bazë dhe të rekomanduar jo vetëm për studentët, stafin akademik të këtij fakulteti por për studentët e programeve të tjera të studimit, gjë të cilën e dëshmon dhe numri mesatar anëtarësimeve në bibliotekë nga 1500-2000 anëtarë në vit.</p> <p><i>Aneks 3.2, Aneks 42.1, Aneks 42.2.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se biblioteka e UAMD (në tre godinat) është e pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Libra në hard copy (të printuar) 12 njësi bibliotekare. • Libri elektronik, i ruajtur ne CD, server, hard disk i jashtëm mbi 10.000 tituj. • Në funksion dhe në dispozicion të studentëve dhe stafit është dhe sistemi i integruar i bibliotekës me programin "KOHA" dhe sistemin e dixhitalizimit "Dspace", si edhe janë vendosur hardware dhe software-ve te të gjithë kompjuterët. • Biblioteka kryesore e UAMD ofron mundësinë e leximit në salla me fond të hapur dhe me fond të mbyllur stafit akademik dhe studentëve të kenë akses ne EBSCO, i cili ofron: <ul style="list-style-type: none"> - 170,000 Libra elektronike nga Oxford University Press, MIT Press, State University of New York Press, Cambridge University Press, University of California Press, McGill-Queen's University Press, Harvard University Press dhe shumë të tjera.)

	<ul style="list-style-type: none"> - 6,600 periodike dhe revista - 6,000 periodike peer-reviewed - 4,000 periodike të Web of Science ose Scopus <p>Në bibliotekën shkencore ndodhet një inventar i pasur me tekste e libra, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj në shërbim të fushës së specialitetit të programit të studimit MP GTSH.</p> <p>Katalogu on-line i Bibliotekës shërben për përcjellje informacioni në lidhje me literaturën ekzistuese. Ambientet e bibliotekës së UAMD dhe literature fizike dhe on-line janë të aksesueshme dhe të vëna në dispozicion të studentëve dhe stafit i antarësuar, pa pagesë. Katalogu elektronik si formati MARC, Standardi Z 39.50, SRU bëhet i aksesueshëm përmes adresës elektronike të tij: 37.139.119.32630.</p> <p>Aneks 42.1, Aneks 42.3, Aneks 45.2, Aneks 45.3.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve kushte dhe mundësi shfrytëzimi të barabartë e pa pagesë për studentët të literaturave të ndryshme duke përfshirë edhe atë të turizmit, albanologjike, trashëgimisë ndër të tjera, duke mundësuar ndërlidhjen e shumëfishtë të programit të studimit në MPGTSH si edhe duke ndikuar në rritjen e formimit të studentëve. Universiteti i ka vënë në dispozicion Departamentit të Turizmit dhe studentëve të këtij programi MP edhe Bibliotekën kryesore të tij, që të shfrytëzohet lirisht nga studentët por dhe mundësi të konsultojnë katalogun e bibliotekës në adresën Web Biblioteka Nr.2, ofron për literaturë bazë dhe ndihmëse ofron edhe shërbim në version on-line, duke siguruar lidhje aksesimi me anë të IP statike me kod të hapur. Në fokus të punës së UAMD, FB, DT ka qenë dhe pasurimi i vazhdueshëm i katalogëve, teksteve që mbështesin procesin mësimor dhe të aktiviteteve të Universitetit. Biblioteka ka lidhje aksesimi sigurohet brenda institucionit me anë të IP statike.</p> <p>Sistemi “Koha”, “pa kosto” me 13 000 rekorde siguron informacion edhe jashtë ambienteve të universitetit përmes informimit me anë të katalogut në kërkimin e informacionit dhe përdorimin e literaturës së nevojshme për kërkim shkencor, hartimin e tezave të diplomave dhe disertacionet e stafit akademik. Aneks 42.1, Aneks 42.3.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se Biblioteka e UAMD (në 3 godina), dhe sidomos pas vizitës në bibliotekën e FB kanë në funksion të tyre dhe një sallë internet/leximi e pajisur me kompjuterë dhe programe kompjuterike si dhe pajisje të tjera të cilat përdoren nga të gjitha kategoritë e frekuentuesve të tyre, edhe ato që janë të regjistruar në programin e studimit MP GTSH, pa kufizime, në përputhje me rregulloren e saj. Nga instalimi falas i Katalogut Online të Integruar, studentët mund të shfrytëzojnë on-line materiale në kohë reale, por mund të aksesojnë lirisht sa herë dëshirojnë në kompjuterët e bibliotekës. Biblioteka ka në funksion fondin on-line EBSCO dhe VENERA e cila është një bibliotekë online e aplikuar në Universitetin Aleksandër Moisiu. Aneks 45.2 Aneks 45.3.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve</p>	<p>Biblioteka Universitare qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është nga ora 8.00 – 16.00. Oraret</p>

<p>në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërhiqnin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapësirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj dhe atë on –line pas tij. Aneks 42, Aneks 42.3.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>UAMD bazuar në realizimin e objektivave të Planit e Zhvillimit Strategjik 2021-2025 për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit akademik ka si prioritet krijimin e hapësirave dhe alternativave më optimale për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe nivelit akademik të stafit dhe studentëve pjesë e tij. Edhe FB ndjek një praktikë të kërkesave për pasurimin e fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vijnë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programeve të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së FB dhe Bibliotekës Shkencore të UAMD. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na konfirmoi se institucioni në një masë të konsiderueshme i merr në konsideratë kërkesat e stafit akademik dhe realizimin e procedurës për pasurimin e fondit në mënyrë periodike. Numri i të anëtarësuarve fizikë rezulton rreth 1100 individë, anëtarë të stafit akademik dhe studentë të të gjitha fakulteteve (DT). Një pjesë e literaturës mundësohet nëpërmjet prokurimit publik, dhurimeve dhe anëtarësime në biblioteka on-line nga institucioni. Biblioteka parashikon fondet e caktuara për t'u blerë nëpërmjet prokurimit publik të literaturës shkencore. Burimi për pasurim kryhen përmes blerjes, dhurimit nga biblioteka, apo nga persona të veçantë, studentë, shtëpi botuese, fondacione e organizata bamirëse, brenda dhe jashtë vendit, përmes botimet shkencore elektronike, artikujve shkencorë, tezave dhe disertacioneve të stafit akademik dhe studentëve të universitetit, pasurimi periodik me botimet e Bashkimit Evropian. Aneks 3, Aneks 45.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në nivel fakulteti UAMD vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën e Fakultetit, Bibliotekën e universitetit. Biblioteka e FB garanton të drejtën e çdo student për aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin të literaturës fizike në ambientet e saj. Gjithashtu studentët shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i gjithë hapësirës së bibliotekës me rrjetin Wireles dhe të aksesohet në biblioteka on-line, për gjetjen e literaturës së nevojshme dhe për programet mësimore të MPTGSH. Konstatim: <u>Nga vizita në bibliotekën e FB, u evidentua se literatura bazë ishte e aksesueshme, ndërsa në lidhje me literaturën ndihmëse, sidomos ajo në gjuhë të huaj paraqitej vështirësi në aksesimin e saj nga ana e studentëve, pavarësisht mundësive që u paraqiteshin atyre për shfrytëzim.</u></i></p> <p><i>- UAMD, bazuar në objektivat e Planit Strategjik 2020-2025 për zhvillimin e programit të studimit MP GTSH, në projekt buxhetin vlerësuar në nivel akademik, financiar apo dhe burimesh njerëzore, ka krijuar hapësira të rëndësishme dhe në rritjen cilësore dhe funksionale të bibliotekës.</i></p>

	<p>- Në nivel universiteti UAMD vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Shkencore e krijuar në vitin 2015, e cila është hibride dhe me fonde të hapura në tre godina.</p> <p>- UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve kushte dhe mundësi shfrytëzimi të barabartë e pa pagesë për studentët të literaturave të ndryshme duke përfshirë edhe atë të turizmit, albanologjike, trashëgimisë ndër të tjera, duke mundësuar ndërlidhjen e shumëfishtë të programit të studimit në MP GTSH si edhe duke ndikuar në rritjen e formimit të studentëve.</p> <p>- Biblioteka e UAMD (në 3 godina) kanë në funksion të tyre dhe një sallë internet/leximi e pajisur me kompjuterë dhe programe kompjuterike si dhe pajisje të tjera të cilat përdoren nga të gjitha kategoritë e frekuentuesve të tyre, edhe ato që janë të regjistruar në programin e studimit MP GTSH, pa kufizime, në përputhje me rregulloren e saj.</p> <p>- Studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapësirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj dhe atë on –line pas tij.</p> <p>- Institucioni në një masë të konsiderueshme i merr në konsideratë kërkesat e stafit akademik dhe realizimin e procedurës për pasurimin e fondit në mënyrë periodike.</p> <p>- Numri i të anëtarësuarve fizikë rezulton rreth 1100 individë, anëtarë të stafit akademik dhe studentë të të gjitha fakulteteve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB-së, GVJ konstaton se institucioni zotëron një sistem menaxhimi përmes të cilit administrohen të gjithë informacionet që kanë të bëjnë me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga hyrja/regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, informacion që mbahet në bazën përkatëse të të dhënave. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit, si dhe shërben për të hartuar statistika. Fakulteti i Biznesit, në të cilin zhvillohet programi i studimit MP GTSH bashkë me sekretaritë mësimore (në përbërje të së cilës është kryesekretarja dhe sekretaret mësimore që varet nga drejtuesi i njësisë kryesore), administrojnë sistemin e menaxhimit të procesit mësimor, organizativ dhe administrative duke ju shërbyer studentëve dhe stafit akademik gjatë zhvillimit të këtij program studimi të ciklit të dytë, përmes një strukture bashkëkohore të teknologjisë së informacionit dhe informimit në rrjet. Sekretaritë funksionojë në bazë të rregullores së FB. Aneks 6, Aneks 9.

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstaton se informacioni që lidhet me veprimtarinë dhe performancën akademike administrohet nga sistemi i brendshëm i menaxhimit. Kjo e fundit i takon njësisë bazë-departamentit. Bashkë me këtë informacion mbahen dhe të dhëna lidhur me stafin akademik që angazhohet çdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar nga departamenti për programin e studimit MP GTSH.</p> <p>Ky informacion bëhet pjesë e analizave dhe raporteve në nivel njësie apo institucioni. Dokumentacioni në fjalë ndodhet tek Drejtoria e Burimeve Njerëzore në UAMD, e cila ligjërisht përgjigjet për dokumentacionet e stafit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, përmes disponimit të dosjeve të stafit akademik dhe administrative ndër vite. Dosjet përditësohen me çdo dokument të fituar nga anëtarët e stafit përgjatë punës së tyre dhe dokumenti shtohet në dosje. Informacioni mbi stafin e UAMD, disponohet edhe në formë elektronike, po ashtu dhe orët mësimore të kryera, ngarkesa mësimore faktike e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, disponohen nga njësia kryesore, njësia bazë dhe nga Sektori i Çështjeve Mësimore, në përputhje me legjislacionin e MASR 29, datë 10.09.2018647. <i>Aneks 11</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se sistemi i menaxhimit të FB dhe DT siguron akses të dedikuar si për stafin, ashtu dhe për studentët, duke dhënë garancitë e nevojshme për transparencën brenda institucionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në mbështetje të detyrimeve që burojnë nga ligji respektiv në fuqi (Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale). Lidhur me informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave personale, dhe koordinimin e procesit mësimor apo aktivitete të tjera në funksion të tij rol të rëndësishëm luajnë si sekretaria mësimore ashtu dhe departamenti. <i>Aneks 120, Aneks 123, Aneks 6, Aneks 9.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit e mundëson aksesin nëpërmjet llogarive personale të stafit dhe studentëve për Programin MPGTSH PITAGORA që nga viti 2019, si një prej sistemeve teknologjike që mundëson komunikimin interaktiv në të cilin studentët kanë një llogari personale e cila aksesohet tek “zona e studentit” e organizuar nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit. Ky sistem lehtëson komunikimin e drejtpërdrejtë me notat, kalueshmërinë, kurset e regjistruara, orarin, mungesat, provimet etj. Në këtë platformë studenti regjistron online lëndët në ditën dhe orarin. Komunikimi përmes sistemit PITAGORA (https://uamd.pitagora.rash.al/login) apo formave alternative të vendosura në dispozicion nga UAMD bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statusin e UAMD, rregulloren e brendshme dhe Kodin e Etikës. <i>Aneks 46, Aneks 39.1, Aneks 98</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i brendshëm siguron dhe garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative. Në kohë reale dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit, Sistemi Pitagora, i cili është nën monitorimin e UAMD dhe të RASH, është një platformë që mundëson e garanton menaxhimin e monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, faqes zyrtare të UAMD dhe FB, garantoher</p>

<p>dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>aktiviteti akademik dhe administrativ. Sistemi mundëson raportime dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët e institucionit si Dekani i Fakultetit të Biznesit, Zv. Dekanët e Fakultetit të Biznesit, Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit në UAMD, Rektoratin e organet e tjera drejtuese në të, RASH pranë ministries së Arsimit Shqiptarë. Nëpërmjet sistemit PITAGORA mund të merren të dhëna mbi funksionin, dokumentacionin e zyrave/strukturave të ndryshme, përpunohen dhe reflektohen në raporte të ndryshme që hartohen për autoritetet dhe organet më të larta drejtuese të fakultetit, universitetit, apo dhe raportime institucionale. Aneks 46.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga kontaktet me studentët dhe takimet me personelin akademik të DT në FB rezultoi se informacionet që lidhen me programin e studimit MPGTSH, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme mësimore dhe ekstrakurrikulare, të organizuar në këtë departament, aktet e brendshme rregullatore etj., janë të publikuara në faqen e internetit të UAMD dhe FB. Materialet e publikuara janë të plota, dhe përcjellin informacion të bollshëm mbi aktivitetin e UAMD dhe FB, të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit dhe ofrohen në gjuhën shqipe, si gjuha kryesore. Gjithashtu informacione në rubrika të caktuara janë të vlefshme dhe në anglisht.</p> <p>Synimi UAMD është: 1. Informimi dhe ndërgjegjësimi për punën dhe arritjet e UAMD-së. 2. Të krijojë imazhin e UAMD-së (dhe forcojë atë) si një institucion serioz, partner i besueshëm për institucionet akademike në vend dhe më gjerë. Aneks 48 (www.uamd.edu.al).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni zotëron një system menaxhimi përmes të cilit administrohen të gjithë informacionet që kanë të bëjnë me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga hyrja/regjistrimi deri në diplomën në programin e studimit, informacion që mbahet në bazën përkatëse të të dhënave.</i> - <i>Informacioni që lidhet me veprimtarinë dhe performancën akademike administrohet nga sistemi i brendshëm i menaxhimit. Kjo e fundit i takon njësisë bazë-departamentit. Bashkë me këtë informacion mbahen dhe të dhëna lidhur me stafin akademik që angazhohet çdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar, të realizuar nga departamenti për programin e studimit MP GTSH.</i> - <i>Sistemi i menaxhimit të FB dhe DT siguron akses të dedikuar si për stafin, ashtu dhe për studentët, duke dhënë garancitë e nevojshme për transparencën brenda institucionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në mbështetje të detyrimeve që burojnë nga ligji respektiv në fuqi, sistemi PITAGORA që nga viti 2019.</i> - <i>Sistemi i brendshëm siguron dhe garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative.</i> - <i>Informacionet që lidhen me programin e studimit MP GTSH, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme mesimore dhe ekstrakurrikulare, të organizuar në këtë departament, aktet e brendshme rregullatore etj., janë të publikuara në faqen e internetit të UAMD dhe FB.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga buxheti i UAMD, ku pasqyrohen dhe të ardhurat e shpenzimet për çdo njësi të tij, FB i akordohet buxheti i tij në raport me nevojat, bazuar në buxhetin afatmesëm të tij. Fakulteti në bashkëpunim me departamentet dhe nevojat e tyre harton çdo vit akademik planbuxhetin e tij në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit që ai ofron. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, me qëllim arritjen e objektivave strategjike, si dhe realizimin e misionit të saj. <i>Aneks 49, Aneks 50.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, si dhe bëhet një vlerësim i ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihen kostot për çdo program studimi, e cila ndryshon nga një program në tjetrin. Burimet financiare në institucion hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në UAMD, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse në shpërndarjen e tyre. Institucioni UAMD në hartimin e planit financiar përfshin financime në: <ul style="list-style-type: none"> • Kritjen e numrit të stafit akademik, me qëllim plotësimin e standardeve student/pedagog; • Kualifikimin e stafit akademik nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit; • Përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencore, me aparatura, programe, mjete teknologjike të domosdoshme për procesin mësimorë-kërkimor; • Abonimi në revista shkencore dhe biblioteka online • Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare • Kritja e konkurrueshmërisë së stafit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte, konferenca/kongrese kombëtare/ndërkombëtare. <i>Aneks 3.1</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar RVB UAMD kryen një auditim të përvitshëm të brendshëm e të jashtëm mbi situatën financiare. Në nivel të brendshëm UAMD ka ngritur dhe strukturën e tij Degën e Auditimit të Brendshëm, e cila harton dhe zbaton Planin strategjik dhe Vjetor të përcaktuar sipas saj. Kjo strukturë është në varësi të Bordit të Administrimit, i cili monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet auditimit të brendshëm. Raportet financiare të paraqitura në

	kuadër të programit të transparencës përmbajnë tabelat mbi të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare të detajuara, institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit. Financimi dhe të ardhurat për FB janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të UAMD. Veprimtaria audituese është e strukturuar në bazë të Ligjit Nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ konstaton se UAMD ka të dokumentuar raportet financiare, për secilin vit akademik (për vitet e përfshira në akreditim) dhe për tri vitet e kaluara akademike nëpërmjet Degës së Auditimit të Brendshëm. Institucioni IAL harton dhe zbaton Planin strategjik dhe Vjetor të Degës së Auditimit të Brendshëm, duke ofruar përmes tij: <ul style="list-style-type: none"> • Siguri objektive dhe të pavarur, shërbime konsulence për vlerësimin dhe përmirësimin me efektivitet të proceseve të menaxhimit të riskut, • Planifikim të ndërhyrjeve të posaçme, • Diversifikime eventuale të financimit të programit të studimit, duke garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Veprimtaria audituese strukturohet në bazë të Ligjit Nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. Aneks 49.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ konstaton se institucioni dëshmon garanci mbi qëndrueshmërinë financiare për vijimin e aktivitetit akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Burimet e buxhetit të UAMD krijohen nga burime të përcaktuara që realizohen në përputhje me rregullat ligjore të detyrueshme përgjithësisht entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave. UAMD financohet nga: <ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i shtetit; • Pagesat e studentëve për arsimim; • Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; • Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financiare; • Veprimtaria kërkimore-shkencore; • Projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare; Të gjitha të ardhurat e krijuara nga UAMD përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës akademik. Aneks 49.
Konkluzione	- Nga buxheti i UAMD, ku pasqyrohen dhe të ardhurat e shpenzimet për çdo njësi të tij, FB i akordohet buxheti i tij në raport me nevojat, bazuar në buxhetin afatmesëm të tij. Fakulteti në bashkëpunim me departamentet dhe nevojat e tyre harton çdo vit akademik planbuxhetin e tij në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit që ai ofron. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, me qëllim arritjen e objektivave strategjike, si dhe realizimin e misionit të saj. - Institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, si dhe bëhet një vlerësim i ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me

kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihen kostot për çdo program studimi, e cila ndryshon nga një program në tjetrin. Burimet financiare në institucion hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në UAMD, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse në shpërndarjen e tyre.

- UAMD kryen një auditim të përvitshëm të brendshëm e të jashtëm mbi situatën financiare. Në nivel të brendshëm UAMD ka ngritur dhe strukturën e tij Degën e Auditimit të Brendshëm, e cila harton dhe zbaton Planin strategjik dhe Vjetor të përcaktuar sipas saj. Kjo strukturë është në varësi të Bordit të Administrimit, i cili monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet auditimit të brendshëm.

- UAMD ka të dokumentuar raportet financiare, për secilin vit akademik (për vitet në akreditim) dhe për tri vitet e kaluara akademike nëpërmjet Degës së Auditimit të Brendshëm. Institucioni IAL harton dhe zbaton Planin strategjik dhe Vjetor të Degës së Auditimit të Brendshëm.

- Institucioni dëshmon garanci mbi qëndrueshmërinë financiare për vijimin e aktivitetit akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Burimet e buxhetit të UAMD krijohen nga burime të përcaktuara që realizohen në përputhje me rregullat ligjore të detyrueshme përgjithësisht entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë MP GTSH në FB, realizohet bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e UAMD, si dhe në kriteret dhe kuotat e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati akademik i UAMD. Ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë, si dhe për studentët e këtij programi studimit. Të drejtat dhe detyrat e studentëve parashikohen në Statutin dhe Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FB, Rregulloren e Departamentit të Turizmit, si dhe në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, Rregullore Diplomimi, Manualin e Cilësisë dhe Rregulloren e zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>UAMD harton dhe zbaton politika të bazuara në dispozitat e Ligjit 80/2015664, të cilat mbulojnë procesin e zhvillimit akademik të studentëve nga momenti i hyrjes në fakultet deri në diplomim.</p> <p><i>Aneks 2, Aneks 5, Aneks 6, Aneks 6.1, Aneks 9, Aneks 12, Aneks 99.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, rezulton se programi i studimit të Ciklit të Dytë MP GTSH është hartuar dhe zbatuar duke u mbështetur në lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi. Për kandidatët e interesuar për vijimësi të programeve të studimit, si dhe për studentët që ndjekin MP GTSH procedurat dhe politikat e ndjekura nga hyrja në dalje të studentëve garantojnë barazinë, gjë e cila pasqyrohet në të gjitha aktet rregullatore të UAMD. Kuotat dhe kriteret e pranimit miratohen sipas procedurave ligjore dhe ato janë të shpallura publikisht e janë të aksesueshme nga të gjithë. Informacioni publikohet në faqen zyrtare të UAMD dhe të FB. E gjithë procedura bazohet në Statutin e UAMD, Rregulloren e Studimeve në UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e Departamentit të Turizmit, Rregulloren e Masterit Profesional GTSH shoqëruar dhe me aktet e tjera të cilat ndihmojnë procesin, Rregulloren e Sekretarisë mësimore, Rregulloren e Zyrës Njësisë së Karrierës.</p> <p><i>Aneks 2, Aneks 5, Aneks 6, Aneks 6.1, Aneks 8, Aneks 7, Aneks 9,</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se përzgjedhja e kandidatëve për programin e studimit MPGTSH është kryer nëpërmjet aplikimit të kandidatëve që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe Brenda afatit të përcaktuar. Kriteret miratohen me vendim të Senatit akademik të UAMD. Kriteret vihen në dispozicion të strukturave të ngritura për zbatimin e maturës shtetërore sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi. Në fillim të çdo viti akademik, UAMD vë në</p>

<p>ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>dispozicion informacionin e nevojshëm për: studentët lidhur me pranimin e tyre, mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, si dhe mundësinë e transferimit të krediteve etj. Renditja e kandidatëve fitues për programin e studimit MPGTSH bëhet nga Departamenti I Turizmit dhe FB përmes shpalljes së listës përpara fillimit të vitit akademik e procesit mësimor.</p> <p>Aneks 6, Aneks 7, Aneks 101, Aneks 101.1.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se objektivat e programit të ciklit të dytë të studimit MPGTSH janë të përcaktuara qartë dhe të hartuara mbi bazën e objektivave institucionale. Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, por edhe struktura e vitit akademik përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit që janë të kuptueshme për publikun. Dosja e programit të studimit Master Profesional GTSH iu përmbahet akteve si: Rregullore e Përgjithshme e UAMD-së, Rregulloren e Fakultetit, në të cilat përcaktohen shumë qartë kriteret e pranimit të studentëve në programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional dhe në versionin on-line në faqen: uamd.edu.al; në faqen e Facebook të Fakultetit të Biznesit dhe të Departamentit të Turizmit. Në lidhje me vlerësimin e studentëve, ai kryhet nga pedagogu përkatës i lëndës dhe rezultati i njoftohet çdo student në datën dhe orarin e ballafaqimit midis pedagogut dhe studentit, datë dhe orar i dakordësuar midis të dy palëve, mbështetur në rregulloret përkatëse të UAMD. Notat janë të aksesueshme për të gjithë studentët (individualisht) në Sistem elektronik.</p> <p>Aneks 2, Aneks 5, Aneks 6, Aneks 6.1, Aneks 7, Aneks 8, Aneks 14, Aneks 38.1, Aneks 39.1, Aneks 46, Aneks 57, Aneks 60, Aneks 62, Aneks 101, Aneks 102, Aneks 103, Aneks 104.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Turizmit dhe Fakulteti i Biznesit, propozojnë kuotat e pranimit, kriteret e pranimit e të përzgjedhjes se aplikantëve fitues jo më vonë se data e përcaktuar, në bashkëpunim me zyrat përkatëse të UAMD-së. Kjo realizohet në çdo fillim viti, përmes nxjerrjes së udhëzimeve dhe guidave për të interesuarit, gjithmonë bazuar në kriteret që duhet të plotësojnë për ndjekjen e këtij programi studimit. Një procedurë e tillë bëhet në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Kriteret i përcillen rektoratit, i cili më pas ia përcjell MASR. Të gjitha të dhënat më pas bëhen publike (FB) në faqen zyrtare UAMD dhe rrjeteve të ndryshme sociale në faqet zyrtare të FB të Fakultetit të Biznesit dhe të Departamentit të Turizmit.</p> <p>Aneks 6, Aneks 7, Aneks 47, Aneks 101, Aneks 102, Aneks 103.</p> <p>https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/te-reja-dhe-njoftime</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimit është kryer nëpërmjet aplikimit nga kandidatët që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Në çdo fillim viti akademik, UAMD vë në dispozicion informacionin e nevojshëm për studentët lidhur me pranimin e tyre, mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës, mundësitë për transferime kreditesh etj.</p>

	<p>Në përputhje me standardet e kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH, aktet e brendshme rregullore të UAMD-së, mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe në bazë të kuotave të miratuara nga Senati Akademik për një vit akademik kryhet dhe numri i pranimeve. UAMD ndjek një politikë jo diskriminuese në kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe të shtresave të marginalizuara, mbështetur dhe në rregullore të cilat lehtësojnë përfshirjen e tyre në procesin mësimor dhe më tej.</p> <p>Aneks 117.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>UAMD propozon çdo vit akademik kuotat dhe kriteret për përzgjedhjen dhe pranimin së aplikantëve fitues dhe nga shtetet e tjera të rajonit ku ka shqiptarë (Kosova). Në lidhje me këto kuota të caktuara kriteret janë të njëjta si edhe për aplikantët studentë shqiptar.</p> <p>Aneks 101.1.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga informacioni i paraqitur nga RVB, evidentohet se Universiteti Aleksandër Moisiu mbështetet në një sistem të mirorganizuar të bursave të cilat janë të përcaktuara për shtresat në nevojë, dhe studentët me aftësi të kufizuar. Për kategorinë e fundit mbështetja e UAMD lidhet me heqjen e taksës së shkollimit.</p> <p>Aneks 117.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë MPGTSH në FB, realizohet bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe udhëzimeve të përvitshme të MASR, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e UAMD, si dhe në kriteret dhe kuotat e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati akademik i UAMD. Ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë, si dhe për studentët e këtij programi studimit. - Programi i studimit të ciklit të Dytë MPGTSH është hartuar dhe zbatuar duke u mbështetur në lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi. - Përzgjedhja e kandidatëve për programin e studimit MPGTSH është kryer nëpërmjet aplikimit të kandidatëve që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe Brenda afatit të përcaktuar. - Objektivat e programit të ciklit të dytë të studimit MPGTSH janë të përcaktuara qartë dhe të hartuara mbi bazën e objektivave institucionale. Departamenti i Turizmit dhe Fakulteti i Biznesit, propozojnë kuotat e pranimin, kriteret e pranimin e të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data e përcaktuar, në bashkëpunim me zyrat përkatëse të UAMD-së. - Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimit është kryer nëpërmjet aplikimit nga kandidatët që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. UAMD propozon çdo vit akademik kuotat dhe kriteret për përzgjedhjen dhe pranimin së aplikantëve fitues dhe nga shtetet e tjera të rajonit shqiptarë (Kosova).

	- Universiteti Aleksandër Moisiu mbështetet në një sistem të mirorganizuar të bursave të cilat janë të përcaktuara për shtresat në nevojë, dhe studentët me aftësi të kufizuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në institucion rezulton se Fakulteti i Biznesit, DT së bashku me strukturat ndihmëse, sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe sekretarinë e masterit, ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe ecurisë së kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informacion gjendet i pasqyruar në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit në Rregulloren e programit të studimit. Informacioni pasqyrohet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet javës orientuese në fillim të studimeve. Departamenti i Turizmit, realizon takime me studentët dhe jep për ta udhëzime në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre. Përmes personelit akademik për çdo disiplinë bazuar te syllabus-i i saj, por dhe nga koordinatori i programit të studimit jepet informacion në lidhje me programin e studimit, planin mësimor dhe përmbajtjen e programeve të disiplinave. Informacion student merr dhe nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit si: faqja zyrtare e Universitetit, Fakultetit si edhe mediat sociale. <i>Aneks 5, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 9, Aneks 102.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në bazë të evidencave të paraqitura. Rezulton që ekziston një procedurë e lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. I gjithë informacioni gjendet në Statutin dhe Rregulloren e UAMD. Duke u mbështetur në dokumentet ligjore, Departamenti i Turizmit disponon një procedurë transparente dhe të rregullt në njohjen e studimeve të mëparshme. Fakulteti i Biznesit (Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Rregulloren e Programit të studimit në Guida Turistike Shqiptare, gjithashtu përmes sekretarisë dhe zyrave të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, sistemit të menaxhimit të informacionit vë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret dhe procedurat në lidhje me kualifikime të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Kriteret specifike publikohen në udhëzues të veçantë (faqja zyrtare e UAMD), apo diskutohen në takime të veçanta me studentët nga përgjegjësi i departamentit. <i>Aneks 5, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 9, Aneks 47.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur me të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga ana

<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>e personelit akademik përkatës ashtu dhe nga ana e koordinorit të programit të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Informacionin e duhur e të plotë ata mund ta marrin edhe nga Rregulloret: të UAMD, FB, DT, MP GTSH, apo syllabus-et e disiplinave që gjenden në faqen eeb. Studentët informohen në afatet e duhura në ambiente publike lidhur me kohën dhe oraret e provimeve. Për të vlerësuar studentin me pikë, përdoren kryesisht aktivizimi dhe frekuentimi në auditor, testimi me shkrim apo me gojë. Pikët konvertohen me notë mbi bazën e intervaleve të përcaktuara në syllabus-et e lëndëve. Studentit i jepet mundësia të njihet me testin që ka shkruar, me pikët e çdo elementi në vlerësim, por gjithashtu ka dhe të drejtën e ankimit në rast se lind nevoja në afatet e dhëna kohore dhe në mënyrën e përcaktuar në Rregullore.</p> <p>Aneks 5, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 9.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezulton që studentët e vitit të dytë të programit të studimit MPGTSH, informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga koordinatori i programit të studimit, nga drejtuesi i departamentit dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit. Informacioni merret dhe nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UAMD, Rregullores së FB, Rregullores së programit të ciklit të dytë të studimit MPGTSH si dhe ekzistuese është dhe Rregullorja e diplomimit. Informacioni i përcjellë përmes këtyre hallkave institucionale i informon studentët rreth procedurës së detyrimeve përmbyllëse të parashikuar.</p> <p>Aneks 5, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 10, Aneks 9, Aneks 10.1, Aneks 10.2, Aneks 114, Aneks 79, Aneks 80.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni në rang universiteti, por edhe njësie kryesore dhe në ato bazë, publikon udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe veçanërisht ato të ofruara nga FB. Pra universiteti organizon përpara fillimit të çdo viti akademik një fushatë informimi dhe mbi mundësitë për rritje në karrierë. Në lidhje me realizimin e një procesi të tillë ngrihet një grup pune me përfaqësues të fakulteteve të UAMD, në kuadër të një fushate marketing përmes së cilës FB dhe DT, dhe UAMD sigurojnë informacione udhëzuese mbi atë çka i ofron studentëve ndjekja e këtij programi studimit, në përputhje dhe me kërkesat e tregut të punës. Puna e departamentit në këtë aspekt është e lidhur ngushtësisht dhe në bashkëpunimin me kategoritë e bizneseve të interesuara gjatë dhe pas ndërmarrjes nga ana institucionale të fushatës së marketingut. Të gjitha këto bëhen publike dhe pasqyrohen me transparencë për të gjithë studentët e interesuar dhe për publikun.</p> <p>Aneks 51, Aneks 51.2, Aneks 136</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion rezulton se Fakulteti i Biznesit, DT së bashku me strukturat ndihmëse, sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe sekretarinë e masterit, ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe ecurisë së kalimit nga një vit në tjetrin.</i></p>

	<p>-Në bazë të evidencave të paraqitura. Rezulton që ekziston një procedurë e lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur me të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga ana e personelit akademik përkatës ashtu dhe nga ana e koordinatorit të programit të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p> <p>- Rezulton që studentët e vitit të dytë të programit të studimit MP GTSH, informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga koordinatori i programit të studimit, nga drejtuesi i departamentit dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit.</p> <p>- Institucioni në rang universiteti, por edhe njësie kryesore dhe në ato bazë, publikon udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe veçanërisht ato të ofruara nga FB.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin dhe në vijim nga ana e Koordinatorit të programit të studimit, nga zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe nga stafi akademik pjesë e DT dhe më konkretisht e programit të studimit MPGTSH. Informacionin mund ta aksesojnë dhe përmes faqes web të UAMD, FB dhe DT, në të cilat mund të njihen gjithashtu dhe për infrastrukturën e ambienteve dhe shërbimet që merren prej tyre. Në mbështetje të studentëve për informacion shërben dhe Sekretaria mësimore (Sekretaria e Masterit) dhe dega e IT në FB. GVJ konstatoi nga biseda me ta, që studentët ishin të informuar mbi këto elemente. Këto informacione, por më të detajuara janë të pasqyruara dhe në Rregulloren e Brendshme të studimit në programin e studimit MPGTSH, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, si dhe përmes prezantimeve nga ana e Dekanatit dhe drejtuesve të njësisë bazë në FB. Aneks 6, Aneks 9, Aneks 10, Aneks 12, Aneks 51.2.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për	Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi evidencave, GVJ konstaton se departamentit në çdo fillimviti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabus-et e përcaktuara në planin mësimor të programit të studimit MP GTSH, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor,

<p>lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>vlerësimin etj. Syllabus-et janë të vlefshëm për studentët në hard copy por edhe elektronikisht dhe përmbajnë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar si dhe element të nevojshëm për lëndën dhe detyrimet akademike që lidhen me të. Gjithashtu Fakulteti i Biznesit, nëpërmjet zyrave përkatëse, sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së Masterit, ka vendosur në dispozicion të studentëve kurrikulat dhe gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit si dhe veprimtaritë formuese që lidhen me të. Rregullorja e Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Aneks 6, Aneks 7, Aneks 9, Aneks 10.1, Aneks 10.3, Aneks 14, Aneks 19, Aneks 47, Aneks 50, Aneks 67.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve me qëllim motivimin personal dhe orientimin sa më të mirë në tregun e punës, u përcillet informacion periodik lidhur me mundësitë për trajnime, pjesëmarrje në programe shkëmbimi me student, mundësi intership-i dhe letër rekomandimi për mbështetje ndaj tyre etj. Departamenti ndjek politika në funksion të mbështetjes dhe orientimit të studentëve në këto aspekte, e cila zhvillohet sidomos gjatë javës së orientimit. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mbështet dhe realizon evidentimin e të dhënave të studentëve dhe gjurmimin e tyre në tregun e punës. Staf i Departamentit të Turizmit, në lidhje të ngushtë me biznesin turistik ka orientuar studentët drejt ofertave të punësimit në rajonin e Durrësit, dhe më gjerë. Rol kryesor në evidentimin, orientimin dhe koordinimin e studentëve drejt ofertave dhe tregut të punës kryhet nga ana e Koordinatorit të Masterit Profesional GTSH, ku si hap i parë është kryerja e praktikave mësimore në operatorë privatë, apo institucione shtetërore të fushës përkatëse me të cilat, ekzistojnë marrëveshje apo marrëdhënie bashkëpunimi.. Informacione mbi mundësitë e punësimit publikohen dhe në faqen zyrtare të website të fakultetit si dhe në rrjetet sociale të departamentit.</p> <p><i>Aneks 6, Aneks 12, Aneks 29, Aneks 32, Aneks 33, Aneks 35, Aneks 34, Aneks 105, Aneks 106.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve u vihet në dispozicion informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, përmes ditëve të orientimit, por edhe përmes udhërrëfyesit informative, mbi programet e studimit në FB, fletëpalosjeve, informacionit on-line që publikohet në website-n e UAMD, FB, DT. Studentët njihen gjithashtu edhe me infrastrukturën dhe logjistikën e zhvillimit të programeve të studimit apo shërbime të tjera të nevojshme për realizimin e programit të studimit, të cilat janë të aksesueshme nga studentët.</p> <p><i>Aneks 6, Aneks 7, Aneks 19, Aneks 24, Aneks 42, Aneks 46, Aneks 47, Aneks 51, Aneks 67, Aneks 65.</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Përmes mënyrave të ndryshme përfshi dhe qasjen on-line, në web faqen e UAMD, të FB, përcillen informacione të plota në lidhje me këtë program studimi, të cilat janë të aksesueshme jo vetëm nga ana e studentëve të FB, por edhe nga ata në distancë, kjo e përcaktuar si në Rregulloren e Masterit GTSH, Rregulloren e sekretarisë mësimore dhe</p>

lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Rregulloren e Fakultetit. Kjo mënyrë e të proceduarit mundëson një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Informacioni që përcillet edhe ai në distancë është lehtësisht i arritshëm dhe i ndihmon studentët që të informohen në kohën e duhur në lidhje me programin e studimit, por edhe mbi detyrimet akademik të tyre në tërësi. Çdo student ka llogarinë e tij personale ku logohet në sistem. Informacioni i nevojshëm publikohet herë pas here, në udhëzues dhe faqen zyrtare të UAMD-së. Kontakte me studentët kryhen si nga sekretaria mësimore ashtu edhe nga Drejtuesja e Departamentit në lidhje dhe me problematikat e ecurisë së procesit mësimor dhe me procedurat e diplomimit. Aneks 6, Aneks 9, Aneks 48			
Konkluzione	<p>- Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin dhe në vijim nga ana e Koordinatorit të programit të studimit, nga zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe nga stafi akademik pjesë e DT dhe më konkretisht e programit të studimit MP GTSH.</p> <p>- Departamentit në çdo fillimviti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabus-et e përcaktuara në planin mësimor të programit të studimit MPGTSH, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin etj.</p> <p>- Studentëve me qëllim motivimin personal dhe orientimin sa më të mirë në tregun e punës, u përcillet informacion periodik lidhur me mundësitë për trajnime, pjesëmarrje në programe shkëmbimi me student, mundësi intership-i dhe letër rekomandimi për mbështetje ndaj tyre etj.</p> <p>- Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, përmes ditëve të orientimit, por edhe përmes udhërrëfyesit informative, mbi programet e studimit në FB, fletëpalosjeve, informacionit on-line që publikohet në website-n e UAMD, FB, DT. - Përmes mënyrave të ndryshme përfshi dhe qasjen on-line, në web faqen e UAMD, të FB, përcillen informacione të plota në lidhje me këtë program studimi, të cilat janë të aksesueshme jo vetëm nga ana e studentëve të FB, por edhe nga ata në distancë, kjo e përcaktuar si në Rregulloren e Masterit GTSH, Rregulloren e sekretarisë mësimore dhe Rregulloren e Fakultetit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentët deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria Mësimore (Masterit) në FB dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës në të gjitha vitet e studimit. Në Sekretarinë mësimore (Masterit) dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomës. Këto të dhëna arkivohen bazuar në ligjin mbi arkivimin e dokumentacionit zyrtar. Sekretaria mësimore administron të gjithë dokumentacionin për çdo student të regjistruar në këtë program studimit, të çregjistruar, të transferuar, të diplomuar, gjatë viteve akademike që nga brezi i parë i diplomimit në vitet 2019-2020. Mbështetur në të dhënat Aneks RVB-Tabelat përmbledhëse, MPGTSH dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve në tre vite akademike është:</p> <p>2020-2021 3 studentë 2021-2022 8 studentë 2022-2023 4 studentë</p> <p>Në total rezulton një numër i vogël studentësh që kanë kryer studimit e ciklit të dytë të studimit në MPGTSH; gjithsej 15 studentë në tre breza të diplomuarish. <i>Aneks 27, Aneks 2, Aneks 7, Aneks 51.</i></p> <p><u>Rekomandim: Shohim me vend të rekomandojmë angazhimin më të madh dhe fushatë më efikase orientuese të stafit akademik të DT dhe institucionit UAMD në lidhje me rritjen e numrit të studentëve që duan të ndjekin këtë program studimit. Këtë e bazojmë në faktin se prioriteti i politikave qeveritare në kuadrin e turizmit është shtuar, por edhe sepse rol të rëndësishëm në arritjen dhe garantimin e suksesshëm të punës në këtë program studimit luan dhe bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes universitetesh në vend.</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore e FB administron regjistrin themeltar të çdo studenti ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u bazuar në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FB dhe Rregulloren e programit të studimit. Detyrime si frekuentimi, zhvillimi i laboratorëve apo i detyrave/projekteve të kursit, detyrime të cilat janë parakusht për lejimin në provim, administrohen vetëm nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>Aneks 27.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga kontrolli në Sekretarinë mësimore të FB, sekretarinë mësimore të Masterit, të regjistrin themeltar, në regjistrin e rezultateve akademike të studentit, si dhe në Regjistrin e Diplomave, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve janë të pasqyruara në to. Të dhënat rezultojnë të pasqyruara dhe në databazat përkatëse. Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve për programin e studimit. Informacioni ruhet në databazat e sekretarisë (sistemi i brendshëm). Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale, të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve. Studentët lehtësisht mund të njihen me vlerësimet për lëndë/module përmes aksesit të sistemit PITAGORA.</p>

	<i>Aneks 27, Aneks 2, Aneks 5, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 9, Aneks 51.1.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka të përcaktuar me akte ligjore të gjithë funksionimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore mbi studentët në hyrje dhe në dalje. Institucioni kryen kontrollin periodik në të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e tyre. Gjithashtu UAMD vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që ruhet dhe disponohet nga këto njësi përgjegjëse, në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre në institucion, fakultet dhe programe studimi. Mbajtja, menaxhimi dhe siguria e tyre është një kërkesë ligjore e normuar nga aktet rregullatore të universitetit. <i>Aneks 54, Aneks 5.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstatoi se njësia kryesore Fakulteti i Biznesit dhe njësia bazë Departamenti i Turizmit hartojnë raporte analitike (periodike) vjetore që plotësohen sipas një formati të përcaktuar nga rektorati. Përmes tij jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamentit, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtarinë shkencore, ngarkesën mësimore të pedagogëve, publikimet, bashkëpunimet dhe partneritetet, etj. Sugjerim: Në funksion të raporteve analitike mund të hartohen edhe analiza të tjera, p. sh., analiza e tregut të punës, etj. Përmes të dhënave të pasqyruara në raportet analitike kryhet dhe vlerësimi i performancës dhe identifikimi i nevojave, në funksion të përmirësimit të punës dhe arritjeve në drejtim të realizimit të objektivave formues të programit të studimit. Kontaktet e vazhdueshme të Departamentit të Turizmit dhe Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës me studentët e diplomuar mundësojnë përpilimin e tabelave me të dhëna mbi cilësinë e punësimit. <i>Aneks 29, Aneks 38.1, Aneks 38, Aneks 37.</i>
Konkluzione	<p>- <i>Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentët deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria Mësimore (Masterit) në FB dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës në të gjitha vitet e studimit. Në total rezulton një numër i vogël studentësh që kanë kryer studimit e ciklit të dytë të studimit në MPGTSH, gjithsej 15 studentë në tre breza të diplomuarish.</i></p> <p>- <i>Rekomandim: Shohim me vend të rekomandojmë angazhimin më të madh dhe fushatë më efektive orientuese të stafit akademik të DT dhe institucionit UAMD në lidhje me rritjen e numrit të studentëve që duan të ndjekin këtë program studimit. Këtë e bazojmë në faktin se prioriteti i politikave qeveritare në kuadrin e turizmit është shtuar, por edhe sepse rol të rëndësishëm në arritjen dhe garantimin e suksesshëm të punës në këtë program studimit luan dhe bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes universitetesh në vend.</i></p> <p>- <i>Sekretaria mësimore e FB administron regjistrin themeltar të çdo studenti ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u bazuar në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FB dhe Rregulloren e programit të studimit.</i></p>

	<p>- Nga kontrolli në Sekretarinë mësimore të FB, sekretarinë mësimore të Masterit, të regjistrit themeltar, në regjistrin e rezultateve akademike të studentit, si dhe në Regjistrin e Diplomave të dhënat statistikore të studentëve janë të pasqyruara në to. Të dhënat rezultojnë të pasqyruara dhe në databazat përkatëse.</p> <p>- Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve për programin e studimit. Informacioni ruhet në databazat e sekretarisë (sistemi i brendshëm).</p> <p>- Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka të përcaktuar me akte ligjore të gjithë funksionimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore mbi studentët në hyrje dhe në dalje. Institucioni kryen kontrollin periodik në të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e tyre.</p> <p>- Njësia kryesore Fakulteti i Biznesit dhe njësia bazë Departamenti i Turizmit hartojnë raporte analitike (periodike) vjetore që plotësohen sipas një formati të përcaktuar nga rektorati. Përmes tij jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamentit, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtarinë shkencore, ngarkesën mësimore të pedagogëve, publikimet, bashkëpunimet dhe partneritetet, etj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në zbatim të Ligjit të arsimit të lartë dhe Rregullores dhe Statutit të UAMD, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjinale si: Senati Akademik; Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët; Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve dhe cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i Etikës, Këshillat studentore. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore mbështetet në: Ligji 20/2015 "Për Arsimin e Lartë", Statutin e UAMD-së, Rregulloren e UAM D. <i>Aneks 2, Aneks 5, Aneks 6.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	GVJ konstaton se UAMD garanton përfshirje të studentëve përmes përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, kryesisht në përfaqësimin e tyre në organe kolegjinale, në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetësorëve. Përpunimi dhe rezultatet e nxjerra nga këta pyetësor reflektohen në raportet vjetore të institucionit dhe në marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përfshirja reale e studentëve përmes përfaqësimit studentor në forume apo organizime studentore synon përcjelljen e zërit

<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>të tyre në forumet e hallkat me të larta institucionale të UAMD. Senati Akademik në UAMD përbëhet nga 21 anëtarë, ku 2 prej tyre janë studentë. Këto të drejta përfaqësimi përcaktohen qartësisht në Rregulloren e UAMD si dhe në Rregulloren e programit të studimit MPGTSH. <i>Aneks 7, Aneks 13, Aneks 28, Aneks 37, Aneks 66, Aneks 71, Aneks 97.1, Aneks 97.2</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Njësia bazë Departamenti i Turizmit garanton përfshirjen e studentëve si pjesë e komisioneve/organeve kolegjiale, përmes të cilave ata kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë në këtë mënyrë kontributin e tyre me vlerë në të gjitha organet kolegjiale ku ata kanë të drejtë përfaqësimi. Si pjesë e rëndësishme e raporteve që hartohen nga NJSBC luajnë dhe merren dhe sugjerimet dhe kontributet e studentëve në nivel departamenti, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për programet e studimit që ato ndjekin.. Masteri Profesional GTSH i nisur që në vitin akademik 2019-2020 e në vazhdim në kuadër të ecurisë dhe përmirësimit të programit të studimit, është parë nga ana e Departamentit, si nja nga prioritetet e tij. Nisur nga një qëllim i tillë në departament janë përgatitur pyetësorë, lidhur me problematikat që janë shfaqur tek ato gjatë periudhës së studimit, të dhënat e mbledhura prej tyre janë marrë në konsideratë në punën e mëtejshme të departamentit për përmirësime në këtë drejtim.</p> <p><i>Aneks 6, Aneks 6.1, Aneks 7, Aneks 72, Aneks 72.1</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu/ët i/e lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, siç është vlerësimi i provimit të lëndës, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi/ese etj. Studentëve u mundësohet si një e drejtë e tyre njohja me: procedurën e zhvillimit të kontrollit të dijeve, tezën e provimit pas korigjimit dhe mënyrën e vlerësimit (njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë) si dhe të drejtën e ankimimit. Student ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit dhe rezultatin e tij përfundimtar. Anketimi në lidhje me problematikat e shfaqura në këtë aspekt i kryer nga ana e departamentit me studentët, ka ndihmuar dhe dhënë mundësi që çdo pedagog përgjegjës për lëndën/modulin të reflektojë mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga anketimet.</p> <p><i>Aneks 40, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 8, Aneks 66.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>- Në zbatim të Ligjit të arsimit të lartë dhe Rregullores dhe Statutit të UAMD, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik; Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënies me studentët; Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve dhe cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i Etikës, Këshillat studentore.</p> <p>- UAMD garanton përfshirje të studentëve përmes përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, kryesisht në përfaqësimin e tyre në organe kolegjiale, në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera</p>

	<p>akademike, përmes pyetësorëve. Njësia bazë Departamenti i Turizmit garanton përfshirjen e studentëve si pjesë e komisioneve/organeve kolegjiale, përmes të cilave ata kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë në këtë mënyrë kontributin e tyre me vlerë në të gjitha organet kolegjiale ku ata kanë të drejtë përfaqësimi.</p> <p>- Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu/ët i/e lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, siç është vlerësimi i provimit të lëndës, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi/ese etj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar te dokumentacioni kryesor zyrtar ligjor i UAMD, Rregullore, Statut, Rregullore e programit të studimit etj., funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: zyra IT, Njësia bazë, Koordinatori i programit të studimit, koordinatori akademik, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli studentor, Biblioteka e UAMD (FB), Sekretaria mësimore. Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës. <i>Aneks 2, Aneks 5, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 10, Aneks 12, Aneks 47, Aneks 51.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti, ndihmon studentët që hasin vështirësi në përvetësimin e lëndëve/moduleve apo në plotësimin e detyrimeve të ndryshme akademike të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, si dhe mbështetjen dhe konsultimin që ofrohet nga pedagogët e departamentit në lidhje me diplomimin në përfundim të këtij cikli përmes koordinorit dhe stafit akademik të tij Në ndihmë në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë u ofrohet dhe nga ana e departamentit vëmendje dhe mbështetje dhe nga ana e stafit ndihmës-akademik dhe administrative, me qëllim lehtësimin dhe informimin në kohë. Njoftimet përkatëse dhe këshillimet e studentëve bëhen në fillim të çdo viti akademik nga: Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, por dhe nëpërmjet sistemit të deklarimit të rezultateve Pitagora, të cilat ruhen në bazë të ligjit të konfidencialitetit. <i>Aneks 2, Aneks 6, Aneks 7, Aneks 8, Aneks 10, Aneks 12, Aneks 46, Aneks 51.1, Aneks 75.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e këshillimit të karrierës, Alumnit dhe Zyra e komunikimit, jep informacion të vlefshëm në lidhje me studentët në këtë program studimi, duke i informuar ata sa u përket institucioneve me të cilat fakulteti/departamenti ka marrëveshje, mundësi internship-i etj. Nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të vazhdueshme, studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit. Studentët asistohen për këtë qëllim dhe marrin informacionin e nevojshëm që i vlen atyre për t'u orientuar dhe projektuar më mirë tregun e punës. Zyrat i ofrojnë studentëve orientim në tregun e punës, në ndihmë të përgatitjes së CV-ve, letrave të interesit dhe përgatitjet për intervista pune.</p> <p>Aneks 12, Aneks 111, Aneks 134.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti mban lidhje me të gjithë të diplomuarit (të numër të kufizuar) në këtë program studimi MPGTSH. Mbledhja e të dhënave për të diplomuarit në këtë program studimi nga ana e departamentit, është përfshirë dhe në një raport të fundit të tij. Gjurmimi i të diplomuarve në vitin akademik në vite akademike (tre vite) është bërë në bazë të zbatimit të strategjisë së zhvillimit të UAMD. Të dhënat bëhen pjesë e raporteve vjetore të departamentit dhe u përcillen organeve/autoriteteve drejtuese të fakultetit/universitetit. Aneks 12.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>- Bazuar te dokumentacioni kryesor zyrtar ligjor i UAMD, Rregullore, Statut, Rregullore e programit të studimit etj., funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: zyra IT, Njësia bazë, Koordinatori i programit të studimit, koordinatori akademik, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli studentor, Biblioteka e UAMD (FB), Sekretaria mësimore. Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës.</p> <p>- Departamenti, ndihmon studentët që hasin vështirësi në përvetësimin e lëndëve/moduleve apo në plotësimin e detyrimeve të ndryshme akademike të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, si dhe mbështetjen dhe konsultimin që ofrohet nga pedagogët e departamentit në lidhje me diplomimin në përfundim të këtij cikli përmes koordinorit dhe stafit akademik të tij.</p> <p>- Zyra e këshillimit të karrierës, Alumnit dhe Zyra e komunikimit, jep informacion të vlefshëm në lidhje me studentët në këtë program studimi, duke i informuar ata sa u përket institucioneve me të cilat fakulteti/departamenti ka marrëveshje, mundësi internship-i etj.</p> <p>- Departamenti mban lidhje me të gjithë të diplomuarit (të numër të kufizuar) në këtë program studimi MPGTSH. Mbledhja e të dhënave për të diplomuarit në këtë program studimi nga ana e departamentit, është përfshirë dhe në një raport të fundit të tij. Gjurmimi i të diplomuarve në vitin akademik në vite akademike (tre vite) është bërë në bazë të zbatimit të strategjisë së zhvillimit të UAMD.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka jo vetëm në fokus të punës së tij zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit, por dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme. Në realizimin e këtyre qëllimeve rëndësi iu kushtohet metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies mbështetur në Rregulloren e NJBSC, (Nenin 1, Nenin 5). Cituar Nenin 1 të kësaj Rregulloreje, që synon dhe garanton bazën ligjore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve në institucion. Ndërsa në Nenin 5 shpallosen 10 standardet kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë, DKSC-së informacionet përkatëse, konsultimi me të, sidomos në rastet kur gjykohet e nevojshme. <i>Aneks 8.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, konstaton se në UAMD është ngritur dhe funksionon Sistemi i tij i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë. Strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik, (Nenin 1, Neni 5 i Rregullores NJSBC). Mekanizmat e përdorura për monitorimin e aftësive të sanksionuara në Rregullore janë: formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik, CV-të e përditësuara të stafit akademik; formularët e vlerësimit të cilët plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe më pas nga Dekani. Angazhimi i degës mësimore lidhet me matjen e performancës së mësimdhënies, sipas një procesi që ka në bazë vlerësimin e studentëve mbi performancën e lektorëve, i cili maksimizon vërtetësinë e të dhënave apo gjetjeve, dhe që realizohet përmes projektit CleanScore. <i>Aneks 8, Aneks 40, Aneks 68.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Për matjen e cilësisë, përveç instrumenteve të parashikuar e përdoruar nga ana institucionit, vend dhe rol të rëndësishëm luajnë dhe studentët, vlerësim që matet në lidhje me instrumentet që ky institucion përdor si: Pyetësorë dhe vlerësime të studentëve; Fokus grupe me studentët; raporte vlerësimi lidhur me pedagogët etj. Përmes këtij roli synohet përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, që kryhet në fund të çdo semestri ore para provimeve në mënyrë periodike përmes plotësimit të formularëve, por dhe në të drejtën e tyre për ankimim, Raporti vjetor i departamentit etj. Të gjitha këto instrumente i referohen bazës ligjore si Rregullores së UAMD-së, Nenin 6 të NJSBC.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe në kontaktet që realizoi me grupe të ndryshme sipas agjendës u njoh me këto dokumente: vlerësimin e brendshëm i hartuar në bazë kriteresh si: vetë-analizën; treguesit e cilësisë; vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve; vlerësimin e studentëve, vlerësimin e programeve mësimore, kurrikulës së</p>

	<p>programeve të disiplinave; vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore; vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve kombëtare/rajonale, mënyrën e hartimit të pyetësorëve studentorë dhe analizën e të dhënave të marra prej tyre në funksion të vlerësimit e cilësisë së mësimdhënies, nivelit të stafit akademik në këtë program studimit. Këtij procesi vlerësimi i bashkëngjiten dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, në lidhje me vlerësimin e punës dhe realizimin e objektivave, mangësitë dhe vështirësitë e hasura, por edhe aspektet sugjeruese në lidhje me programin e studimit MPGTSH. Nga analiza e thellë e të dhënave dhe reflektimi në kohë mund të arrihen rezultatet e pritura në përmirësimin e punës në kuadër të sigurimit të cilësisë në Universitet. <i>Aneks 3, Aneks 3.2, Aneks 5, Aneks 8, Aneksi 40, Aneks 71, Aneks 72.1.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Një nga dokumentet bazë dhe të rëndësishëm që prodhohen nga mekanizmat e sigurimit të cilësisë, është raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësive bazë, i cili hartohet dhe merret në analizë në fund të vitit akademik, për t'u integruar më tej në raportet në nivel njësie kryesore. Vend të rëndësishëm në to zënë veç të tjerash dhe raportet e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe karrierës lidhur me pyetësorët e studentëve. Nga vizita e GVJ në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur evidentohet se institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke angazhuar dhe studentët dhe të gjitha strukturat përgjegjëse në këtë drejtim. Këto struktura në lidhje me monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në UAMD, paraqesin dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik. Të dhënat e marra prej tyre i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, dhe të gjithë anëtarëve në mënyrë individuale të stafit akademik në programin e studimit përkatës. <i>Aneks 66</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se së UAMD ndërmerren politika për sigurimin e cilësisë, është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel të njësive kryesore; kryhen herë pas here veprimtari monitoruese, vlerësuese dhe përmirësuese. Në politikat e ndjekura për sigurimin e cilësisë si proces përfshihen: rishikimi, përditësimi i parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit. UAMD, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ka jo vetëm në fokus të punës së tij zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit, por dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme.</i> - <i>Në UAMD është ngritur dhe funksionon Sistemi i tij i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë. Strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të</i>

	<p>ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Mekanizmat e përdorura për monitorimin e aftësive të sanksionuara në Rregullore janë: formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik, CV e përditësuara të stafit akademik; formularët e vlerësimit të cilët plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe më pas nga Dekani.</p> <p>- Angazhimi i degës mësimore lidhet me matjen e performancës së mësimdhënies, sipas një procesi që ka në bazë vlerësimin e studentëve mbi performancën e lektorëve, i cili maksimizon vërtetësinë e të dhënave apo gjetjeve, dhe që realizohet përmes projektit Clean Score.</p> <p>- Për matjen e cilësisë, përveç instrumenteve të parashikuara e përdoruar nga ana institucionit, vend dhe rol të rëndësishëm luajnë dhe studentët, vlerësim që matet në lidhje me instrumentet që ky institucion përdor si: Pyetësorë dhe vlerësime të studentëve; Fokus grupe me studentët; raporte vlerësimi lidhur me pedagogët etj.</p> <p>- Institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke angazhuar dhe studentët dhe të gjitha strukturat përgjegjëse në këtë drejtim. Këto struktura në lidhje me monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në UAMD, paraqesin dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik.</p> <p>- Në UAMD ndërmerren politika për sigurimin e cilësisë, është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore; kryhen herë pas here veprimtari monitoruese, vlerësuese dhe përmirësuese.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se UAMD në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj., ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Në UAMD janë ngritur struktura të sigurimit të cilësisë, por është hartuar dhe një politikë të qartë UAMD-ja lidhur me procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, mbështetur në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, vendimet për komisionet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. NjBSC apo DSBCK kanë mision: NjBSC synon planifikimin e përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit “Aleksandër Moisiu”</p>

	<p>Durrës (UAMD) dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Strukturat në rang njësie kryesore (Fakultetin e Biznesit), nëpërmjet punës së Komisionit për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, harton strategji dhe ndërton politika dhe procedura për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për programet e studimit që ofrohen në të. NJSBC e FB kryen funksione që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe garantimin e standardeve të cilësisë të Fakultetit dhe programeve të studimit; monitoron dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore në programin e studimit “Master Profesional Guida Turistike Shqiptare. Aneks 2, Aneksi 8, Aneksi 37 Aneks 115.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, konstaton se UAMD e ka tashmë të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Si strukturë përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit është NjBSC-në në nivel institucional që ka si funksion: Mbështetjen dhe ofrimin e ekspertizës me çdo fakultetet dhe departament për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, si dhe në asistimin e NjBSC në rang fakulteti. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në garantimin e pjesëmarrjes së personelit të personelit akademik dhe studentëve në procesin e vetëvlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë. NjBSC në nivel institucional, bashkërendon punën me NjBSC-të pranë fakulteteve, por mund të shtrihet edhe në njësi të tjera në universitet kur NjBSC-ja konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale, garanton njohjen dhe përfshirjen që detyrimet të njihen dhe përfshihen nga IAL, monitoron, ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton problem, administron, organizon dhe përgatit vizitat e vlerësimit të jashtëm, përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë sipas niveleve të programeve të studimit, lehtëson vendosjen e një klime të favorshme duke vënë në qendër studentin, për një arsim cilësor, rritje të nivelit akademik të stafit, përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve logjistike gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, evidenton treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm e të jashtëm, mbështetur në legjislacionin shqiptar.</p> <p>Zgjidhjet e propozuara nga NjBSC-ja mbi problematikat e evidentuara, në varësi të nivelit të problemit, përmes Rektorit, mund t’i kalojnë për shqyrtim dhe miratim Senatit Akademik ose KPGSC-së. Në strategjinë që Institucioni harton për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë dhe student, në statusin e anëtarit të Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor.</p> <p>Aneksi 8, Aneksi 115.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes</p>	<p>Institucioni përdor instrumentet e duhura përmes së cilave vlerëson në mënyrë periodike standardet e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. UAMD-ja e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm e të jashtëm të cilësisë, ku përfshihen student dhe</p>

<p>procese të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>ekspertë në këto procese përmes adoptimit të politikave dhe standardeve për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Nga vizita e GVJ në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur evidentohet se institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike në bashkëpunim me ASCAL. UAMD ju nënshtroa në vitin 2016 procesit të Akreditimit Institucional duke rezultuar i akredituar në 5 vite. Programi i studimit Master Profesional GTSH, në vitin 2022-2023 i është nënshtroar për herë të parë procesit të akreditimit (procesin e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit). Aneks 8, Aneks 57.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në UAMD ndërmerren politika për sigurimin e cilësisë, është ngritur dhe funksionon sistemi I menaxhimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel të njësive kryesore; kryhen herë pas herë veprimtari monitoruese, vlerësuese dhe përmirësuese. Në çdo fund semestri Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë organizon anketimin nga studentët mbi stafin akademik. Në politikat e ndjekura për sigurimin e cilësisë si process përfshihen: rishikimin, përditësimin e parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimi dhe përmirësimi e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit, mbështetur në sistemin dhe garantimin e transparencës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatorët e programeve përgatisin raporte periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim. - DKSC realizon Raportin e vetëvlerësimit për çdo vit akademik. <p>NjBSC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kriterëve dhe standardeve të paracaktuara në Kodin e Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Aneks 8.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UAMD në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj., ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Në UAMD janë ngritur struktura të sigurimit të cilësisë, por është hartuar dhe një politikë të qartë lidhur me procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, mbështetur në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, vendimet për komisionet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. - NjBSC në nivel institucional, bashkërendon punën me NjBSC-të pranë fakulteteve, por mund të shtrihet edhe në njësi të tjera në universitet kur NjBSC-ja konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i

	<p>personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale, garanton njohjen dhe përfshirjen që detyrimet të njihen dhe përfshihen nga IAL, monitoron, ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton problem, administron, organizon dhe përgatit vizitat e vlerësimit të jashtëm, përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë sipas niveleve të programeve të studimit, lehtëson vendosjen e një klime të favorshme duke vënë në qendër studentin, për një arsim cilësor, rritje të nivelit akademik të stafit, përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve logjistike gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, evidenton treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm e të jashtëm, mbështetur në legjislacionin shqiptar.</p> <p>- Institucioni përdor instrumentet e duhura përmes së cilave vlerëson në mënyrë periodike standardet e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. UAMD-ja e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm e të jashtëm të cilësisë, ku përfshihen student dhe ekspertë në këto procese përmes adoptimit të politikave dhe standardeve për sigurimin e cilësisë.</p> <p>- Institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike në bashkëpunim me ASCAL.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse</p>	<p>GVJ konstaton se programet e studimit që ofrohen nga departamenti, rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie, për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij program studimi dhe me nevojat e tregut të punës në mënyrë të herëpashershme. GVJ konstaton se UAMD ka përcaktuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve. Syllabus-et rishikohen në fillim të vitit akademik, në nivel departamenti, nga pedagogët përkatës. Bashkë me syllabus-et, nëse gjykohet e nevojshme mund të rishikohet edhe kurrikula për programin e 20 % të tij. Ky informacion dokumentohet dhe i dërgohet zyrtarisht në formë shkresore, Rektoratit të UAMD (drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë), dhe më pas për t'u shqyrtuar nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, si struktura përgjegjëse për vlerësimin e projektprogrameve të paraqitura. Sistemi i sigurimit të cilësisë, si proces i brendshëm në UAMD përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese për të cilën ofrohen strukturat e saj si NjBSC dhe realizohet nëpërmjet</p>




<p>dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>monitorimeve të përvitshme dhe publikimit të raporteve të analizës mësimore. Në çdo gjashtë vite kryhen dhe raportet e vetëvlerësimit të GVB institucionale në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL. Lektorët në mënyrë të periodike dorëzojnë te koordinatorët e kërkimit shkencor formularët e raporteve të veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore. UAMD përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregullores së NJSBC. Zyra Mësimore dhe e Kurrikulës në bashkëpunim me FB hartojnë standardet në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR, të cilat përdoren nga departamenti për kryerjen e vlerësimit të programit të studimit. Programet e studimit në Fakultetin e Biznesit synojnë të ofrojnë kurrikula bashkëkohore në kuadër të përfitimit nga ana e studentëve të një niveli sa më të mirë akademik dhe te kompetencave të gjëra në përputhje koherente me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit MP GTSH nuk i është nënshtruar më parë një procesi akreditimi. <i>Aneks 2, Aneks 6, Aneks 8, Aneks 37, Aneks 38, Aneks 40, Aneks 63, Aneks 55, Aneks 72.1.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Të gjitha këto raporte të analizave vjetore në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe raporti i NJSBC paraqesin përveç rezultateve të pritshme, edhe adresime të mangësive të ndryshme për përmirësimin e cilësisë. Raportet gjenden të publikuara dhe në faqen zyrtare të UAMD. Si një element shumë i rëndësishëm i përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik. DKSC realizon për çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Raporti hartohet duke u bazuar në 5 fushat e vlerësimit: Organizimi dhe Menaxhimi; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi. Në evidencat e paraqitura në këtë raport vlerësimi gjykohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore, analizimi i nevojave dhe vendosja e synimeve për zhvillimin e cilësisë në Fakultetin i Biznesit dhe Departamentin e Turizmit. Departamenti realizon analiza vlerësuese, krahasuese në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit si dhe për programin e ofruar në fushën e turizmit, i cili është në vitin e tretë të nxjerrjes së specialistëve të kësaj fushe. <i>Aneks 18, Aneks 37, Aneks 38, Aneks 38.1, Aneks 57, Aneks 71, Aneks 97.1, Aneks 97. 2.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta. Në morinë e metodave për procesin e vlerësimit si: vlerësim cilësor i mësimdhënies, metodologjisë së përdorur të mësimdhënies, kurrikulës, rezultateve të të nxëniet; testet etj. UAMD-ja përfshin të dhënat e raporteve semestrale, siç janë përqindjet e kalueshmërisë, nota mesatare apo realizimi i objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Gjithashtu pjesë të këtyre metodave të vlerësimit lidhen me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuse-ve, provimeve. Strukturat e SBSC</p>

<p>studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>janë (DKSC), (NjBSC-të në nivel Fakulteti) dhe (Koordinatorët e Programeve), (NjBSC në nivel institucional). Rol të rëndësishëm luan dhe vlerësimi i performancës së stafit të brendshëm e të jashtëm akademik në programin e studimit, veprimtaria e të cilit kontrollohet përmes: plotësimit në mënyrë periodike të CV-së dhe dosjeve e tyre të vetëvlerësimit si në njësinë bazë ashtu dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. UAMD, FB dhe DT në mënyrë periodike realizon monitorimin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së praktikave, leksioneve të hapura etj., në funksion të mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit. Aneks 2, Aneks 8, Aneks 7, Aneksi 10.3, Aneks 66.1.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, nëpërmjet NJSBC-së, përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi si: Pyetësorë të ndryshëm dhe vlerësime të studentëve sipas formateve të përcaktuara në Paketën e Instrumenteve të Cilësisë UAMD dhe Raporti vetëvlerësimit nga stafi akademik. Departamenti i Turizmit zhvillon anketime/pyetësorë me studentët, duke synuar anonimatin me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve. Pyetësorët shërbejnë për të marrë mendimin e studentëve për programin përkatës të studimit Master Profesional Guidë turistike shqiptare që ata ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij. Të dhënat e përpunuara i paraqiten departamentit të Turizmit nga NJSBC për vlerësim dhe analizë të mëtejshme. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senati, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të UAMD-së, këshillave studentore, Komisionit të Etikes, etj. Metoda dhe instrumentet e përdorura në vlerësim dhe palët që përfshihen në këtë proces janë të përcaktuara në rrugë ligjore në Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Sigurisë. Një prej instrumenteve për analizën e arritjeve e të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës. Aneksi 4, Aneksi 5, Aneksi 6, Aneksi 8, Aneksi 10.3, Aneksi 40, Aneks 72.1.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Programet e studimit që ofrohen nga departamenti, rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie, për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij program studimi dhe me nevojat e tregut të punës.. - UAMD ka përcaktuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve. Syllabus-et rishikohen në fillim të vitit akademik, në nivel departamenti, nga pedagogët përkatës. Bashkë me syllabu-set, nëse gjykohet e nevojshme mund të rishikohet edhe kurrikula për programin e 20 % të tij. Ky informacion dokumentohet dhe i dërgohet zyrtarisht në formë shkresore, Rektoratit të UAMD, dhe më pas për t'u shqyrtuar nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. <p>-Sistemi i sigurimit të cilësisë, si proces i brendshëm në UAMD përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese për të cilën ofrohen strukturat e saj si NjBSC dhe realizohet nëpërmjet monitorimeve të përvitshme dhe publikimit të raporteve të</p>

	<p><i>analizës mësimore. Në çdo gjashtë vite kryhen dhe raportet e vetëvlerësimit të GVB institucionale në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL.</i></p> <p><i>- UAMD përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregullores së NJSBC. Zyra Mësimore dhe e Kurrikulës në bashkëpunim me FB hartojnë standardet në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR, të cilat përdoren nga departamenti për kryerjen e vlerësimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>-Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta.</i></p> <p><i>- UAMD-ja përfshin të dhënat e raporteve semestrale, siç janë përqindjet e kalueshmërisë, nota mesatare apo realizimi i objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Gjithashtu pjesë të këtyre metodave të vlerësimit lidhen me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuse-ve, provimeve. Rol të rëndësishëm luan dhe vlerësimi i performancës së stafit të brendshëm e të jashtëm akademik në programin e studimit, veprimtaria e të cilit monitorohet në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>- Nëpërmjet NJSBC-së përdoren edhe metoda të tërthorta vlerësimi si: Pyetësorë të ndryshëm dhe vlerësime të studentëve sipas formateve të përcaktuara në Paketën e Instrumenteve të Cilësisë UAMD dhe Raporti vetëvlerësimit nga stafi akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Vlerësimi i ekspertëve Mbështetur në gjithë dokumentacionin zyrtar të tij, UAMD parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm e të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet dhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Senati Akademik e deri te GVB, në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në Bordin e Administrimit, NjBSC të fakultetit dhe në formë këshillimore, përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, UAMD ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimin të programit të studimit. Departamenti i Turizmit dhe Fakulteti i Biznesit, mundëson dhe është i hapur për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar



	për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet takimeve, konsultave, ftesave të personaliteteve të fushës etj. Aneks 5, Aneks 6, Aneks 6.1, Aneksi 76.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ, nga baza dokumentare e paraqitur dhe nga vizita në institucion, konstatoi se përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në nene të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe në Rregulloren e Fakultetin e Biznesit. UAMD përcakton përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, por dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet përmes pjesëmarrjes së tyre në mbledhjet e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm. Aneksi 6, Aneksi 6.1, Aneks 8.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Siç rezultoi nga evidencat e vëna në dispozicion për vlerësimin e jashtëm si dhe nga verifikimet nga vizita në institucion, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë dhe njësia kryesore me strukturat e saj. Roli i tyre është i mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësinë në UAMD. Fakulteti i Biznesit ka përfaqësuesit e saj në Njësinë e Brendshme për sigurimin e Cilësisë dhe Standardeve, dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës. Aneks 2, Aneks 5, Aneks 8, Aneks 28.1.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në respekt të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Në proceset ciklike të vlerësimit aktivizimi dhe përfshirja e aktorëve të brendshëm shmang çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve. Edhe pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike ruajnë anonimatit dhe konfidencialitetin e tyre. Aneks 5, Aneks 8.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga evidentimi i bërë, rezultojnë që në aspektet e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhen dhe takime dhe me përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë. Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, të cilët japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Aneks, Aneks 6, Aneks 8, Aneks 30.
Konkluzione	GVJ konstatoi si:

	<p>-UAMD parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm e të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Studentëve ju garantohet dhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Senati Akademik e deri te GVB, në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në Bordin e Administrimit, NjBSC të fakultetit dhe në formë këshillimore, përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit.</p> <p>- UAMD përcakton përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, por dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>- Përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë dhe njësia kryesore me strukturat e saj. Në proceset ciklike të vlerësimit aktivizimi dhe përfshirja e aktorëve të brendshëm shmang çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>- Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, të cilët japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UAMD/FB janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UAMD ka krijuar programin e transparencës e cila është dhe publike në webfaqen e tij. UAMD ka bërë publike raportet e përvitshme vjetore nëpërmjet publikimit të tyre në manuale, në takime të hapura të organizuara me asamblenë e Fakultetit të Biznesit për studentët, por edhe të tjerë të interesuar për tu marrë informohen në lidhje me funksionimin dhe rezultatet e sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UAMD.. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që kanë në fokus Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin MPGTSH, në mënyrë transparente, janë të publikuara në faqet zyrtare: www.uamd.edu/al , Facebook: uamd, faqe zyrtare Fakulteti i Biznesit, faqe zyrtare Departamenti Turizmit, faqe zyrtare Instagram etj. Aneks 38, Aneks 47, Aneks 51.

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë UAMD-ja dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit, i cili bëhet në përputhje me format e miratuara nga Senati Akademik i UAMD. UAMD garanton se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë.</p> <p>Në UAMD, rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, dhe gjithë informacioni që disponohet për këtë qëllim, publikohet në dokumentacionet përkatëse apo online, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces. <i>Aneks 40, Aneks 52, Aneks 37.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se në fund të vitit akademik, Departamenti i Turizmit harton raportin vjetor, me të gjitha komponentët e rezultateve të arritura vjetore, dhe mbi bazën e së cilës bëhet një analizë e ecurisë së tij dhe programeve që ofron, me synim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. <i>Aneks 37, Aneks 38, Aneks 40, Aneks 57.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se një vullnet i mirë dhe i qartë nga ana e UAMD në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi.</p> <p>UAMD ka praktika të mira në drejtim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përfshirjes së stafit në trajnime e projekte ndërkombëtare, - Bashkëpunime të cilat kanë sjellë përmirësime në hartimin e kurrikulave; - Mbështet kërkimin shkencor nga lektorët me anë të financimit të pjesëmarrjes se tyre në aktivitete shkencore; kombëtare/ndërkombëtare; - Mbështet kërkimin shkencor nga studentet përmes organizimit të konferencave studentore, workshop, start-up etj. Institucioni mbështet (Neni 38, rregullore e UAMD-se) kërkimin shkencor të lektorëve në UAMD, dhe i vlerëson në mënyrë periodike përmes vlerësimit të performancës së përgjithshme të lektorit. <i>Aneks 68, Aneks 85.</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur GVJ konstaton se UAMD kryen një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në mënyrë periodike janë organizuar disa veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Me GVB-të e njëjësive të UAMD-së organizohen trajnime, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e këtyre grupeve të vlerësimit, në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Institucioni ka publikuar të gjithë informacionit që lidhet me procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në udhëzues, webfaqen e UAMD, FB etj., me qëllim rritjen e transparencës për këtë proces të rëndësishëm, të universitetit, dhe për të ndërgjegjësuar studentët dhe personelin akademik për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit afatgjatë të saj në programin e</p>

	studimit. Departamenti i Turizmit garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimit MPGTSH. <i>Aneks 51, Aneks 47.</i>			
Konkluzione	<p><i>-Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UAMD/FB janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</i></p> <p><i>- UAMD-ja dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit, i cili bëhet në përputhje me format e miratuara nga Senati Akademik.</i></p> <p><i>- UAMD garanton se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë.</i></p> <p><i>- GVJ konstaton se në fund të vitit akademik, Departamenti i Turizmit harton raportin vjetor, me të gjitha komponentët e rezultateve të arritura vjetore, dhe mbi bazën e së cilës bëhet një analizë e ecursionit të tij dhe programeve që ofron, me synim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura.</i></p> <p><i>- UAMD kryen një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në mënyrë periodike janë organizuar disa veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>- Me GVB-të e njësive të UAMD-së organizohen trajnime, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e këtyre grupeve të vlerësimit, në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Guidë Turistike Shqiptare”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës”

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


 Faqe 90
 

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Njëpërmjet programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Guidë Turistike Shqiptare", Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, ofron një kurrikul cilësore, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Studentëve u sigurohet një përgatitje teorike cilësore, si dhe mundësia e punësimit në profesionin e tyre, në kompani apo agjenci private, si operatorë turistikë ose si profesionistë të lirë, në varësi të nevojave të tregut.
2. Programi i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Guidë Turistike Shqiptare", i ofruar nga Fakultetit të Biznesit, realizohet mbi një organizimi strukturor mjaft të mirë, si dhe në potenciale njerëzore, akademike (me tituj e grada) e potenciale drejtuese, çka e dëshmojnë më së miri arritjet e tij ndër vite. Infrastruktura e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës ofron hapësira të mjaftueshme për zbatimin e programit të studimit, veçanërisht në kampusin e ri universitar, ku ndodhet edhe fakulteti i lartpërmendur.
3. Stafi akademik i programit të studimit është i përfshirë gjerësisht në kërkimin shkencor, si dhe merr pjesë në projekte kërkimore, gjë që dëshmohet nga angazhimi i tyre i konsiderueshëm në botime dhe studime shkencore, të cilat përfshijnë monografi, artikuj shkencorë, tekste shkollore, etj. E gjithë veprimtaria e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm vihen në shërbim të studentëve, jo vetëm për kurrikulën e lëndës së studimit, por edhe për kryerjen e praktikës profesionale.
4. Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, ofron salla leximi me kapacitet të mjaftueshëm. Në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve janë kompjuter me qasje në internet dhe të lidhur me biblioteka të tjera vendase dhe ndërkombëtare. Përveçse përmes librave, literatura kryesore dhe ndihmëse që u vihet në shërbim stafit dhe studentëve, ofrohet edhe njëpërmjet literaturës on-line, përmes abonimit në 30 revista shkencore ndërkombëtare, në mbi 600 tituj librash akademikë, në gjuhë të ndryshme, si dhe qasje në periodikun shqip të periudhës 1945 – 2007.
5. Marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me organizma të ndryshëm turistikë, si publikë dhe privatë, në mënyrë që studentët e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Guidë Turistike Shqiptare" të kryejnë praktikën e tyre profesionale dhe të përparojnë në formimin e tyre, çka çon në promovimin e programit të studimit në nivel vendor dhe jo vetëm.
6. Strategjia e ndërkombëtarizimit në nivel institucioni, e cila shtrihet edhe tek fakulteti dhe departamenti që organizojnë e ofrojnë programin e studimit Master Profesional "Guidë Turistike Shqiptare", bën të mundur që studentët të transferojnë studimet në universitetet rajonale, si dhe ata kontinentale e më gjerë.
7. Zbatimi i teknologjisë digjitale dhe platformave on-line (platforma "Pitagora", për menaxhimin e të dhënave të studentëve; platforma "Moodle", për zhvillimin e mësimit online; si dhe "Clean Score"), në mënyrë që të sigurohet zbatimi optimal i procesit mësimor, si dhe realizimi i provimeve e vlerësimi objektiv i tyre.

Pika të dobëta:

1. Mundësi të kufizuara mobiliteti për studentët, të cilët prirën drejt përvojave studimore në auditorët e institucioneve arsimore të huaja, por edhe jashtë tyre. **(Standardi I.3)**
2. Mungesa e mjeteve ndihmëse teknologjike në mbështetje të realizimit të procesit mësimdhënies në programin e studimit MPGTSH (programe të veçanta për kryerjen e

Rekomandime:

1. Rekomandohet që Departamenti i Turizmit dhe stafi i tij akademik, veçanërisht ai i angazhuar në programin e studimit MPGTSH, të realizojë një shfrytëzim sa më efikas të mjeteve elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, në kryerjen më së miri jo vetëm të aktiviteteve mësimore, por edhe të atyre me natyrë praktike. Në laboratorët ekzistues duhet të instalohen programe profesionale, sidomos në këtë program studimi, pasi në kuadër të ndërkombëtarizimit duhet të hidhen hapa konkretë, që ai t'u përshtatet kërkesave dhe tregut të punës në nivel lokal e më gjerë.
2. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Fakulteti i Biznesit, si dhe njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit MPGTSH, duhet të punojnë për të hedhur ura bashkëpunimi me IAL-të e tjera në Shqipëri e më gjerë, të cilat ofrojnë një program studimit të njëjtë ose të ngjashëm, çka do bënte mundur shkëmbimin e përvojës, ekspertizës, informacionit dhe të risive teknologjike.
3. Nevoja për shtimin e bashkëpunimit dhe sigurimin e lidhjeve me IAL-të e tjera në vend, në kuadër të shkëmbimit të përvojës, shkëmbimit të literaturës akademike dhe botimeve kërkimore-shkencore, apo në kuadër të projekteve të përbashkëta në funksion të programit të studimit.
4. Në lidhje me literaturën ndihmëse, sidomos atë në gjuhë të huaj, rekomandohet që të shtohen mundësitë për një qasje më të lehtë në të nga ana e studentëve, njësoj siç ndodh me literaturën bazë, pasi këta të fundit hasnin vështirësi në këtë kuptim.
5. Rekomandohet një angazhim më i madh dhe një fushatë orientuese më efektive të stafit akademik të Departamentit të Turizmit dhe UAMD, në lidhje me rritjen e numrit të studentëve që duan të ndjekin këtë program studimit, pasi prioriteti i politikave qeveritare në kuadrin e turizmit është shtuar. Rol të rëndësishëm në arritjen dhe garantimin e suksesshëm të punës në këtë program studimit do të luante edhe bashkërendimi e bashkëpunimi mes universiteteve në vend.
6. Të rritet promovimi për këtë program studimi, nëpërmjet një fushate informuese dhe sensibilizuese, për afrimin e studentëve në këtë program.

External evaluation's conclusions of the second cycle study program Professional Master "Albanian Tourist Guide" provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" University, Durrës.

Strengths and affirmations:

1. Through the second cycle study program "Professional Master in Albanian Tourist Guide", "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, offers a quality curriculum, in accordance with the needs of the job market. Students are provided with quality theoretical preparation, as well as the possibility of employment in their profession in private companies or agencies, as tour operators or as a freelancer, depending on the needs of the market.
2. The study program of the second cycle "Professional Master in Albanian Tourist Guide", offered by the Faculty of Business, develops on a very good structural organization, as well as on human, academic (with titles and degrees) and leadership potential, as is demonstrated at better from his successes over the years. The infrastructure of "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, offers sufficient spaces for the implementation of the study program, especially in the new university campus, where the aforementioned faculty is located.
3. The academic staff of the study program are widely involved in scientific research, as well as participate in research projects, which is evidenced by their considerable commitment to scientific publications and studies, which include monographs, scientific articles, textbooks, etc. All the activities of internal and external academic staff are put at the service of students, not only for the curriculum of the program, but also for carrying out professional practice.
4. The library of "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, offers reading rooms with sufficient capacity. At the disposal of the academic staff and students are computers with Internet access and connected to other local and international libraries. In addition to books, the main and auxiliary literature placed at the service of staff and students is also offered through online literature, through subscriptions to 30 international scientific journals, to over 600 titles of academic books, in different languages, as well as access to the Albanian periodical from the period 1945 - 2007.
5. Partnership and cooperation agreement with various tourism organizations, both public and private, so that the students of the second cycle study program "Professional Master in Albanian Tourist Guide" can carry out their professional practice and improve their training, which leads to the promotion of the study program at the local level and beyond.
6. The internationalization strategy at the institution level, which also extends to the faculty and department that organize and offer the "Albanian Tourist Guide"



Professional Master study program, makes it possible for students to transfer their studies to regional universities, as well as continental ones and beyond.


7. Implementation of digital technology and online platforms ("Pitagora" platform for student data management, "Moodle" platform for online learning development, and Clean Score), in order to ensure the optimal implementation of the learning process, as well as the realization of exams and their objective evaluation.

Weaknesses:


1. Limited mobility opportunities for the students of "Albanian Tourist Guide" Professional Master study program, who tend towards study experiences in the auditoriums of foreign educational institutions, but also outside them as well.
2. Lack of technological means to support the teaching process in the Professional Master ATG study program (special reservation (booking) programs, tourism laboratory, video projectors, computer).

Recommendations:

1. It is recommended that the Department of Tourism and its academic staff, especially those engaged in the MPGTSH study program, make the most efficient use of electronic tools and information technology, in the best performance of not only teaching activities, but also those of practical nature. Professional programs should be installed in existing laboratories, especially in this study program, since concrete steps should be taken within the framework of internationalization, so as to adapt it to the needs of labour market at local level and beyond
2. "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, Faculty of Business, as well as the basic unit responsible for the study program of Professional Master in Albanian Tourist Guides, should intensify their efforts to build bridges of cooperation with other HEIs in Albania and beyond which offers a study program similar to this, enabling the exchange of experiences, knowledge, information and technological innovations.
3. The need to increase cooperation and ensure connections with other HEIs in the country, in the framework of the exchange of experience, the exchange of academic literature and research-scientific publications, or in the framework of joint projects in function of the study program.
4. Regarding the auxiliary literature, especially that in foreign languages, it is recommended to increase the opportunities for an easier access to it by the students, just as it happens with the basic literature, since the latter encounter difficulties in using it.



5. It is recommended a greater commitment and a more effective guidance campaign by the academic staff of the Department of Tourism and UAMD regarding the increase in the number of students wishing to follow this study program is recommended, as now there is an increased government policy priority in the tourism sector. Coordination and cooperation among universities in the country would play an important role in achieving and ensuring the success of work in this study program.
6. To increase the promotion of this study program through an information and awareness campaign, in order to bring students closer to this program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X